




NDËRGJEGJJA
(Dramë në pesë akte)

Sami Frashëri



© LOGOS·A
S H K U P
PRISHTINË
T I R A N Ë
2 0 1 4



LOGOS·A

Sami Frashëri
NDËRGJEGJJA

Boton: LOGOS-A
Biblioteka: DIVAN

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Milazim Krasniqi
Redaktor gjuhësor: Lindita Xhanari – Latifi

Redaktor i përgjithshëm: Xhevat Lloshi

Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Naser Fera
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus Print - Shkup

ISBN 978-9989-58-521-0

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2014

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

NDËRGJEGJJA

(Dramë në pesë akte)

Sami Frashëri

E PËRKTHEU NGA TURQISHTJA:
Raif Morina

TRANSKRIPTOI:
Irfan Morina

TITULLI I ORIGJINALIT:
Şemsettin Sami,
VİCDAN
(Beş fasıldan ibaret tiyatro eseri)



... Meqë përkthyes letrar më bëri vepra mahnitëse e Sami Frashërit, këtë përkthim dhe botim ia kushtoj intelektualës së parë shqiptare dhe pionieres së demokracisë, e cila në Skenën e Teatrit Kombëtar të Tiranës të shndërruar në Gjyq famëkeq të komunizmit dhe diktaturës, ashtu si Fatma në Gjyqin poaq famëkeq të Inkuizicionit spanjoll, e sfidoi vdekjen me ndërgjegje të lartë, duke thënë: *"Unë s'jam fajtore. S'jam komuniste... Unë jam nxënëse e Sami Frashërit dhe e Rilindjes Kombëtare...* Pra, me po kaq admirim mahnitës dhe respekt për *Ndërgjegjen* e shkrimtares MUSINE KOKALARI.

*Përkthyesi
Raif Morina*

PËRMBAJTJA:

NJË DRAMË I SHTOHET TRASHËGIMISË LETRARE TË SAMI FRASHËRIT.....	7
NDËRGJEGJJA NJERËZORE DHE NDËRGJEGJJA E SAMIUT SI DRAMË.....	17
 NDËRGJEGJJA	25
 AKTI I PARË	27
PAMJA E PARË	27
AKTI I DYTË	59
PAMJA E PARË	59
PAMJA E DYTË	60
AKTI I TRETË	95
PAMJA E TRETË.....	95
PAMJA E KATËRT.....	125
AKTI I KATËRT.....	135
PAMJA E PESTË	135
PAMJA E GJASHTË	149
AKTI I PESTË	163
PAMJA E SHTATË.....	163
PAMJA E TETË	169
PAMJA E NËNTË	183
PAMJA E DHJETË	192
PAMJA E NJËMBËDHJETË	196

NJË DRAMË I SHTOHET TRASHËGIMISË LETRARE TË SAMI FRASHËRIT

Në të dyja kulturat, shqiptare dhe turke, Sami Frashëri shquhet në radhë të parë si enciklopedisti i madh. Këtë vlerësim të shquar ai e ka marrë jo vetëm sepse ishte autori i *Fjalorit universal të historisë dhe gjeografisë* në gjashtë vëllime dhe i pesë fjalorëve të tjerë, jo vetëm sepse përgatiti një bibliotekë të tërë me 12 punime nga lëmenj të ndryshëm të dijes, si dhe nëntë libra didaktikë për gjuhët, por edhe sepse fushat që lëvroi me tërësinë e tyre përbëjnë një enciklopedi të shumanshme. Ai ishte publicist dhe me atë horizont sintetizues përgatiti manifestin politik të Rilindjes shqiptare – *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet?*, ishte gazetar dhe drejtoi gjashtë gazeta e revista, ishte polemist dhe përkthyes, hulumtues dhe kritik. Ashtu si çdo autor prodhimtar i palodhur ka lënë edhe një tog dorëshkrimesh.

Visari i këtij mendimtari dhe krijuesi për shumë kohë ka qenë i njohur vetëm pjesërisht prej lexuesve shqiptarë e turq për shkak edhe të vështirësive që paraqisnin tri gjuhët, në të cilat ai ka shkruar. Kjo pengesë dhjetëvjeçarët e fundit është kapërcyer me përgatitjen e përkthyesve dhe sidomos nën nxitjen e studiuesve, të cilët me hulumtimet e tyre nga të dyja anët e kanë zgjeruar hap pas hapi rrezen e ndriçimit mbi punët e tij. Kështu me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së tij u bë e mundur që Shtëpia Botuese “Logos-A” të nxirrte një përmbledhje në 20 vëllime të *Veprës* së Sami Frashërit. Kjo arritje për kulturën shqiptare ishte fryt i përkushtimit të gjallë nga ana e drejtuesve të Shtëpisë Botuese, i përpjekjeve të përkthyesve e të redaktorëve, si dhe i punës me cilësi të lartë në shtypshkronjë për gjithë përmbledhjen.

Vepra natyrisht që do të hapej me manifestin politik të rilindësit të madh shqiptar, që gjithashtu ishte një rilindës për gjuhën dhe kulturën e re turke. Me vlerë të veçantë është zgjerimi i njohjes së personaliteteve dhe viseve shqiptare në enciklopedinë e Samiut, ndërsa në vëllime të veçanta janë abetarja dhe gramatika e shqipes, të cilat kanë luajtur rol të madh për shkollën dhe gjuhësinë shqiptare në kohën e tyre. Vëllimet e fundit janë përzgjedhur nga publicistika dhe biblioteka e tij e xhepit. Një vëllim shtojcë dy vjet më vonë, më 2006, gjithashtu prej Shtëpisë Botuese “Logos-A”, ka përfshirë bibliografinë e gjithë botimeve me emrin e autorit nga viti 1872 deri më 2006, si dhe të bibliografisë mbi autorin nga viti 1880 deri më 2006.

Nga kjo pasqyrë e re për prodhimin shumëpërmasor të Samiut bie në sy, se prej krijimtarisë së tij letrare kanë zënë vend kryesisht një dramë dhe një roman në mjaft ribotime, si edhe në veprat përmbledhëse. Është e kuptueshme që përmasa diturore dhe publicistike krijon përshtypjen se krijimtaria e tij letrare mbetet disi në hije. Kështu shpjegohet përse akad. Ali Aliu kumtesën e botuar në vëllimin “Bibliografia e kumtesat” e nis me pohimin: “Sami Frashëri është autor edhe i dy veprave letrare.” Në të vërtetë, Samiu ka qenë gjithashtu shkrimtar në kuptimin e mirëfilltë të letërsisë artistike. Madje letërsia e në veçanti drama, me sa duket, ka qenë e parapëlqyera e enciklopedistit në fillimet e krijimtarisë së tij.

Djaloshi i ri 21-vjeçar erdhi në Stamboll nga Janina, ku tre vjet më parë kishte mbaruar gjimnazin e njohur Zosimea, dhe ende ishte nën magjinë e letërsisë franceze. Shkruan romanin *Dashuria e Talatit dhe e Fitnetes*, i cili mbahet si romani i parë i letërsisë së re turke dhe njëkohësisht është shkrimi i parë i tij i botuar (1872). Është një rrëfim sentimental për fundin tragjik të dashurisë së pafat në mjedisin oriental. Ndërkaq, nuk mungojnë jehonat nga kjo gjini në letërsinë europiane me vetëvrasjet, çmendjet, fajin tragjik dhe

rreziket për incest. Nuk mund të mohohet që rrëfime të tilla e kanë gjithnjë një shtresë lexuesish. Me këtë kuptohet përse është ribotuar katër herë turqisht dhe katër herë i përkthyer shqip. Hartoi edhe një tragjedi (Shyhrabi ose Përsiatësi) me motive nga “Shahnameja” e Firdusit, por e ndjeu se nuk u përmbahej kërkesave për një vepër teatrale dhe e la mënjanë.

Nuk ishte thjesht vllaga e ndikimit të frëngjishtes, që e shtyu menjëherë të përkthente diçka nga një histori e shkurtër e Francës po atë vit të parë, romanin *Galateja* më 1873 dhe një dramë, *Rreshteri plak* nga Dumanoir-Donnery, që është dhënë shqip edhe me titullin *Tetari plak*. Përkundrazi, burimet nga frëngjishtja i kanë shërbyer gjithë jetën Samiut e sidomos për punimet e tij enciklopedike dhe ky orientim përputhej më së miri me rrymën e zhvillimit të kulturës së re turke të asaj kohe. Dihet se për shumë kohë edhe huazimet e reja dhe terminologjia në turqishten e kanë pasur burimin pikërisht nga frëngjishtja. Vetë Samiu për terminologjinë gjuhësore të shqipes është mbështetur drejt-përdrejt te fjalët e frëngjishtes.

Drama ‘Rreshteri plak’ u shfaq në Stamboll në janar 1874; besoj se ai ka ndier menjëherë një frymëzim të veçantë nga një e papritur e tillë. Në atë vrull brenda pak kohësh Samiu ia doli ta hartonte e ta vinte në skenë në prill dramën *Besa*. Pa asnjë dyshim, kjo ka qenë vepra e tij më e suksesshme. E botoi një vit më pas dhe është përkthyer bullgarisht më 1902, italisht më 1908, frëngjisht më 1918 dhe anglisht më 1945.

Shqip *Besa* është përkthyer më 1901 nga A. Ypi Kolonja dhe u shtyp në Sofje. Më pas është rishtypur tetë herë, që nga viti 1918 e deri më 2004. Në parathënien e dramës vetë autori është shprehur: “Që prej kaq kohësh ma pati push-tuar përfytyrimin mendimi për të shkruar një pjesë teatrale, në të cilën do të viheshin në pah disa vlera morale e zakone tradicionale të popullit shqiptar. Dhe kjo jo sepse jam bir i këtij populli, por ndoshta ngaqë tek ai kisha vënë re disa

virtyte fisnike të tyre, si atdhedashuria, shpirti i sakrificës, besa, vetëmohimi, të cilat ia vlen të vihen në skenë.” Stудиuesi turk Agâh Sırrı Levend (1969), ma merr mendja gjithashtu i frymëzuar për vete, e ka përshkruar kështu shkëndijën e krijimit të kësaj veprë: “Një mbrëmje shkurti [domethënë muajin tjetër pasi ishte shfaqur drama e përkthyer], ndërsa shtrihej në shtrat, në mendje i vjen *besa*. Stina e teatrit ishte në mbarim e sipër. Vendos që ta shkruajë menjëherë dhe ta vërë në skenë po në atë stinë. Të nesërmen në mëngjes sa zgjohet nga gjumi, lag bojën e tharë, lidh me pe penën e vetme të plasarit dhe shkruan drejt e në të pastër. Sepse ai atë që e mendonte natën, e shkruante në ‘fletoren e veçantë të imagjinatës’. Në të vërtetë ai veprat i shkruante gjithmonë në këtë mënyrë.”

Vepra u shfaq më 5 prill dhe u prit me duartrokitje. Konflikti dramatik si gjithnjë ka në qendër një dashuri, ndërmjet Rexhepit e Merushes, po këtë radhë pengesa janë ndjenjat e një trimi, Selfos, i cili e do vetë vajzën dhe arrin derisa të vrasë të atin e saj. Kthesa e papritur vjen me kthimin pas shumë vjetësh të babait të Selfos, të cilit ia shpëton jetën pikërisht gruaja e të vrrarit prej të birit. Ai i jep besën asaj dhe do ta plotësojë atë sipas thënies së njohur: “Shqipitari kur jep fjalën, ther edhe djalën.” Fundi tragjik duke e mbajtur besën e çon pastaj të vrasë edhe veten. Me këtë përfundim duket sikur autori nuk pajtohej me atë thënie, përmbajtja e së cilës ishte kapërcyer që në kohët e para biblike, kur Zoti e zëvendësoi me një kurban betimin e Abrahamit për të vrrarë djalën. Për mendimin tim, ishte pikërisht kjo kundërthënie e brendshme, domethënë vlera e besës përballë zbatimit të saj të pamëshirshëm, që jo vetëm e bën thurjen e ngjarjes tronditëse, por edhe e shtyn spektatorin të mendojë përtej pranimit të pavetëdijshëm të një tradite.

Po atë vit (më 1875) Samiu botoi edhe dramën e dytë *Sejdi Jahjai*, këtë radhë me një ngjarje nga Spanja në fund të shek. XVI dhe në vitet e sundimit të Ferdinandit të

Aragonës. Në parathënien e saj autori na ka dhënë edhe një shpjegim, se cili ishte parimi i tij ndërtues për intrigën e veprës, parim që e vëmë re te krijimet e tij përgjithësisht. Ai shkruan: “Megjithëse historia jonë është e mbushur plot me ngjarje të tilla, të cilat meritojnë të jenë subjekte dramash, përsëri jemi të detyruar që drama të tilla kombëtare t’i shoqërojmë edhe me tema dashurie e martesë të dhunshme.” Rrjedhimisht, shkrimtari merrte pikënisje nga ndonjë ngjarje ose nga historia, por e ndërthurte me kërkesën e shikuesit, që të kishte doemos dashuri, trekëndëshin e dashurisë dhe përpjekjet për martesë të dhunshme. Njëkohësisht këto do të shoqëroheshin me kundërvënien e atdhedashurisë përballë tradhtisë, me zbulime të papritura dhe befasi nga e kaluara e personazheve. Prandaj sajimet e veta artistike ai i përligj, duke thënë, për shembull për këtë rast, se “Dashuria e Jusufit dhe Halimesë plot fatkeqësi, pengesa e dëshpërim dhe së fundi, arritja e lumturisë, besoj se nuk i kanë krijuar ndonjë mangësi dramës sime.” Fundi i Sejdi Jahjasë ishte në kundërshtim me të vërtetën, por autori donte ta shpëtonte artistikisht nga një njollë, që nuk i shkonte për shtat. Shqip është përkthyer më 2004.

Dhe kështu pa ndërprerje, vit pas viti botoi të tretën dramë *Gave*, pjesë teatrale në pesë akte me temë nga ‘Shahnameja’, për historinë e farkëtarit Gave, që ia del të rrëzojë sundimtarin gjakatar, i cili ndiqte kultin e gjarpërinjve, që i ushqente me fëmijë.

Me temë nga ‘Shahnameja’ ka mbetur në dorëshkrim edhe drama “Shuhrabi ose Përsiatësi” (Suhrab Yahud Ferzendkuş), të cilën e ka përmendur te gazeta “Serveti Fünun” më 19 qershor 1896 dhe, siç u tha më lart, e la vetë mënjane. Po atë vit njoftonte se po shkruante dramën “Fëmijët” (Çocuklar), një tjetër “Përsëri Besa” (Yine Besa), si dhe “Shtriga” (Cadı), por më shumë nuk dimë gjë për këto.

Si shpjegohet ky pasion rinor i tij për skenën? Ai ka folur disa herë për këtë; kështu te parathënia e dramës së

dytë të botuar theksonte domosdoshmërinë dhe dobinë e teatrit, si dhe epërsinë që gëzonin shfaqjet e teatrit kombëtar. Ndërkaq, gjithçka nevojitet të vendoset në mjedisin lettrar e kulturor të kohës. Pas reformave të Tanzimatit për disa dhjetëvjeçarë fryu një erë e re në kryeqytetin osman. E para pjesë teatrale turke ka qenë një komedi (1860) e shkrimtarit Shinasi, pa ndonjë vlerë të veçantë. Po sidomos duhet përmendur Namik Qemali (1840-1888), i cili hartoi një varg dramash romantike, shpesh nën ndikimin e drejtpërdrejtë të teatrit francez. Pjesa e tij “Vatan” u prit me entuziazëm nga shikuesit më 1873, por autoritetet e internuan për këtë. Shkurt, Samiu u përfshi po në këtë rrjedhë të mendimit e të letërsisë me N. Qemalin. Njerëzit përparimtarë të Turqisë po zbulonin rolin shoqëror të teatrit. Samiu te njëra parathënie ka vënë në dukje: “Nuk e shoh të nevojshme që të ndalem gjatë në domosdoshmërinë dhe dobinë e teatrit, si dhe mbi epërsinë që gëzojnë shfaqjet e teatrit kombëtar.”

Në fund të librit “Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit”, botuar më 1884 dhe përkthyer shqip më 2004, Sami Frashëri ka dhënë një listë të shkrimeve të veta të botuara dhe të pabotuara. Aty renditet te nr. 28 edhe *Mezalimi Endelus*, që shqip me përpikëri do të përkthehej *Mizoritë në Andaluzi*. Autorët që do të shkruanin për Samiun, do ta përmendnin shkarazi, mes trashëgimisë së tij të panjohur, me titullin *Dhuna e Andaluzisë*. Dorëshkrimi i saj ende mbetet i panjohur.

Nuk mund të mos shënoj se A. S. Levendi në librin e tij “Sami Frashëri” (botuar shqip më 2004) përmend edhe një dramë në tre akte “Ndërgjegjja” (Vicdan), por pa të dhëna të tjera për të gjykuar më tepër.

Ndërsa pas hulumtimeve këmbëngulëse dorëshkrimin e zbuloi më 2011 në Arkivin Qendror Shtetëror prof. dr. Irfan Morina, orientalist. Sipas mendimit të tij, është hartuar në vitet 1876-1877, domethënë pikërisht në vijim të vrullit dramaturgjik të Samiut. Ishte shkruar në osmanishten e ko-

hës, prandaj I. Morina bëri një punë të lavdërueshme, duke e kthyer në turqishten e sotme. Kjo bëri të mundur që Raif Morina në Prizren ta përkthente shqip më 2013. Ndeshemi kështu përsëri me dy emra, që në vitin 2004 transkriptuan nga osmanishtja dhe përkthyen shqip dramën “Sejdi Jahja”. Ndërsa në vitin 2006 gjithashtu dramën “Gave” e ka përkthyer shqip Raif Morina. Përkthyesi ka përballuar me sukses punën e vështirë për t’i kthyer këto tekste shqip.

Ngjarjet e dramës i përkasin vitit 1492 në Granadë të Spanjës. Është koha e sundimit të mbretit Ferdinand të Aragonës dhe mbretëreshës Isabela të Kastiljes. Me forcat e tyre të bashkuara ata ia arritën të dëbonin arabët maurë prej asaj province dhe të shtinin në dorë Granadën. Po binte edhe qyteti i fundit dhe këto ngjarje tronditëse e të përgjakshme përfshinë në vorbullën e luftës edhe jetën e njerëzve nga të dy anët e ndërluftuesve. Drama ka pesë akte. Fatma dhe Hasani, motër e vëlla, janë në qendër të ndërlikimeve të veprimit. Ajo është e fejuar me Ridvanin, që mishëron luftëtarin e palës arabe. Hasani përkundrazi, dashuron Lionorën nga pala e spanjollëve dhe kështu mishëron njeriun e lëkundur ndërmjet dashurisë dhe detyrës kombëtare. Konvertohet në katolik, ndryshon edhe emrin, madje është gati të flijojë edhe të ardhmen e së motrës, duke pranuar që edhe ajo të ndërrojë emrin e të martohet me kunatin e tij të ardhshëm. Kur këto plane të këqija shkojnë mjaft larg, pas rimarrjes së qytetit nga spanjollët, Hasanin fillon ta brejë ndërgjegjja. Pikërisht për këtë arsye përkthyesi e ka titulluar edhe shqip “Ndërgjegjja”, duke e quajtur se konflikti midis dashurisë dhe atdhetarisë është vatra e shtjellimit të ngjarjeve dhe morali i dramës.

Kështu thuret një tekst melodramatik me personazhe të ndërkryqëzuara mes palëve kundërshtarë në luftë. Autori ka shfrytëzuar gjithë sajесat e zakonshme të intrigave, synimeve të fshehura, shfaqjeve të papritura, monologëve patetikë dhe dialogëve me shumë “ah!” e “oh!”, moralizimeve e

ndjenjave të larta, të shprehura me retorikë. Zgjidhja është e llojit me fund të lumtur, ku ngadhënjen vetëdija atdhetare, por pa e flijuar edhe pasionin.

Lexuesi i sotëm shqiptar e ka të vështirë të orientohet me lehtësi në stilemat patriotike të personazheve, sepse ka përvojën historike të luftërave në shekullin e fundit, të lëvizjeve çlirimtare dhe në veçanti prej arritjes së pavarësisë së Kosovës. Nuk e besoj që në ato vite Samiu mendonte për shpërnguljet masive të shqiptarëve pas rënies së Perandorisë Osmane dhe as mund të bëhet ndonjë paralelizëm me largimin e arabëve nga Spanja dhe me fatin e mundshëm të shqiptarëve.

Mjafton të përmend nocionin themelor të atdheut, i cili nuk përkon historikisht mes maurëve në Spanjë dhe shqiptarëve, që janë autoktonë në Kosovë. Përveç kësaj, dramën e përshkon një konflikt i hapur edhe ndërmjet besimeve fetare. Nuk është e nevojshme të zgjatëm për këtë anë, që e njohin mirë të gjithë në kontekstin e sotëm kombëtar dhe ndër-kombëtar. Nga ana tjetër, është e vërtetë historike, që në periudhën e Ferdinandit të Aragonës dhe Isabelës u ngrit Inkuizicioni i tmerrshëm spanjoll me gjithë krimet e tij deri kundër njerëzve të shkencës, por nuk ka si të harrojmë që më 1492 ata mbështetën ekspeditën e K. Kolombit për zbulimin e Amerikës dhe po në atë vit, me pushtimin e principatës së Granadës arritën në fakt bashkimin e Spanjës. Historia është e mbushur me kundërthëniet e veta dhe sot shtrohet çështja që të mos gjykohet vetëm me qëndrimin tendencioz, sipas interesave vetëm të njëres palë.

Duke i pranuar të metat e veprës edhe nga ana artistike, për të cilat vetë Samiu duket se ka qenë i vetëdijshëm e prandaj nuk vendosi ta botonte, do të shtoja se është e natyrshme që ato do të binin edhe më tepër në sy pas pothuaj një shekulli e gjysmë. Rrjedhimisht, ajo mbetet pjesë e krijimtarisë letrare të Samiut, që e vlente të zbulohet e t'i bëhej e njohur botës sonë letrare. Që është e nevojshme të njihet

më gjerësisht krijimtaria e Samiut do ta vërtetonte mjaftueshëm edhe vetëm fakti i mëposhtëm. Në ribotimin e “Fjalorit enciklopedik shqiptar” më 2008 shënohet vetëm drama “Besa” dhe i gjithë artikulli për Sami Frashërin është po ai, që ishte paraqitur një çerek shekulli më parë! Ndërkohë ne kishim nxjerrë me Shtëpinë Botuese “Logos-A” më 2004 veprën e Sami Frashërit në 20 vëllime, shoqëruar me vëllimin plotësues, që përmban edhe bibliografinë e plotë të shkrimeve të tij dhe të çfarë ishte shkruar deri atëherë për jetën dhe veprën e tij. Ndërsa tashti do të bëhen 4 drama jo vetëm të njohura, po edhe të përkthyer shqip, një pasurim i vërtetë për historiografinë letrare shqipe.

Shtëpia Botuese “Logos-A” po ua jep lexuesve këtë vepër të përkthyer shqip. Dhe është në kohën më të përshtatshme, sepse sivjet është 110-vjetori i vdekjes së Samiut. Nuk mund ta mbyll pa i përgëzuar të dy Morinat dhe Shtëpinë Botuese, që e bënë të mundur këtë ngjarje me rastin e përvjetorit.

Xhevat Lloshi

NDËRGJEGJJA NJERËZORE DHE NDËRGJEGJJA E SAMIUT SI DRAMË

Drama *NDËRGJEGJJA* e Sami Frashërit është shkruar osmanisht (në turqishten e vjetër) dhe ashtu ka mbetur në dorëshkrim, pa u botuar deri tani, madje as në gjuhën turke. Vepra në dorëshkrim është gjetur pas shumë hulumtimeve dhe kërkimeve nga Prof. Dr. Irfan Morina – orientalist, nëpër shumë biblioteka, universitete dhe akademi në Stamboll, me dëshirën dhe qëllimin për të plotësuar veprën e botuar të Samiut edhe me veprat e tjera të shkruara nga ai, por të pabotura, pra të mbetura në dorëshkrim. Si për çudi, Profesori në vitin 2011 këtë dramë në dorëshkrim nuk e gjeti në Stamboll, por në Arkivin e Shtetit Shqiptar në Tiranë, e transkriptoi në turqishten e sotme dhe ma dhuroi, që unë të kem ndërin dhe respektin ta përkthej në gjuhën shqipe.

Dorëshkrimi nuk ka ndonjë datë të shënuar. Sipas Prof. Dr. Irfan Morinës, bazuar në kronologjinë e botimit të veprave letrare të Samiut, kjo Dramë duhet të jetë shkruar gjatë viteve 1876-1877 si vazhdimësi e dramave BESA, SEJDI JAHJA dhe FARKËTARI GJAVE, të cilat për fat të mirë sot janë përkthyer dhe botuar edhe në gjuhën shqipe.

Drama ka si temë bosht ngjarjet e hidhura në Granadën e Andaluzisë së Spanjës, kur kjo provincë u pushtua nga mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Izabelë, në vitin 1492, pas më se shtatë shekujsh sundimi nga arabët. Ky pushtim, apo ripushtim mizor i Andaluzisë, në historinë botërore njihet si më i përgjakshmi, më çnjerëzori dhe më i pandërgjegjshmi, i planifikuar, i udhëhequr dhe i realizuar nga ki-

sha katolike e Romës përmes Kardinalëve të Papës. Pikërisht për këto ngjarje të trishtuara, Samiu edhe me këtë vepër teatrale (njëlloj si në dramën Sejdi Jahja) dëshiron të sprovtojë edhe njëherë ndërgjegjen njerëzore, prej nga rrjedh edhe titulli i dramës, duke ngritur lart brengën e tij dhe të iluministëve të tjerë europianë, përmes zërit të personazheve të përfytyruara. Me këtë dëshironte që edhe njëherë të kthjellonte ndërgjegjen njerëzore për këto mizori në përgjithësi, por mendoj se në veçanti, Samiu kishte brengën e fatit të popullit të tij të origjinës, pra të popullit shqiptar, duke e parë muzgun e Perandorisë Osmane dhe duke e krahasuar këtë rënie, me rënien e Perandorisë Arabe në Andaluzi dhe pasojat nga kjo shembje për arabët, hebrenjtë dhe gjithë të tjerët jo të krishterë. Ai e dinte se atëherë nga Andaluzia e Spanjës u përndoqën nga Inkuizicioni më se 3 milionë arabë dhe më se 3 qind mijë hebrenj dhe u shpërngulën për në Afrikën Veriore e Turqi, prandaj dhe kishte frikë se mos e njëjta fatkeqësi do t'u ndodhte edhe shqiptarëve pas rënies së Perandorisë Osmane, duke i ditur rrethanat e atëhershme gjeopolitike. Fatkeqësisht, të themi kushtimisht se një Akt të një drame të tillë të popullit shqiptar Samiu veçse e kishte parë me shpërnguljen dhe përndjekjen e qindra mijëra burrave, grave e fëmijëve nga trojet e tyre autoktone nga Nishi e Leskovci, Kurshumlija dhe Toplica. Prandaj kishte frikën që tragjedia mos të vazhdonte dhe donte që ta kthjellonte ndërgjegjen njerëzore, se njerëzimi duhet të jetë më human, i aryeshëm dhe i drejtë. Nga ana tjetër, në mënyrë të prerë, ai u përcjell porosinë bejlerëve dhe agallarëve shqiptarë, se duhet ta vënë interesin kombëtar mbi atë personal dhe familjar, për të mbrojtur popullin nga fatkeqësi të tilla të mundshme me këto fjalë të personazheve të dramës:

FATMA: ... *Asnjëri nga prijësit tanë nuk është duke menduar për të mirën e vendit. Secili mendon vetëm për rehatinë dhe madhështinë e vet. Syri i secilit është tek froni dhe kurora. Për ta marrë fronin, vëllai vret vëllanë. Për interes, prindi ia vë prangat të birit. Vetëm e vetëm për të qëndruar në pushtet, djali bëhet komandant në ushtrinë e armikut!*

Por fatkeqësisht, mizoritë e Andaluzisë pas vdekjes së Samiut (më 1904) u përsëriten duke i ndjekur dhunshëm nga Çamëria për në Shqipëri më se treqindmijë çamë dhe duke i shpërngulur me valixhe në dorë nga Kosova për në Turqi po ashtu më se treqind mijë shqiptarë, e në këtë mënyrë numri 3 u shndërrua si ndonjë numër magjik i pandërgjegjshmërisë dhe tragjedisë njerëzore, si në Andaluzi, ashtu edhe në Arbëri.

Drama NDERGJEGJJA është shkruar në V (pesë) Akte.

Personazhet kryesore të Dramës janë:

FATMA: është e bija e Ibn-i Hatibit, motra e Hasanit dhe e fejuara e Ridvanit. Fatma ishte rritur jetime nën përkujdesjen e vëllait të saj, Hasanit. Është një vajzë e bukur arabe me të cilën dashurohet Ridvani, por edhe Rafaeli dhe Kardinali Mysjy. Ajo do të martohet me Ridvanin brenda dhjetë ditësh, por meqë mbreti Ferdinand kishte dhënë ultimatum që Granada duhej t'u dorëzohej spanjollëve, marteja e tyre u shty për më tutje. Ridvani, si djalë atdhetar që ishte, i thotë Fatmës se tani nuk është koha për martesë, por për mbrojtjen e atdheut dhe vdekjen, prandaj edhe u bashkohet luftëtarëve të tjerë.

RIDVANI: është një djalë trim dhe i fejuari i Fatmës. Nuk i dhimbset jeta dhe lufton për mbrojtjen e atdheut, duke u bashkuar me Musa bin Ebu'l-Gazenin, i cili ishte deputet i Parlamentit të Granadës dhe prijës për mbrojtjen e vendit.

HASANI: është vëllai i madh i Fatmës dhe përveç saj, ai nuk ka askënd tjetër nga familjarët. Është njëzet e pesë vjeç. Emri i tij, pas konvertimit në katolik, është Don Alfons. Ai dashurohet me Lionorën, një vajzë e krishterë dhe për t'u martuar me të, heq dorë nga feja islame dhe konvertohet në katolik. Ai nuk merr pjesë në mbrojtjen e atdheut dhe ndahet nga e gjithë shoqëria e tij, duke vepruar kështu i vetmuar në kokë të vet. Pas konvertimit dhe pranimit të emrit Don Alfons, nga ana e mbretit Ferdinand i dërgohet titulli dhe medalja e Donit. Për shkak se kishte ndërruar fe, pas pushtimit të Granadës atë e bren ndërgjegjja për këtë veprim dhe e gjykon veten si tradhtar në krahësim me të tjerët, të cilët kishin shkuar në luftë, ndërsa ai vetë qëndronte i mbyllur në shtëpi.

LIONORA: është e bija e Don Pedros dhe e dashura e Hasanit. Tri vitet e fundit janë bashkë. Edhe pse babai i saj, Don Pedro, është kundër njoftimit dhe fejesës së saj me Hasanin, ajo nuk e pranon këtë. Përveç kësaj, Lionora është edhe e vetmja që e kupton drejt dashurinë e Fatmës dhe gjithmonë e ndihmon atë.

DON PEDRO: Është babai i Lionorës dhe Rafaelit. Atij i është dhënë titulli i nderit Don nga ana e mbretit Ferdinand dhe e mbretëreshës Izabelë.

RAFAELI: Është i biri i Don Pedros dhe vëllai i Lionorës. Ai është i dashuruar me Fatmën, por faktin që Fatmën e ka parë vetëm njëherë, nuk e di askush.

KARDINALI: është Kardinal i Granadës dhe udhëheq Inkuizicionin në këtë vend. Me të parë Fatmën, instinktivisht bie në dashuri dhe nga ai çast kërkon rrugë për ta bërë për vete. Mashtron, intrigon dhe trillon gjëra nga më të ndryshmet vetëm e vetëm për të arritur qëllimin e tij të ulët.

Fatmën e burgos në kishë dhe e keqtrajton për ta bindur me dhunë, por këtë nuk e arrin dot, pasi në fund Fatma ngadhënjën dhe del fitimtare.

MURGIT DHE MURGESHAT

KRYEMURGESHA

NJË PLAK

NJË DJALË

SHOKËT E LUFTËS TË RIDVANIT:

AMRU

SA'D OSMANI

XHAFERRI

ABDULLAHU

IBRAHIMI

Fatma është kryepersonazhi i dramës, Ndërgjegjja me të cilën kjo dramë fillon dhe mbaron. Është e fejuara e Ridvanit me të cilin do të martoheshin brenda dhjetë ditësh. Por Granada e Andaluzisë si vend dhe Alhamra si qytet, është rrethuar nga forcat e mbretit Ferdinand dhe i është dhënë ultimatum sundimitarit të fundit mysliman Es-Safirrit për dorëzimin e qytetit spanjollëve të krishterë. Ridvani, si djalë trim dhe atdhetar, vendos t'u bashkohet luftëtarëve të tjerë nën komandën e Musasë, për mbrojtjen e vendit, prandaj dhe i thotë Fatmës se martesë e tyre duhet të shtyhet për më tutje, pasi tani nuk ishte koha për martesë. Fatma mërzi-tet shumë prej këtij njoftimi të Ridvanit, por pranon që ai t'u bashkohet forcave për mbrojtjen e Granadës dhe përshëndeten. **FATMA:** *Zoti ju ndihmoftë në shpëtimin e atdheut dhe na mundësoftë që të shihemi përsëri!*

Hasani edhe pse e ka motër Fatmën dhe e do, meqë ajo është rritur jetime në duart e tij, dashuria ndaj Lionorës ia turbullon ndërgjegjen dhe mbetet as andej e as këndej.

Megjithatë, ai vendos që ta pranojë fenë katolike, meqë ndryshe nuk mund të martohej me Lionorën e krishterë, duke e ripagëzuar veten si Don Alfons. Ai pranon nga mbreti Ferdinand titullin dhe medaljen e Donit, nuk merr pjesë në luftë për mbrojtjen e atdheut, si dhe i sjell shumë vuajtje e mundime Fatmës. Pas kësaj Fatma nuk do të pranojë se ka një vëlla me emrin Don Alfons. Por Hasani e mashtron dhe e bind Fatmën që edhe ajo duhet të heqë dorë nga feja islame, madje për një kohë të shkurtër derisa ky do të martohej me të dashurën e tij Lionorën dhe pastaj do iknin të gjithë së bashku nga Granada. Fatma nuk bindet me këtë meqë ndërgjegjja e saj është e lartë, por Hasani sajon trillime nga më të ndryshmet dhe e mashtron Fatmën, në mënyrë që ajo përkohësisht dhe me mashtrim ta pranojë fenë katolike, ta ndërrojë emrin në Elizabetë dhe gjithashtu të pranojë se nuk e do më Ridvanin (meqë ai kinse ka vdekur), por do Rafaelin dhe pranon të martohej me të.

Për t'i zyrtarizuar të gjitha këto konvertime dhe ripagëzime sipas Gjqyt të Inkuizicionit, Fatma duhet të shkojë tek Kardinali. Por Kardinali, me të parë Fatmën e bukur, dashurohet pas saj dhe që nga ai moment ai vepron, trillon dhe rrezikon çdo gjë nga detyra e tij si Kardinal për ta bërë Fatmën për vete. E burgos në kishë, i urdhëron Kryemurgeshës që ta lërë pa ujë e pa bukë, që ta prangosë dhe ta fusë në birucë. E pastaj e provokon herë pas here në mënyrë që Fatma të bindet dhe ta pranojë dashurinë e tij në këmbim të shpëtimit të saj nga dënimi me djegje në zjarr, pasi ajo njëherë gjoja është bërë e krishterë, por pastaj ka hequr dorë duke u penduar. Fatma nuk e pranon këtë, duke thënë gjithmonë se vdekja për të është shpëtim. Mirëpo kjo sjellje

e Kardinalit e shtyn Kryemurgeshën të ketë xhelozit dhe të hakmerret. Prandaj i shkruan një letër Papatit në Romë, duke e njoftuar Papën për këto veprime të kundërligjshme dhe të papërgjegjshme të Kardinalit.

Papa me të marrë letrën e Kryemurgeshës Maria, nxjerr një vendim për ndërrimin e këtij kardinali të quajtur Mysju dhe cakton një kardinal të ri. Por kardinalit të ri dhe dy murgjve të tjerë që e shoqëronin, rrugës duke shkuar për në Granadë, u del përpara Ridvani me shokë. Ua marrin dy ediktet e Papës dhe i ekzekutojnë që të tre. Ridvani vesh rrobat e kardinalit, ndërsa shokët e tij veshin ato të murgjve.

Ridvani sipas veshjes që ka, tani luan rolin e kardinalit të ri me murgj që vijnë nga Roma. Shpejtojnë që sa më parë të arrijnë në burgun e kishës në Granadë ku është burgosur Fatma me Hasanin dhe Lionorën. Veç Fatmës, dhe këta të dy janë në të njëjtin burg. Hasani, duke i parë torturat ndaj motrës së tij, Fatmës, pendohet dhe kthehet në fenë e të parëve, pra në mysliman. Po ashtu edhe Lionora, duke parë padrejtësitë që i bëhen Fatmës, e pranon fenë myslimane, duke e pagëzuar veten si Mazllume. Pikërisht për këtë arsye edhe këta të dy janë të dënuar me burg.

Ridvani në rolin e kardinalit të ri, me të arritur në kishë, sipas ediktit të parë, e shkarkon menjëherë kardinalin Mysju dhe sipas të dytit, për shkak se Don Pedroja kishte tentuar që vajzën e tij Lionorën ta martonte me një mysliman (pra me Hasanin) e ky ishte veprim i ndaluar sipas ligjit të Inkuizicionit, u jep urdhër shokëve të tij ushtarë (tani të veshur si murgj) që t'i dërgojnë për në Romë që të dy për t'u dhënë dënimet e merituar. Pastaj urdhëron kryemurgeshën Maria që t'i përcjellë këta për në qelinë e kishës tek të burgosurit e mësipërm. Drama përfundon me lirimin e Fat-

mës, Hasanit dhe Lionorës nga burgu dhe me dënimin e Kryemurgeshës Maria nga ana e Ridvanit (kardinalit të ri) si spiune.


Originali i Dramës përfundon me kaq. Sipas transkriptuesit, Prof. Dr. Irfan Morinës, ka mundësi që ndonjë faqe e fundit të ketë humbur ose vetë Samiu ta ketë lënë me kaq, meqë nuk e dorëzoi në shtyp, por i mbeti në dorëshkrim!.

PRIZREN

16 mars, 2013

*Përkthyesi
Raif Morina*

NDËRGJEGJJA



AKTI I PARË

PAMJA E PARË

(Kur hapet perdja, shihet një dhomë në stilin arab. Në fund të saj është një derë, në të majtë një dritare dhe në të djathtë edhe një derë tjetër. Në të majtë është një minder dhe pranë tij një tavolinë e vogël plot e përplot me libra. Mbi këtë tavolinë janë ca dorë-shkrime. Pranë derës së djathtë është një sënduk me sirtar dhe mbi të një komplet prej ari për lëngje frutash. Në mur janë vënë disa tablo dhe një shpatë. Fatma, e veshur me rroba arabe, është ulur në minder dhe është duke qëndisur me gjergjef.)

Skena e parë

(Hyn së pari Fatma e pastaj Ridvani)

FATMA: *(E lë gjilpërën dhe flet me vete):* U bënë tri ditë që nuk e kam parë! Nuk e di se çfarë ka ndodhur? Më parë vinte tri-katër herë në ditë. Ka diçka këtu.

Duhet t'i ketë ndodhur diçka e madhe Ridvanit që nuk po vjen të më shohë... Mbrëmë bisedonte bashkë me vëllanë në rrugicë. Ndërsa i vëllai sot ishte pak si i dalldisur... Ah, këtu pa dyshim ka diçka... Po çfarë mund t'i ketë ndodhur vallë? Mos e dhëntë Zoti t'i ketë ndodhur ndonjë ngatërresë... Ah, o Zot, po çfarë faji kemi ne për këto vuajtje! Çdo ditë dëgjojmë për tragjedira të padurueshme dhe të tmerrshme. Sot dëgjon për rrethimin e një qyteti, nesër për djegien e tij dhe pasnesër për vrasjen me shpatë të qindra mijëra myslimanëve të pafajshëm, burra e gra, fëmijë e pleq. Dëgjojmë për

marrjen rob të mijëra vajzave dhe pastaj për dhunimin e tyre! Tani për tani në tërë Spanjën vetëm qyteti ynë Granada ka mbetur pa u prekur nga shpata e armikut! Por ka të ngjarë që të mos vazhdojë kështu. Sepse tragjeditë e ndodhura në Granadë, janë edhe më të tmerrshme. Që kur unë mbaj mend, këtë qytet fatkeq kurrë nuk e pashë pa mbrapshti të liga. Në një anë Ebu Hasani e në anën tjetër es-Safiri me ez-Zagilin, jo hilja e hileqares Zehra e jo ngatërresat e ngatërrestares Ajshe... Asnjëri nga prijësit tanë nuk është duke menduar për të mirën e vendit. Secili mendon vetëm për rehatinë dhe madhështinë e vet. Syri i secilit është tek froni dhe kurora. Për ta marrë fronin vëllai vret vëllanë. Për interes, prindi ia vë prangat të birit. Vetëm e vetëm për të qëndruar në pushtet, djali i bëhet komandant në ushtrinë e armikut! Sot në Spanjë nuk ka as një pëllëmbë toke që nuk është larë me gjak! Më duket se kiameti është afër? (*Pasi e sheh Ridvanin*) Ah! Ridvan!

RIDVANI: (*Duke hyrë nga dera*) Oj atdhetare! Atdhetaria arabe e humbur sot tek meshkujt, si duket paskësh gjetur vend tek ti?

FATMA: Ridvan pas dhjetë ditësh... apo? Pas dhjetë ditë do të martohemi apo jo!

RIDVANI: (*Me dëshpërim*) Jo.

FATMA: Jo! E përse!

RIDVANI: Tani nuk është më koha për martesë, por për vdekje.

FATMA: Ridvan!

RIDVANI: E pra, ku është ajo atdhetaria jote e pakmëparshme? Fatma, më parë edhe unë kisha frikë nga vdekja, kisha dëshirë për të jetuar. Mirëpo ato kohëra tani nuk janë më. Tani lumturia më e madhe për ne është vdekja.

FATMA: Ridvan! Çfarë po thua kështu? Ç'është kjo punë? Ah! Vdiqa!

RIDVANI: Mos Fatma, mos ki frikë. Nëse kemi fat, do vdesim që të dy. Ty të pret kjo shpatë, ndërsa unë bie dëshmor nga dora e armikut në dyert e al-Hamras!

FATMA: Ridvan, do t'ma marrësh shpirtin! Ma shpjego çfarë do të thuash?

RIDVANI: Fatma, përse frikësohesh? Unë dua të të jap shpresë. Ndërsa ti më duket se ke frikë nga vdekja? Jo Fatma, jo, mos u frikëso nga vdekja. Sepse që nga sot vdekja për ne është një fatbardhësi! Ajo nga e cila unë kam frikë sot është jeta, e jo vdekja! Po po, jeta! Sepse nëse mbesim gjallë, si do të jetojmë? E di ti këtë? Unë me siguri do jem nën pranga dhe në qeli! Dritën e diellit nuk do ta shoh deri në vdekje! E ti do jesh robinjë! Skllave! Do të shitesh nga dora në dorë, si të jesh kafshë! Do të jesh nën mëshirën e priftërinjve dhe të kalorësve të pamëshirshëm!

FATMA: Ah, Ridvan ç'po më ndodh mua! Ah!

RIDVANI: Mos Fatma, mos! Mos u shqetëso! Zoti është i madh! Nëse do ai, ne as nuk do të vdesim, e as nuk do të bëhemi robër...

FATMA: Unë nuk kam frikë as nga vdekja e as nga jeta! Vetëm nga ti mos të ndahem dhe ose të jetojmë bashkë, ose të vdesim së bashku!

RIDVANI: Po, nëse vdesim do të vdesim bashkë! Nëse vendi pushtohet nga armiku dhe unë detyrohem të vdes, së pari me duart e mia të mbys ty! Sepse nuk dua që ti të mbetesh në duart e armikut! Por, nëse ka mundësi të shpëtojmë, atëherë do të jetojmë së bashku. Mund të shkojmë në Marok, në Allgjer, në Egjipt. Shkojmë në Buhara, në Stamboll. Shyqyr Zotit që vendet islame janë të shumta. Nëse pushtohet Andaluzia, le të rrojnë vëllezërit mysli-manë! Edhe ashtu flamuri i osmanlinjve është duke u valëvitur në muret e Vjenës!

FATMA: Por Ridvan, më thuaj si është puna? A është duke ardhur armiku, apo ka ndodhur ndonjë bela?

RIDVANI: Në fakt edhe ashtu nuk ka ditë pa bela. Si është e mundur që mos të ndodhë e keqja kur në udhëheqje kemi kaq njerëz të ligj? Tani mendon se Granada do ta mbrojë islamit? Zaten edhe ashtu i ati i ka shërbyer ushtrisë së armikut! Atëherë çfarë mund të pritet nga një njeri i tillë? Por pa dyshim që Zoti i madhërishëm ia jep çdokujt dënimin e merituar. Edhe Ebu Abdullahu Ez-Zagëlli e harroi atdheun e tij dhe i shërbeu armikut në dëm të popullit të vet, por pas tij i pati punët pisk dhe nga ndërgjegjja e vrarë, iku në

Marok. Por Emiri, atdhetar i Marokut, për tradhtinë që ky bëri, si ndëshkim, ia nxori të dy sytë.

Prandaj ky farë Ez-Zagëlli, që dikur mbretëronte në Al-Hamra, sot është lypsar nëpër rrugët e Marokut! Mbase edhe këtë Es-Safir e pret i njëjti fat.

FATMA: Domethënë ka rebelim apo kryengritje kundër Es-Safirit...

RIDVANI: Kishte.

FATMA: Po tani?

RIDVANI: Jo, tani nuk ka. Tani nuk është koha e tij, por koha e sulmit të armikut kundër nesh.

FATMA: Si?

RIDVANI: Ferdinandi dhe Izabela kanë dërguar diplomatët dhe kërkojnë nënshtrimin e Es-Safirit dhe dorëzimin e Granadës.

FATMA: Po çfarë thotë Es-Safiri?

RIDVANI: Çfarë ka për të thënë ai? I poshtri! Sa nuk e pranoi. Por shyqyr që ka akoma atdhetarë. Musa Bin Ebul-Gazeni... Ai hero i Granadës, trim dhe atdhetar, u ngrit në këmbë dhe *“jo - tha, - nuk bën dot. Ti nëse dëshiron ta pranosh, shko dhe bëhu shërbëtor i Ferdinandit dhe po të duash bëhu edhe oficer i tij dhe na sulmo. Ne nuk e pranojmë. Sepse e pamë se çfarë trajtimi iu bë myslimanëve në ato qytete*

që u dorëzuan. Prandaj nuk duam që vëllezërit tanë myslimanë të bëhen robër. Ne jemi për ta mbrojtur atdheun. Nëse del nevoja edhe do të vdesim bashkë me ta." Shumë atdhetarë, pas këtij fjalimi të Musait, dhanë betimin se ishin të gatshëm për të vdekur në mbrojtje të atdheut... Dhe njëri nga ata që u betuan, jam edhe unë!

FATMA: Edhe ti Ridvan, ëëëë?

RIDVANI: Po, i dhashë besën Musait, se do të vdes për atdheun. Dhe nëse i shpëtoj luftës, të jap besën edhe ty se do të jetoj vetëm për ty... Por, nëse nuk mund t'i iki vdekjes, do të vdes. Po që se nuk kam rrugë tjetër veç të kalbem në burgjet e armikut, më mirë të vdes.

FATMA: Ah, Ridvan! Nuk di çfarë të them? Sikur të thoja mos shko... Jo, nuk mundem! Një fjalë e tillë nuk mund të dalë nga goja e një vajze arabe! Shko dhe shlyeje borxhin ndaj atdheut. Mos m'i shiko lotët e mi... Mos të të mendojë vajtimi im. Shko, o trimi im! Nëse e shpëton atdheun tonë, atëherë kthehesh si hero dhe shihemi... Por nëse ti vdes... nëse ti vdes për atdhe... edhe unë... edhe unë do të vdes duke vajtuar për ty.

RIDVANI: Jo, jo, Fatma... Si mund të shkoj. Ma jep dorën të ta puth... Ndoshta kjo do të jetë hera e fundit dhe nuk do të shihemi më! Ah, Fatma, ah!

FATMA: Ah, Ridvan! Aman o Zot! Mos vallë para një ore unë të nxita që të shkoje? Ah! Unë gabova! Nuk isha në vetë! Të lutem, edhe vetëm dy minuta!

RIDVANI: Fatma! Edhe dy ditë të jem pranë teje, më duken sa një minutë! Unë mund të rri sa të duash. Por më lejo që të shkoj. Fatma, është gjendje e rrezikshme! Unë nuk dua askënd dhe asgjë më shumë se ty, përveç... atdheut që e dua sa ty... Si thua ti? Ta dua edhe atdheun? Nuk bëhesh xhelozë, apo jo?

FATMA: Jo nuk bëhem. Edhe unë e dua atdheun njësoj sa ti... Por ja që më ra ndërmend diçka. Sikur ta them, nuk zemërohes?

RIDVANI: Hajt, ma thuaj.

FATMA: Unë sa e dua atdheun po aq të dua edhe ty. Nëse beson se mund ta shpëtoni vendin, shkoni dhe luftoni. Sepse nëse ti vdes, pas teje nga vuajtjet dhe mundimet do vdes edhe unë por, të paktën, na shpëton atdheu. Bëhemi dëshmorë të kombit! Mirëpo nëse dyshon se atdheu edhe ashtu do të pushtohet, atëherë përse të vdesim kot? Përse të shoh edhe pushtimin e vendit, edhe vdekjen tënde! Ah, Ridvan! Ah! Nëse nuk të dhimbset vetvetja, ki mëshirë për mua!

RIDVANI: Fatma, ti ke vetëm një faj... Dhe ky është vetëm se je grua. Gruaja sado që të jetë guximtare, mundet nga mëshira. Mendjen e ke të fortë, por shpirtin të butë... Fatma, nëse na mbetet që këtë vend të shenjtë ta shohim të pushtuar nga armiku, shtëpitë dhe gjithë pasurinë në duart e armikut, djemtë, vëllezërit dhe baballarët në shërbim të armikut, nga minaret të dëgjojmë zërin e kambanave dhe vajzat tona, të cilat deri tani nuk i ka parë askush as me sy, t'i shohim nën thundrën e armikut... vdekja në luftë për atdheun është një mije herë më mirë.

FATMA: Ah, Ridvan! Po sa mizor që je! Mendon vetëm për veten tënde! Tani është e qartë se nuk më dashke sa të dua! Por s'ka gjë.

RIDVANI: Unë!

FATMA: E ke për detyrë që të më mbrosh. Jam e fejuara jote... Ti do vdesësh për atdheun dhe shpëton, po unë? Kë të vajtoj unë, ty apo veten?

RIDVANI: Fatma! Po unë të thashë. Sikur mos të të doja dhe sikur mos të ishte e fejuara ime, vdekjen për atdheun do ta bëja me mburrje dhe krenari të pashoqe. Do të vdisja pa menduar fare për asgjë. Por dashuria për ty është e njëjtë me dashurinë për atdheun. Dashuria për atdheun më fton drejt vdekjes, ndërsa ajo ndaj teje, për jetën. Musasë ia dhashë besën se do të vdes për vatanin. Ndërsa ty, të betohem se do të jetoj vetëm për ty. Ti mos ki frikë fare. Se do të bëhet ashtu si e ka shkruar Zoti. Ose do vdesim bashkë, ose do jetojmë së bashku. Kaq!

FATMA: Sikur të ndodhte njëra nga këto!

RIDVANI: Tani më jep leje... Shokët më presin... Eja të përshëndetemi.

FATMA: Ndoshta ky do të jetë takimi ynë i fundit! Ndoshta kësaj radhe do të përshëndetemi përgjithmonë!

RIDVANI: Jo. Nëse do Zoti, do të shihemi përsëri!

FATMA: Zoti ju ndihmoftë në shpëtimin e atdheut dhe na mundësoftë që të shihemi përsëri! (*Ecën për ta përqaftuar. Hasani hyn nga dera.*)

Skena e dytë

Fatma – Ridvani – Hasani

HASANI: (*Duke hyrë nga dera*) Urdhri i shpallur për shpëtimin e atdheut është i pakuptimtë! Nëse derti juaj është ky, atëherë harroni se do të shiheni edhe një herë.

FATMA: AH!

RIDVANI: Hasan!

HASANI: Ridvan! Nëse të është mërzhitur jeta, kjo është diçka tjetër.... Por nëse vërtet mendon se atdheu mund të shpëtohet, atëherë madje është mirë që këtë mos ta thoni gjatë, se do qeshin me ju... Kastilja, Aragona, Portugalia, Lioni, Napoli, Sicilia, Papati, Gjermania ose thënë më hapur, sot e gjithë Europa është kundër nesh. Që të gjithë duan largimin e arabëve nga Spanja. Asnjëri nga shtetet afrikane nuk ka mundësi të na ndihmojnë. Si do të rezistojmë ne ndaj gjithë këtyre armiqve? Edhe ashtu kur themi ne, kush jemi? Granada, një qytet i rrethuar nga të katër anët me vende armike!

RIDVANI: Qëndresë nuk mund të bëhet përderisa ky qytet ka qaq njerëz të poshtër, tradhtarë dhe të pandershëm, ashtu si ti.

HASANI: Do të shohim sesa do të vlejë atdhetaria juaj. Ajo që ju mashtroi juve, është oratoria e Musait. Po kush është

ky i quajhuri Musa? Një njeri të cilit i është mërzhitur shpirti dhe jeta, një njeri pa shtëpi, rrugaç...

RIDVANI: Hesht! I poshtër! Nuk të takon ty që Musanë ta zësh në gojë! Sikur vendi ynë të kishte edhe ca të tjerë si Musai, jo vetëm që do ta mbronim Granadën, por mbase si ai i vjetri, Musa bin Naseri, do të ishim të zotë që ta ripushtonim Spanjën. Ndërsa ju, të pafytyrët, sot dorëzoheni pa derdhur asnjë pikë gjak, për këtë vend ku stërgjyshërit tanë luftuan dhe u flijuan, e ndërtuan dhe e arsimuan.

HASANI: Kjo qëndresë e pakuptimtë është rezultat i padi-turisë sate. Mua nuk më duhen këto që thua ti, por dua të të jap ca këshilla...

RIDVANI: Ti t'më japësh mua këshilla!

HASANI: Mbase këtë vend do ta pushtojë armiku. E ata që do t'i rezistojnë, ose do të vdesin kot së koti, ose do të kapen rob. Për këtë arsye, nëse ti dëshiron të vdesësh apo të kapesht rob dhe ta humbasësh tërë pasurinë, shko dhe iu bashkëngjij Musait. Dhe në të kundërt, nëse dëshiron të jetosh, të ruash pasurinë dhe të jesh i lirë, eja që tani, menjëherë, t'i japim votën sundimtarit tonë të ardhshëm, duke dëshmuar kështu mirëkuptimin tonë dhe të përcaktojmë në këtë mënyrë fatin dhe të ardhmen tonë.

RIDVANI: T'ia japim votën armikut? Të bëhemi mirëkuptues me armikun duke e tradhtuar vendin, popullin dhe fenë? T'ia kthejmë shpinën popullit e atdheut dhe të mendoj-

më vetëm për shpëtimin dhe të ardhmen tonë? Hasan, çfarë po thua kështu?

HASANI: Unë e kam përcaktuar fatin tim dhe nuk dua të mendoj shumë për ty. Ti bëj çfarë të duash! Por jam duke menduar vetëm për motrën time. Nëse ti mendon t'i rezistosh armikut, atëherë ata duke e trajtuar motrën time si gruan tënde, ose do ta mbysin, ose do ta marrin robinjë. Prandaj, sikur vetëm për këtë, ti që tani lëre motrën time dhe pastaj bëj ç'të duash...

FATMA: *(Duke vrapuar përkrah Ridvanit)* Amani të qoftë, Ridvan!

RIDVANI: I poshtër!

FATMA: Hasan, të lutem, mos u merakos fare për mua... A jam unë e fejuara e Ridvanit? Jo, nuk ndahem nga Ridvani... Le të më vrasin, le të më zënë rob, në rrugë le të mbes, vetëm e vetëm ta dinë që jam e fejuara e Ridvanit, gruaja e tij. Le të jetë ky fati im dhe unë do të mburrem me të! Ti mos mbaj hallin tim dhe mos mendo për mua!

HASANI: Do të bësh ashtu si them unë. Jam në vend të babait tënd dhe të kam si amanet me testament.

FATMA: Jo! Testamenti im është sheriat. Dhe sheriat mua më ka dorëzuar tek Ridvani.

HASANI: Jo, kanuni i mbretit Ferdinand do të të dorëzojë ty te dikush tjetër.

RIDVANI: (*Me zemërim të madh*) Tradhtar i poshtër!

FATMA: Ah, ti o i mallkuar, kështu mendon për mua, apo jo? Jo, jo, ti mendon vetëm për veten tënde dhe për Lionorën!

HASANI: Lionora!..

RIDVANI: Lionora!.. (*Nxjerr shpatën*) Ah!.. Më lër ta mbys këtë tradhtar...

FATMA: (*Pasi hyn në mes të të dyve*) Të lutem Ridvan, se e kam vëlla!

RIDVANI: Jo, ky nuk është vëllai yt! Ky është tradhtar, kundërshtar! Sikur të ishte vëllai yt, atëherë në gjakun e tij do të kishte qoftë një për qind të atdhetarisë sate... I pafytyrë, tradhtar! Ah, o Zot! A thua se atdhetarizmi tek arabët u zhduk i tëri? Ky gjak i trashëgimtarëve a nuk është gjak i të parëve tanë atdhedashës? Apo mos vallë ka ardhur koha e shkatërrimit dhe e zhdukjes? Ah, sa keq, vaj medet për ne!

HASANI: (*Me vete*) Lionorë, si duket e paskan kuptuar!

FATMA: Ridvan! Të lutem shumë Ridvan, lëre le të bëjë çfarë të dojë. Dhe ti shko, se po të presin. Për mua mos ki merak fare! Unë deri në ditën e kiametit do të jem bashkëshortja jote besnike! Dashuria ime për ty nuk do të humbasë kurrë! Shko dhe dashuria jote le të bëhet dritë. Ishallah bashkohemi! (*Ridvani del.*)

HASANI: (*Me vete*) E paskan diktuar! (*Me zë të ulët*) Fatma...

FATMA: (*Me hidhërim*) Jo, nuk të dëgjoj! (*Dëgjohen krismat e pushkëve dhe topave*) Kuku! (*Del.*)

Skena e tretë

Hasani (dhe pastaj) Lionora

HASANI: (*Me vete*) Ia nisën... Dikush vret e dikush vritet. Dikush kthehet si ngadhënjimtar e dikush bie dëshmor! Ndërsa unë rri si grua në këtë dhomë! Edhe fëmijët pesë-mbëdhjetëvjeçarë i kanë rrokur armët në dorë dhe kanë marrë rrugën për në frontin e luftës. Ndërsa unë dëgjoj nga larg gjëminin e topave! Ah, o vatan i dashur! O fe e shenjtë! O popull i bekuar! Po ç' të keqe pashë nga ju unë, që tani t'ju tradhtoj e mos të jem ashtu si ju! Ah, o Ridvan! Ti je trim dhe mëmëdhetar! Po sa shumë që të dëshpërova! Çfarë gabimi të madh bëra unë! (*Përsëri dëgjohet krisma e topave.*)

Ah, gjylet e këtyre topave bien mbi trupat e vëllezërve të mi! Vallë, përse nuk shkova edhe unë. Sikur të shkoja e të më kapte ndonjë gjyle që t'më hiqte qafe nga kjo botë! Ah, Lionora, ah! Ah, o katile! Ti je ajo që më solle në këtë gjendje! Më mirë mos të të kisha parë dhe të mos dija asgjë për ty! Si ndodhi që rashë në dashuri me ty! Ty ta fala dashurinë dhe ti tani më tërheq prej hunde! Kuku, ja erdhi Lionora!

LIONORA: (*Pasi hyn brenda nga dera për të parë se a është dikush*) Don Alfons!

HASANI: (*Me frikë*) Don Alfons! Alfonsi!

LIONORA: Ç'ke që u trembe? Mos vallë pse të thirra Don? Mos ki merak se ti do ta marrësh titullin e Donit. Këtë ta ka

premtuar Ferdinandi. Do të ta japë sapo të hyjë në Granadë. Prandaj mos ki dyshim fare Alfons, se këtë titull njëkohësisht do t'ia japë edhe babait...

HASANI: (*Duke u trembur e dridhur edhe më shumë*) Alfons!

LIONORA: Aaa! Si duket ty nuk të pëlqen emri Alfons? Eee, ti vetë e kërrove... tani si të të quajmë, Hasan?

HASANI: (*Me vete*) Ah, o emër i bekuar! Po ç' të keqe pashë nga ti që ta mohoj?

LIONORA: Ah, po sa i pashpirt qenke! Unë për ty, më shumë se një vit, ditë e natë i i bëra ballë qëndrimit të prindit tim. Sikur Granada të mbetej në duart e myslimanëve, unë pa e pyetur fare as prindin tim, as kardinalin, madje as papën do të vija tek ti... Do ta braktisja edhe babin dhe gjithë farefisin tim dhe do të bëhesha pre e dashurisë sate... Ndërsa ti tani, për fatin dhe lumturinë tonë, mërzitesh prej emrit Hasan!

HASANI: Ah, Hasan! Hasan është emër i bekuar! Madje edhe më i mirë dhe më i ëmbël më duket, kur këtë e dëgjoj nga goja jote. Ndërsa emri Alfons edhe nga goja jote kur del Lionorë, akoma më duket i ftohtë! Andaj Hasan, Hasan më thirr Lionorë, e jo Alfons!

LIONORA: Ah, e mjera unë! Jam e pashpresë! Ju nuk munda t'ju bind. Ty vetëm edhe dy a tri ditë mund të të thërras Hasan. Po pastaj? Pastaj vetëm dikush le ta dëgjojë, do të na zhdukin që të dyve! O Hasan.....

HASANI: Oh Hasan, Hasan... Po sa emër i mirë!

LIONORA: Hasan, unë nuk mund ta di sesa më do ti. Por nëse puna vjen deri aty sa ne duhet të ndahemi, unë parapëlqej vdekjen. Madje, ndoshta edhe do të vdisja menjëherë...

HASANI: A nuk e di sesa të dua? Ajo që më solli në këtë gjendje, a nuk është dashuria ime ndaj teje? Ah, Lionorë! Po si nuk e kupton dot se ajo më mbylli në këtë dhomë që të rri si një grua, kur vëllezërit e mi në beteja luftojnë për jetë a vdekje, është dashuria ime ndaj teje? Ah, Lionorë ah!

LIONORA: Hasan, Granadën do ta marrë Ferdinandi. Prandaj që nga ajo ditë në këtë vend do të udhëheqin katolikët. Autoritet vendimmarrës do të jetë Inkuizicioni. Prandaj nëse mendon që mos ta fshehësh emrin Hasan, atëherë duhet të arratisesh patjetër, se përndryshe do të zihesh rob. Nëse arratisesh, atëherë zor se mund të shihemi edhe një herë. Ndërsa nëse të zënë rob, nuk do të kesh guximin as të më shikosh në sy, ndërsa unë as një fjalë që ta them! Sepse nëse diktojnë dashurinë tonë, na djegin që të dyve! Hasan! Pash Zotin Hasan! Në emër të së ardhmes sonë, në emër të jetës sonë të përbashkët, pranoje emrin Alfons!

HASANI: Jo! Nuk mund ta pranoj...

LIONORA: Ah, o Zot! Hasan! Po ç'je duke thënë ore? U premtuam prindërve tëmi. I shkruam Ferdinandit dhe ai do të ta sjellë titullin e Donit...

HASANI: Jo nuk dua! As titullin e Donit, as...

LIONORA: Hasan! Për çfarë po mendon? Çfarë do të bësh? Do të më lësh mua? A nuk më do mua? Apo, mos vallë ke hequr dorë nga unë?

HASANI: Ty nuk mund të të lë! Nga ti nuk mund të heq dorë! Ah, Lionora! Ah!

LIONORA: Nëse jo nga unë, atëherë duhet të heqësh dorë nga emri Hasan... Sa kohë mban këtë emër, nuk ka mundësi të na plotësohen dëshirat tona. Hasan! Sikur të varej vetëm nga unë, atëherë do të të doja me çfarëdo emri që të kishe. Madje, me emrin Hasan do të të doja edhe më shumë. Sepse jam mësuar që të të thërras me këtë emër dhe për mua është emër më i bukur dhe më i dashur... Por... Ja që kjo nuk varret prej nesh... Hasan, ky vend do të jetë nën sundimin e Inkuizicionit. Nëse më do dhe nuk dëshiron që të ndahesh nga unë, nëse e do lumturinë tonë, atëherë duhet të heqësh dorë nga emri Hasan. Sidoqoftë, nga njëra, o nga unë o nga emri Hasan, duhet hequr dorë... Unë nuk di rrugë tjetër. Nëse di ti zgjidhje tjetër, ma thuaj.

HASANI: Jo... Nuk ka rrugë tjetër... O do të mbes Hasan... O do të heq dorë prej teje!

LIONORA: Të heqësh dorë nga unë!

HASANI: Lionorë! Lionorë! Jo, jo, unë nuk mund të heq dorë nga ti! Jo kurrësi! Mund të heq dorë nga çdo gjë tjetër në këtë botë, madje edhe nga jeta, por jo edhe nga ti! Jo, Lionorë, nga ti nuk mund të heq dorë! Ah, po si mund ta bëjë unë këtë! Ah, moj Lionorë! Të lutem edhe njëherë mos m'i përmend këto fjalë!

LIONORA: Nëse mendon kështu, atëherë duhet hequr dorë nga emri Hasan.

HASANI: Për ty jam në gjendje që të bëj gjithçka... Unë jam i gatshëm ashtu si thua ti të bëj... Dhe ja, po heq dorë nga emri.

LIONORA: Duhet të pranosh emrin Alfons.

HASANI: Po, e pranova!

LIONORA: E pranove apo jo? Ah, shpëtua!

HASANI: Po e pranova ose thënë më troç, ti më shtyve që ta pranoja. Sepse dëshira, dashuria dhe pëlqimi nuk janë më në duart e mia, por në të tuat dhe mund të bësh ashtu si do vetë ti.

LIONORA: E pranove me të vërtetë. (*E kap përdore. Hasani ia merr dorën*) Oh bre! Shumë faleminderit. Shpëtua! Tani më nuk do të kemi kurrfarë frike! Ti do të jesh burri im e unë gruaja jote! Unë do të jem Dona Lionora e ti Don Alfonsi! Oh, lavdi Zotit! Unë tani do iki. Të shkoj të njoftoj babin tim për këtë sihariq. Mirupafshim. (*Del.*)

Skena e katërt

HASANI: (*Me vete*) Unë... Alfonsi! Alfons... Emrin tim që ma kanë vënë prindërit e mi, tani... Tani pas njëzet e pesë vitesh më duhet ta lë atë emër të bekuar me të cilin u mësua dhe të zgjedh emrin Alfons! E përse? Vetëm për shkak të lakmisë ndaj një titulli të kotë si ky i Donit! Jo, jo! Hasan,

mos u mashtro! Por jo! Ajo që më mashtron mua, nuk është titulli i Donit, as pasuria, as fama... Ajo që më mashtron mua është Lionora, Lionora! Lionorën nuk mund ta lë! Prej saj nuk mund të ndahem! Ah, Lionorë, oj Lionorë! Nëse një orë nuk të shoh, bëhem si i çmendur. E si bëhet po të jem i ndarë përgjithmonë nga ti! Ah, o Zot, ti më krijove kaq zemërbutë... Ti je ai që ma fute dashurinë e saj në zemrën time! Më fal! Më fal, o Zot! Ja që u pajtova! E pranova emrin Alfons! E tradhtova fenë time, popullin dhe vendin tim! Çfarë të bëj? Kjo s'varet nga unë! Zgjedhja nuk është imja! Nuk jam nga ata që mund ta kundërshtoj atë që thotë Lionora! Ajo ngadhënjeu ndaj ndërgjegjes sime! Ajo e mposhti ndërgjegjen time. Tek unë tani më nuk mbeti asnjë zgjedhje, asnjë dëshirë, asnjë vullnet për jetë! Jam thujse në një gjendje të pashpirt. Qendra shpirtërore për çdo mendim dhe veprim, më është zëvendësuar me Lionorën! Ah, Lionorë, oj Lionorë!

Skena e pestë

Don Pedro – Hasani

DON PEDRO: *(Duke hyrë nga dera)* Don Alfons! Deri tani nuk isha në gjendje të të thërrisja kështu. Megjithëse e kishe pranuar emrin Alfons, ti përsëri e doje emrin Hasan. Ta themi troç, ishe në mëdyshje... Apo jo?

HASANI: *(I shastisur)* Unë a! Po, po.

DON PEDRO: E pra, nëse e pranon, atëherë ja pra, urdhëro dhe merre dekretin si dëshmi e gradimit në titullin e Donit! *(Nxjerr një letër nga xhepi)* Këtë dekret ma dërguan para dhjetë ditësh mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Izabela. Merre

këtë dhe tani e tutje je Don Alfons. Dhëntë Zoti e hyn në rangun e ministrave të mbretit Ferdinand! (Ia jep dekretin.)

HASANI: (*Me vete*) Ah! Ç'është duke thënë ky, ore? Ç'janë këta tituj: Don! Ministër! Pse, për këto gjëra të kota e zgjodha tradhtinë? Mos vallë unë hoqa dorë nga vendi dhe populli im për t'i shërbyer Ferdinandit dhe Izabelës? Unë...

DON PEDRO: Ti do jesh dhëndri im.

HASANI: Dhëndri yt!

DON PEDRO: Po, burri i Lionorës!

HASANI: Unë do të jem burri i Lionorës! Unë! Me të vërtetë! Don Pedro, a ma jep besën?

DON PEDRO: Po, ja ku e ke besën! Lionorën ta dhashë ty. Lionora të dashuron ty. Të do... U bënë tre vjet që ajo të dashuron. Edhe pse u mundova që ta bindja të hiqte dorë, nuk munda. Deri tani nuk mund të ta jepja. Por meqë tani quhesh Alfons, mund të ta jap. (*Hasani rrëqethet.*) Tani që u bëre edhe Dukë. Do t'jesh edhe dhëndri im. Do ta fejoj vajzën time. Do të ta jap ty vajzën time! (*E kap për dore Hasanin.*) Po dridhesh, Alfons!

HASANI: Ah! Nuk e di se ç'kam!

DON PEDRO: Dekretin fute në xhep. Ruaje. Edhe nja dy a tri ditë duhet ta mbash të fshehur, derisa të pushtohet Granada. Pastaj do të ndërrosh edhe këtë kostum. Do të veshësh rrobat e një Duke.

Skena e gjashtë
Hasani – Don Pedro – Rafaeli

RAFAELI: *(Duke hyrë nga dera)* Baba! Myslimanët janë duke u mposhtur. U tërhoqën brenda në kala. Ndërsa ushtria e Ferdinandit e ka rrethuar kalanë! Të gjithë janë duke vrapuar drejt El-Hamras. Më duket se Es-Safiri dëshiron të mbajë përsëri një kuvend.

HASANI: Ah!

DON PEDRO: Tani Es-Safiri le të mbajë mbledhje sa të dojë. Kur qyteti pushtohet një herë, çdo gjë ka mbaruar. Oh! Të falënderoj o Zot! Don Alfons, a u gëzove? Nesër a pasnesër në fronin e El-Hamras do të shohim Ferdinandin me Izabelën! Oh, sa mirë! Dëshira na u plotësua!

RAFAELI: Don Alfons!

DON PEDRO: Si nuk e di ti? E ke kunat tani.

RAFAELI: Kunat e kam! Dhëntë Zoti e inshalla edhe unë bëhem kunati i tij!

HASANI: Çfarë the?

DON PEDRO: Çfarë the, o bir?

RAFAELI: Bëra një lutje që të më pranohet dëshira.

HASANI: Jo, jo, ti deshe të thuash diçka!

DON PEDRO: Hajt, përsërite edhe një herë atë që the.

RAFAELI: Ëë... jo asgjë. Por nuk e mora vesh mirë, u bëra unë kunati i tij, apo u bë ai imi?

HASANI: Ai imi!

RAFAELI: E pra shumë mirë, meqë unë mund të bëhem kunati i tij, atëherë përse edhe ai mos të bëhet kunati im?

DON PEDRO: Ti e pranon?

RAFAELI: Posi nuk e pranoj. Natyrisht... Aq sa e do Don Alfonsi Lionorën, unë një mijë herë më shumë e dua Fatmën! Një vit më parë e kisha takuar nja dy a tri herë dhe që nga ajo kohë u bëra rob i saj. Por s'kisha guximin t'ia thosha dikujt këtë. Isha besimzi. E çfarë shprese mund të kishte një Rafael ndaj Fatmës në një vend që sundohej nga myslimanët? Por sot puna qëndron ndryshe. Sot zemra ime është plot me shpresa.

HASANI: Po çfarë janë ato shpresa, ore?

RAFAELI: Po e thashë pak më parë. Nëse ti mund të jesh kunati im, atëherë tani e tutje edhe unë mund të bëhem kunati yt. Çfarë të keqe ka këtu?

HASANI: Çfarë thua, ore? Fatma është e fejuar. Ajo do të jetë gruaja e Ridvanit.

RAFAELI: E Ridvanit? Ç'thua kështu? Ti akoma mendon që motrën do t'ia japësh Ridvanit? E di ti se kush është ai?

Njëri nga armiqtë më të përбетuar të mbretit Ferdinand! Vetëm në këtë betejë, nga dora e Ridvanit janë vrarë së paku më se njëqind të krishterë. Pas pushtimit të Granadës mendon se Ridvani mund të jetojë më në këtë vend?

HASANI: Fatma është në duart e tij. Unë nuk kam kurrfarë ndikimi. Ata janë të fejuar. Ajo është lidhur me të.

RAFAELI: E çfarë do të thotë lidhje martese? Çfarë efekti ka sot kurora? Ai gjykatës që bërë lidhjen bashkë me Ridvanin, tani o është diku përtej detit, o është në dhe! Ajo gjykatë ku është bërë ajo lidhje, do të jetë konaku i Kardinalit të madh.

DON PEDRO: Rafael, ku jemi!

HASANI: *(Me vete)* Të lutem, o Zot! Jam shumë keq! Ah! Nuk e di si do t'ia bëj? Është vëllai i Lionorës. Sikur këto fjalë t'i thoshte dikush tjetër, do ta vrisja!

RAFAELI: Përveç kësaj, ku e dimë ne që Ridvani nuk ka rënë në këtë betejë? Ndoshta ai tani është veçse i vdekur.

HASANI: I vdekur?

DON PEDRO: Nëse ka vdekur, është në rregull. Por nëse jo, atëherë ne më mirë ikim prej këtej, që mos të na takojë! Hajdeni të shkojmë!

RAFAELI: Po edhe nëse na takon, ç'të keqe ka kjo?

DON PEDRO: Jo, jo, asgjë. Po mos t'i hapim vetes ndonjë telash të panevojshëm. Ejani të shkojmë! *(Duke dalë, Hasanit)*

Don Alfons, mos na turpëro! Durim! (*Pasi e kap për dore Hasanin, dalin bashkë edhe me të birin.*)

Skena e shtatë

HASANI: (*Me vete*) Ah, ti o derr i çmendur! Sikur mos të ishte babai i Lionorës, tani do të të kisha bërë copë e grimë! Sikur mos të shpresoja tek Lionora, këtë dekret... Këtë copëz letër do ta shqyja dhe do t'ia flakja turinjve! Por çfarë t'i bëj Lionorës. Ajo gjithnjë më del përpara. Nuk mund ta harroj atë. Për Lionorën do të pranoj çdo gjë që më ofrohet! Ndërsa ky farë plaku mizor, që ka qenë pengesa jonë për t'u afruar me Lionorën, sot Lionorën dëshiron të ma japë me kushte dhe kërcënime. Megjithatë, sado të vështira dhe kërcënuese të jenë kushtet, më duhet t'i pranoj. Më fal, o Zot! Ah, ja erdhën! Po nëse vjen edhe Ridvani... e ma sheh këtë dekret... Ah! Më duhet të shkoj... Më duhet të iki... Më mirë të shkoj në shtëpinë e Don Pedros. Nuk kam strehë më të mirë se tek ai... (*Pastaj del.*)

Skena e tetë

Ridvani (pastaj) Fatma

RIDVANI: (*Dorën e majtë e ka të lënduar, hyn nga dera e poshtme*) Ç'u bënë, ore! Ku janë! Hasan! (*Duke vrapuar për tek dera në krahun e djathtë*) Fatma! Fatma!

FATMA: (*Duke hyrë nga dera e djathtë*) Ah, more Ridvan! Je lënduar, apo..?

RIDVANI: Jo, nuk është gjë. Pakëz... Por a e di çfarë ka ngjarë? (*Qan.*)

FATMA: Ç'po ndodh Ridvan? Ç'është kjo? Ti ke shpëtuar, tani përse qan?

RIDVANI: Ah! Po më mirë të vritesha sesa të lëndohesha kështu. Më mirë do ishte që ai plumb të më kapte në kokë, sesa në dorë!

FATMA: Ridvan, ç'është kjo punë? Je mërzhitur nga unë apo çfarë? Gjithnjë parapëlqen vdekjen!

RIDVANI: Ah, Fatma! Sikur të mos ishe ti, do të hidhesha nga kalaja dhe do ta vrisja veten! Çfarë më duhet jeta pasi u mposhtëm dhe atdheu u robërua! A e di ti se e humbëm luftën! Na u vranë shumë luftëtarë, ndërsa ata që shpëtuan, u ngujuan në kala. Armiku e rrethoi kalanë në të katër anët. Unë nuk munda që të hyja i gjallë në kala! Por kur u lëndova, e kisha humbur veten. Më kishin marrë dhe më kishi futur brenda. Kur erdha në vete, e pashë se isha brenda në kala! Tani e tutje më nuk ka selamet! Po sido që të jetë, megjithatë është më mirë të vdesësh nga uria, sesa t'i dorëzohemi armikut! Por Es-Safiri ka caktuar edhe një kuvend... Kam frikë që ai idioti do të na dorëzojë!

FATMA: Ridvan, ti e kreve detyrën tënde. E pagove borxhin ndaj atdheut. Mjafton plaga e plumbit që ke në dorë! Vatani të është mirënjohës. Tani nëse të tjerët e dorëzojnë, fajin nuk e ke ti, por ata që e dorëzojnë. Nëse Granada dorëzohet, ne duhet të provojmë të shpëtojmë veten tonë. S'ke mi më gjë tjetër në dorë!

RIDVANI: Edhe Musai shkoi në kuvend. Do të provojë t'i bindë që qyteti të mos dorëzohet. Nëse pranohet ky qën-

drim për mosdorëzim të qytetit, do të provojmë të qëndrojmë edhe për një farë kohe... Por nëse e dorëzojnë, atëherë së pari do të provoj të të shpëtoj ty e pastaj edhe veten... Mos ki frikë, se do gjej një zgjidhje!

FATMA: Të lutem, Ridvan! Më shpëto mua! A e di ti që unë jam në duart e armiqve!

RIDVANI: Ç' do të thotë kjo?

FATMA: Vetëm kaq të them.

RIDVANI: Fatma mos u bëj si fëmijë! Ma thuaj që ta di?

FATMA: Por ja që të thashë. Nëse ikën ti, unë mbes në duart e armiqve.

RIDVANI: E përse? Hasani ku është?

FATMA: Cili Hasan?

RIDVANI: Yt vëlla.

FATMA: Po ku kam unë vëlla me emrin Hasan!

RIDVANI: Të lutem Fatma, për atë Zot më thuaj... Ç'u bë me Hasanin?

FATMA: (*Me vete*) Ah, Hasan, o Hasan! Çfarë ka bërë ai, e di? I poshtri, u bë Don Alfonsi!

RIDVANI: Fatma!

FATMA: Ridvan, të lutem më lër rehat! Mos këmbëngul më shumë! Ja vetëm kaq po të them: Vetëm ti je ai që mund të më shpëtosh! Gjithë të tjerët i kam armiq! Hajt të lutem, më shpëto nga duart e tyre! Na gjej një zgjidhje..... Na gjej një rrugë..... Na ndihmo, o Zot!

RIDVANI: Ah! Këtu ka diçka! Fatma, kam frikë se do të të humbas ty!

FATMA: Ti sillu me mençuri... Kërko ndonjë rrugë dhe mos ki frikë!

RIDVANI: Ah Fatma! Po si të shkoj unë e ty të lë në rrezik? Të paktën të dija se si qëndron puna, e pastaj të mendoja dhe të merrja masa.....

FATMA: Jo, Ridvan! Nëse do që të më shpëtosh ... Nëse do të mirën time, atëherë është më mirë që këtë tani mos ta dish fare... Ta tregoj më vonë...

RIDVANI: Atëherë të paktën të shkoj sa më parë dhe të kërkoj një rrugë për të ikur...

FATMA: Shko! Zoti të ndihmoftë! Por Ridvan! Ta pashë krahun! Si e ke plagën!

RIDVANI: Mos ki merak... Nuk është keq. Po shkoj, shpirt. Mirupafshim! *(Ia puth dorën dhe largohet.)*

Skena e nëntë

FATMA: (*Me vete*) Ridvan i gJORë! Aq shumë e ka dëmtuar veten për dashurinë ndaj atdheut dhe ndaj meje, saqë e ka harruar veten fare! Ah, Ridvan, ah, Ridvan! Ti je para një humnere të madhe e unë para një rreziku të madh! A thua do të shpëtojme? A thua vallë do të shihemi edhe një herë? Ah! Po përse nuk shkova edhe unë me Ridvanin? Le të vdisnim bashkë! Do të jepnim shpirt në krahët e njëritjetrit! Ah, Ridvan! Më pyete për vëllanë... Për Hasanin... Por të gJORin nuk e kam asgjëkund! Hasanin e kam humbur! Përveç Ridvanit s'kam askënd tjetër! Ah, Hasan, ah, Hasan! Ti tani ke vdekur për mua! Ai që pashë pak më parë, nuk është Hasani, ai nuk ishte vëllai im! Jo, jo! Nuk është! Ai është Don Alfonsi! Don Alfonsi! Nuk do ta besoja sikur mos ta dëgjoja me veshët e mi. Don Alfons! Ah, ti o tradhtar! Por ai ishte Hasani! Ah, Hasan, Hasan! (*Bie mbi minder dhe vajton.*)

Skena e dhjetë

Hasani - Fatma

HASANI: (*Duke hyrë nga dera*) Fatma!

FATMA: (*Duke u ngritur në këmbë*) Hasan! Ah! Jo, jo! Don Alfons!

HASANI: Don Alfons.

FATMA: Po, po, Don Alfons... Nuk të pëlqeu emri Hasan, këtë emër të bekuar me të cilin të quajti babai, por zgjodhe

emrin tjetër Don Alfons... Prandaj dhe unë, pikërisht për këtë të thërras Don Alfons!

HASANI: *(Me vete)* Ah, e paska dëgjuar! Po, sikur mos ta kishte dëgjuar vetëm edhe për një apo dy ditë! *(me dëshpërim)* Motër!

FATMA: Jo! Nuk më ke motër! Unë nuk mund të jem motra e një Don Alfonsi! Unë isha motra e Hasanit. E ti nuk je Hasani, por Don Alfonsi, Don Alfonsi!

HASANI: Fatma! Të lutem më dëgjo...

FATMA: Jo, nuk të dëgjoj dot!

HASANI: Fatma! Armiku është duke pushtuar qytetin...

FATMA: Natyrisht që po e pushton! Po si mund të mbrohet qyteti, kur ka tradhtarë si ti?

HASANI: Nuk dua ta them këtë, por ushtria e armikut...

FATMA: Si thua ti, ushtria e armikut! Jo, ore jo! Ajo ushtri nuk është armike për ty! Por e shenjtë! Ajo ushtri të dhuroi ty titullin e Donit!

HASANI: *(Me vete)* Ah! Po i ditka të gjitha! *(me dëshpërim)* Ushtria e armikut, me të hyrë në qytet, do t'i plaçkitë të gjitha shtëpitë e myslimanëve. Meshkujt që i has, o do t'i vrasë, o do t'i marrë rob!

FATMA: Mbase e bëjnë! Pasi nuk ka kush t'i mbrojë shtëpitë e myslimanëve, sepse ka aq shumë tradhtarë si ti, mbase e bëjnë!

HASANI: Unë tani do t'i marr plaçkat e mia... Dhe do t'i çoj në shtëpinë e fqinjit tonë, sinjor Pedros.

FATMA: Po më mirë sikur të thoshe të Don Pedros se ... Sepse edhe ai është si ti. Për më tepër e ke edhe vjehërr!

HASANI: Vjehërr! (*Me vete*) Ah! Po i ditka të gjitha! (*me dëshpërim*) Edhe ti duhet të vish atje, sepse nëse rri këtu, do të të vrasin...

FATMA: Jo! Ti mos ma qaj hallin mua..... Ka kush më mbron mua! Mua më shpëton Ridvani!

HASANI: Ridvani! Ah e gjora ti! Akoma e ëndërron Ridvanin?

FATMA: Kuku! Çfarë po më thua, ore?

HASANI: (*Me gjakftohtësi*) Ridvani ka vdekur!

FATMA: (*Me shqetësim*) Kuku! Çfarë po thua? Aman o Zot! Po çfarë i ndodhi Ridvanit tim? (*Pasi mendon një çikë*) Hëëëem.. Jo! Është gënjeshtër! Ti gënjen! Ridvani sapo doli prej këtu! Ai ishte këtu!

HASANI: (*Me habi*) Këtu ishte! Tani! Po mirë. Me të dalë nga këtu, e kanë vrarë. A nuk e dëgjove krismën e topave? I ka rënë ndonjë gjyle në kokë dhe...

FATMA: Ah, Ridvan o shpirt! Jo, jo! Kjo është gënjeshtër, është gënjeshtër! Ti o mizor, ti o tradhtar! Ti kërkon të më japësh tek Rafaeli.

HASANI: *(Me vete)* Të gjitha i di! Që të gjitha i paska dëgjuar! *(me dëshpërim)* Po deshe mos më beso, por eja të ikim... Ushtria është duke ardhur, po na takuan këtu, na bëjnë copë e grimë që të dy!

FATMA: Ti shko! Shpëtoje veten tënde... Unë nuk vij... Le t'më vrasin! Dua të vdes këtu!

HASANI: Do vish apo t'u them të të marrin me zor?

FATMA: Ah, tradhtar!

HASANI: Përgjigju.

FATMA: Vij... Por më prit pak... Ose ti fillo me mbledhjen e gjërave.

HASANI: Në rregull... *(Bërtet.)* Hej, o ju! *(Hyjnë ca djem ia nisin grumbullimit, kapin nja dy a tre sëndukë, ca gjëra të tjera dhe fillojnë t'i bartin. Hasani i vëzhgon. Fatma i afrohet tavolinës, shkruan një letër dhe e mban të fshehur në dorë. Një djalë afrohet për të marrë librat.)*

HASANI: Jo, librat le të mbesin.

FATMA: *(Pasi merr në dorë një libër me kapak të bukur nga një tavolinë e vogël)* Të paktën të marr këtë Kuran të shenjtë...

Babai im i ndjerë e ka shkruar me dorën e vetë... Le ta kem si kujtim nga ai!

HASANI: (*Djemve*) Inshalla nuk harruam ndonjë gjë të vlefshme... Ju shkoni.

(*Djemtë dalin.*) Fatma, eja! (Kërkon ta kapë për dore.)

FATMA: Mos më kap për dore, vij vetë. Ti ec përpara. (*Hasani ecën i pari. Fatma e lë letrën mbi tavolinë.*) Ah, o shtëpi e babait tim! Vallë a kam për ta parë edhe njëherë? (*Dalin.*)

(*bie perdja*)

AKTI I DYTË

PAMJA E PARË

(Kur hapet perdja, është e po njëjta dhomë nga akti i parë, disa gjëra dhe shtrojë dyshemeje, si dhe tavolina tavolina me libra.)

Skena e parë

RIDVANI: *(Pasi hyn nga dera, duke shikuar rreth e rrotull)* Nuk është askush! Kanë ikur! Edhe orenditë i paskan bartur! Po ku paskan ikur, ore? Ah! Fatma! *(Duke shikuar nga dyert në dhomat e tjera)* Fatma! O Fatma! Ah! Jo, jo! Nuk është! Po çfarë ka ndodhur kështu! Aman o Zot! Do çmendem! I paskan marrë të gjitha gjërat... Vetëm këta librat paskan lënë. *(Me të parë letrën mbi tavolinë)* Hë, ja një letër! *(Pasi e merr dhe e hap)* Ah, qenka prej Fatmës! *(E lexon):* “*Shpirti im Ridvan. Pasi ike shkove, erdhi Hasani dhe më tha që ty të kanë vrarë. Por unë nuk i besova. E kuptova që ka një dredhi, se përndryshe do të vdisja menjëherë.*” Ah, e mjera Fatma! “*Hasani po më dërgon në shtëpinë e komshiut tonë Pedro. Dhe unë po të lë këtë letër. Nëse vjen në shtëpi, natën duhet të ndezësh një qiri dhe ta lësh në dritaren përballë shtëpisë së Don Pedros dhe vetë duhet të fshihesh. Kur në dritaren përballë në shtëpinë e Don Pedros, do shohësh të ndezur një qiri dhe pas dritës së qiriut më sheh mua, duhet të vish nën këtë dritare. Por duhet të jesh edhe i përgatitur. Me vete merre një litar dhe një sharrë.*”

Një litar dhe një sharrë! Vallë, a thua është burgosur? Apo i kanë vënë prangat? Ah, Fatma ah! Më thoshte se ishte në duart e armikut... Këtu ka ndodhur diçka. E ka dërguar në shtëpinë e Pedros! E përse pikërisht tek ai? Ah, Hasan ah! Të ka çmendur dashuria për Lionorën! Dashuria e Lionorës të la pa fe e atdhe! Tani ka marrë me vete edhe Fatmën! Ah, e mjera Fatma! Po ku je ti? Je në burg? Je nën pranga? Gjithsesi je në duart e armikut! Dhe armiku i parë, nuk është tjetër veçse i vëllai! Ah, o Zot! Të lutem më ndihmo që ta shpëtoj Fatmën! Sot më duhet të rri këtu dhe të përgatis këto që më shkruan në këtë letër. Ndërsa në mbrëmje, në këtë dritare, duhet ndezur një qiri dhe... Zoti na ndihmof-të!... (Del.)

PAMJA E DYTË

(Është natë. Shihet njëra dhomë e shtëpisë së Don Pedros dhe dera e saj e mbyllur. Në të djathtë një dritare me parmak. Në të majtë një tjetër derë po ashtu e mbyllur. Afër njëres derë është një sënduk. Nën dritaren e djathtë me parmak, një minder. Në të dy anët e derës së poshtme shihet nga një xham, një qiri dhe dy sëndukë. Në mur janë të varura nja dy fotografi, ndërsa në minder është ulur Fatma dhe mendon.)

FATMA: (Me vete) Vallë a thua sonte në dritaren e shtëpisë sonë do ta shohim dritën e ndezur? U bënë tri ditë që kemi ardhur këtu. Ditë e natë si në burg! Ah, po kujt i kishte shkruar mendja që unë do të isha e burgosur në shtëpinë e Pedros! Vëllai im... Ai Hasani që më donte aq shumë, ai të më bëhet roje e ferri!

Kurrë s'më kishte shkuar mendja! As Ridvani nuk u duk fare... Ose ka ardhur, por s'e ka gjetur letrën! Apo... Zoti na ruajt. Mos qoftë e thënë t'i ketë ndodhur gjë Ridvanit! Ah, e mjera unë! Ridvani është i vetmi që mund të më shpëtojë nga duart e armikut! Ah, Ridvan, ah Ridvan! A thua vallë kam për ta parë edhe një herë? Ah, Ridvan! Vetëm sikur ta dije se në çfarë halli jam! Mos! Erdhën! Aman o Zot!

Skena e dytë
Fatma – Hasani

(Hasani pasi e hap derën me çelësin e vet, hynë brenda me veshje spanjolle.)

FATMA: *(E trembur tej mase)* Mos! Kush është ky? Kush është ky që hyri në dhomën time? Është xhelati apo dikush tjetër?

HASANI: Fatma.

FATMA: Mos, edhe emrin ma thotë! Je Azraili, Xhelati, apo kush tjetër?

HASANI: Nuk më njeh mua?

FATMA: *(Pasi shikon me kujdes fytyrën e tij)* Aman, o Zot! Po ç'jam duke parë! Hasan! Ç'është kjo veshje kështu!

HASANI: Fatma, ç'është ky fanatizëm... S'del gjë nga veshja. Kroba janë që të gjitha.

FATMA: Mos o Zot! Do çmendem! S'mundem të të shoh në sy! Po ajo në gjoks! Ç'është ajo?

HASANI: Është shenjë e krenarisë që ma dhuroi Mbreti Ferdinand... Është simbol i besnikërisë ndaj shkëlqesisë së tij.

FATMA: Është simbol i tradhtisë! Është shenjë e tradhtisë tënde ndaj vendit dhe popullit!

HASANI: Fatma!

FATMA: Hesht!... Harroje emrin tim!... Shporru nga këtu!...
(Ulet dhe vajton)

HASANI: (Me vete) Ah, o Zot! Po ç'është ky mjerim kaq i madh! Ah mos, vdiqa! (I afrohet Fatmës dhe pasi ia merr dorën me butësi) Moj motër!

FATMA: (Pasi ngrihet në këmbë dhe largohet në anën tjetër) Ah! Po ç'ke ti me mua? Të lutem më lër rehat!

HASANI: (Duke e lutur) Fatma, moj motër! Po ti a nuk je motra ime e dashur! E unë a nuk jam vëllai yt Hasani? Të lutem! Më shiko një herë në sy... Ku shkoi dashuria jonë e mëparshme? Sa shumë që duheshim ne! Unë nuk kam njeri tjetër të gjallë veç teje! E as ti nuk ke askënd tjetër veç meje! Ku shkuan bisedat tona të kaluara! Ti tani më urren! As në sy nuk më shikon.

FATMA: Ah, Hasan! Jo, jo! Ti nuk je Hasani! Ti nuk je vëllai im! Unë nuk kam më vëlla! Jo, jo! Hasani për mua ka vde-

kur! Ah, Hasan a Hasan! Ti tani nuk je më Hasan, por je Don Alfonsi! Don Alfonsi!

HASANI: Don Alfons!

FATMA: Të lutem ik! Mjaftë më hidhërove! Më lër që të bëj një sy gjumë, se ka dy net që nuk kam fjetur fare...

HASANI: Unë të të hidhëroj ty! Unë që të kam rritur në duart e mia pasi vdiqën prindërit e ti ishe e vogël... Kurrë nuk ta kam prishur qejfin. E di këtë? E harrove mundin dhe kujdesin tim?

FATMA: Jo, s'e kam harruar! Dhe s'e harroj kurrë! Unë nuk jam budallaqe o Hasan! (*Sapo nxiton për ta përqaftuar, ndalet në vend dhe kthehet mbrapsht*) Aaa, jo, jo! Ti nuk je Hasani! Ti nuk je vëllai im! Ti je Don Alfonsi!

HASANI: Don Alfonsi! Vëllai i Fatmës!

FATMA: Jo vëllai i Fatmës, por burri i Lionorës.

HASANI: Ah, Fatma! Të lutem ki mëshirë, se s'ka njeri sot që është më fatkeq se unë! Sepse këto rroba unë nuk i veshja nga qejfi, por nga zori.

FATMA: Prej kujt?

HASANI: Nga dashuria!

FATMA: Forca e dashurisë është e madhe. Unë këtë e di.

Por atdhetaria është më e fortë dhe gjithmonë duhet ta mundë dashurinë. Ndërsa tek ti dashuria ndaj atdheut nuk qenka fare! Sikur të ishte fare pak atdhetar, edhe do shpëtoje nga kjo brengë e Lionorës, edhe do t'i shërbeje atdheut! Hasan ke lindur dhe Hasan do të vdisje! Nuk do shkëlqej mbi nderin e të parëve tanë! Nuk do bëheshe horr deri në kiamet! Duhet të të vijë turp! Mendo pak se çfarë baballarësh atdhedashës kishim e çfarë po bën ti tani! Turp! Turp se si je veshur! Shiko atë shenjë në gjoks dhe turpërohu. Shiko më një herë në sy ti, o i pafytyrë! Madje, edhe këtë motër të mjerë që ke, do që ta bësh skllaven e të huajve!

HASANI: Fatma!

FATMA: Mos më fol kot! Nuk të dëgjoj dot! Dil dhe shko! *(Përsëri ulet mbi minder dhe fillon të qajë.)*

HASANI: Fatma! Puna ime ka mbaruar! Unë bëra çfarë bëra dhe ato kanë ikur. Kurse ti tani dëshiron që duke m'i kujtuar gabimet, të m'i hapësh plagët e vjetra? Thuaj se nuk më mjafton ndërgjegjja ime e vrarë dhe ti tani do që t'më mundosh edhe më shumë! Të lutem më thuaj: ç' dëshironi ti?

FATMA: Jo, unë nuk dua asgjë... Jo, unë nuk dua asgjë nga ti dhe nuk të njoh fare. Për mua, vëllai im Hasan ka vdekur. Ndërsa me ty, Don Alfons, nuk kam asgjë... Por ti ç'ke me mua?

HASANI: Dua që të të shpëtoj!

FATMA: Ti mua! Prej kujt do të më shpëtosh? Nëse shpëtimi im varet nga ti, shumë falemnderit!

HASANI: Unë nuk jam armiku yt, por jam vëllai yt!

FATMA: Jo, ti tani je armiku im!

HASANI: Ti nuk e di që qyteti është dorëzuar? Ushtria e Mbretit Ferdinand ka hyrë brenda në qytet dhe është duke vrarë çdo mysliman që i del përpara. Janë duke djegur çdo gjë... Duke marrë robër... Ja pra, unë dua të të shpëtoj nga dora e tyre vrastare!

FATMA: Ti do më shpëtosh? Po ti je njëri nga ata, o tradhtar!

HASANI: Po e saktë, për të të shpëtuar ty u bëra me ta. Prandaj edhe ti, nëse do që të shpëtosh, duhet të bëhesh me ta!

FATMA: Ah, ti tradhtari i keq! Kështu mendon të më shpëtosh mua! Nëse është shkruar që të jetoj, ka kush më shpëton mua! Nëse jo, atëherë do të vdes... Por do të vdes me nder! Unë nderin dhe atdhedashurinë nuk e shes si ti!

HASANI: Ëhë, paske njeri që të shpëton ty! E kush është vallë ai?

FATMA: Ridvani!

HASANI: Shiko, shiko! Akoma mendon për Ridvanin! Eshtrat e tij tani mbase janë bërë hi e pluhur!

FATMA: Mos!

HASANI: Tani po e dëgjon këtë? A nuk ta thashë më parë?

FATMA: Ridvani!

HASANI: Ridvani ishte një djalë jo fort i mençur! Edhe ai, ashtu si ti, i besonte vetvetes çmendurisht dhe e mbyti veten kot së koti. Nuk dëgjoji askënd. Mendonte që e kishim prej inati... Por fatkeqësisht i doli ajo që i thashë... prandaj edhe ty mund të të ndodhë e njëjta gjë...

FATMA: Ah, Ridvan o shpirt! Po ku më le mua? (*Vajton.*)

HASANI: Mos, ti mos u pikëllo, se nuk do të jesh keq... Po kush nuk të do ty? Kush është ai që nuk të merr ty? Don Rafaeli.

FATMA: (*Duke ia ndërprerë fjalën*) Mos më fyej!

HASANI: Është i ri! I pashëm! Paska një vit që qenka dashuruar pas teje!

FATMA: Pa shiko njëherë se çfarë pështjellimi bën ky tradhtar! Ik! Shporru nga këtu! Mos të të shoh më! Nëse ka vdekur Ridvani, atëherë ka rënë dëshmor për këtë vend! Prandaj do të shkoj dhe do të gjej varrin e tij, do të vajtoj mbi hirin e eshtrave të tij e do të vdes edhe unë! Por ti, o tradhtar, shporru nga këtu dhe mos të t'i shoh më sytë!

HASANI: Fatma, unë po mundohem për të mirën tënde...

FATMA: Nuk dua! Jo nuk e dua atë të mirë që vjen nga ti! Ik, largohu nga këtu!

HASANI: Atëherë unë do iki. Por ti mendohu mirë që pastaj mos të pendohesh... *(Del dhe e mbyll derën.)*

Skena e tretë

FATMA: *(Me vete)* Aman o Zot! Në këtë botë vëllai vëllait po iu bëka armik! Po aq shumë sa e doja këtë Hasan dhe po aq shumë sa më donte, tani të më bëhet armik! Çmendesha po mos ta shihja çdo ditë. E tani nuk mund t'ia shoh sytë! Me ta parë, menjëherë fillon të më dridhet trupi! Vallë, a nuk është ky ai Hasan i vjetër? Po si u bë që ndërroi kaq shumë! Thujse ndryshoi njësoj ashtu siç ndërroi edhe petkun! Ky u shndërrua plotësisht! Ky nuk është ai Hasan që ishte! Ah, e gjora unë që e humba Hasanin dhe mbeta pa vëlla! Ah, o Zot! Po sikur Ridvanit me të vërtetë t'i ketë ndodhur diçka.... Ah, si do të jetojë unë pastaj! Dhe me siguri atij i ka ndodhur diçka! Ai nuk është më i gjallë! Ose e kanë zënë rob! Përndryshe do të vinte gjithsesi dhe nuk do të vonohej kaq shumë... *(me të shikuar nga dritarja, e çuditur)* Ah, o Zot! Në dritaren e shtëpisë sonë qenka një dritë! Pas-ka ardhur Ridvani! Oh, o Zoti im i madh! Shpëtuam! Oh, Ridvani! *(Pasi e merr qirinë dhe e vendos në dritaren e djathtë, ndalet para dritares)* Ja, drita u fik! Është duke ardhur! Oh, sa mirë o Zot! Të lutem o Zot, mos ta shohë kush! *(Pasi e mbyll derën nga brenda, i afrohet dritares dhe me krye të zgjatur nga dritarja.)* Ridvani! Ridvani! Ende nuk erdhi! Ah, o Zot! Hë! Ja, është duke ardhur! Ai është! Të lutem, o Zot! Ridvan! Hidhe litarin! Hidhe atë! Hidhe! *(Ridvani e hedh litarin. Fatma e kap dhe e ngre lart. Në litar janë të lidhur një sharrë dhe një limë. Fatma pasi e zgjidh sharrën nga litari, i sharron ngadalë parmakët e dritares dhe pastaj e lëshon njërin skaj të litarit, e lidh*

në dritare dhe skajin tjetër e lëshon poshtë.) Ridvan! Kape dhe lidhu... (Pasi ai lidhet, ajo fillon ta tërheqë litarin lart.) O Zot! Jepu forcë krahëve të mi! (Ridvani me t'iu afruar dritares, me te dy duart kapet në dritare dhe hyn brenda.)

Skena e katërt
Fatma – Ridvani

FATMA: *(Pasi e përqafton)* Ridvan! Oh, shyqyr o Zot që edhe një herë të pashë me sytë e mi! Sa nuk i pata i humbur shpresat për ty! Më thanë që kishe vdekur! Doja të vrisja veten!

RIDVANI: *(Pasi e përqafton)* Ah, Fatma, shpirti im!

FATMA: Po sikur mos të kishe ardhur edhe sonte, nuk do t'më gjeje gjallë! Ah, Ridvan, a Ridvan! U bënë tri net që jam burgosur në këtë dhomë!

RIDVANI: *(Me shqetësim)* E Burgosur a! Ua! E Hasani?

FATMA: Ah, Hasani! Nuk ka më Hasan! Në vend të tij është njëfarë Don Alfonsi! Sepse Hasani është bërë Don Alfons! Prej mbretërisë e ka marrë titullin e Donit. Edhe shenja i ka mbërritur! Është veshur me rroba spanjolle! Do të bëhet dhëndri i Don Pedros, sepse do të martohet me Lionorën!

RIDVANI: Ah, i poshttri! Tradhtari!

FATMA: Më tha se ti je vrarë. Deshi t'më mashtronte për të më martuar pastaj me Don Rafaelin.

RIDVANI: Ah, i poshtri, i pabesi! Rafaelin! Tek Rafaeli donte te të jepte! Fatma, të lutem më thuaj se ku është? Të shkoj dhe ta vras atë tradhtar!

FATMA: Ridvan! Të lutem mos! Falë të qoftë! Mos!

RIDVANI: Ende të dhimbset ai? Ende e shikon si vëlla? Ende e do atë?

FATMA: Jo, jo! Nuk më dhimbset! Nuk e dua... As vëlla nuk e kam! Në këtë botë, veç teje s'kam njeri tjetër! Eja ti dhe ne të ikim! Të shpëtojmë! E ai le të bëjë çfarë të dojë! Nuk është fëmijë...

RIDVANI: Ke të drejtë... Tani është koha që të të shpëtoj ty! Ndërsa atë, nëse është e shkruar, do ta shpëtojë Zoti. E nëse jo, do ta vras.

FATMA: Ah, Ridvan!

RIDVANI: Mirë, tani ne ç' do të bëjmë?

FATMA: Ç' do të bëjmë? S' e ke gjetur rrugën e ikjes?

RIDVANI: Po, po, e kam gjetur. Binda një rojtar duke e paguar. Të gjitha paratë dhe gjërat e tjera të vlefshme që pata në shtëpi, i mora me vete. Gjysmën ia dhashë rojës dhe gjysmën tjetër e kam me vete. Nuk dihet, mund të na duhen për ndonjë rast tjetër. Por fatkeqësisht, ne nuk do të mund të ikim së bashku.

FATMA: Mos!

RIDVANI: Ti do të shkosh me njerëzit e mi të besuar. Sepse jashtë ka ushtarë dhe mua më njohin.

FATMA: E nëse do të jesh vetëm, nuk do të njohin? E si mund të shkosh vetëm?

RIDVANI: Edhe nëse më njohin, unë iki. Nuk mund të më kapin dot. Ndërsa vendin e takimit tonë ua kam treguar njerëzve të mi.

FATMA: Ah, Ridvan, siç duket do të ndahemi përsëri!

RIDVANI: Jo, jo, mos ki merak, se do të takohemi përsëri. *(E kap për dore.)* Por si t'ia bëjmë me këto rrobat tona? Duhet t'i heqim këto. Ka këtu ndonjë veshje spanjolle? Po sikur ta hapnim këtë sënduk.

FATMA: Po, po, mund të ketë brenda në sënduk. Po si ta hapim se?

RIDVANI: *(Pasi i afrohet sëndukut)* Prit. *(Nxjerr thikën dhe pasi mundohet pak, sënduku hapet.)* Hë, tamam. *(Në të janë ca kostume burrash dhe veshje grash.)* **FATMA:** Ja këto janë për mua. Ndërsa ky... *(merr një komplet dhe fillon ta veshë.)*

RIDVANI: *(Pasi zgjedh një takëm)* Ndërsa ky takëm është për mua *(Fillon ta veshë.)*

FATMA: *(Pasi është veshur)* Gati jemi apo jo? *(Rrobat e mbe-tura i kthen në sënduk dhe e mbyll atë.)*

RIDVANI: Gati jemi, të ikim...

FATMA: Të ikim!

RIDVANI: Eja së pari të të zbres ty. (*Pasi e lidh Fatmën me litar, e lëshon nga dritarja. Pastaj lëshohet edhe vetë me litar, të cilin e ka lidhur fort në shufrat e dritares.*)

Skena e pestë

Hasani - Don Pedro - Lionora

(*Nis të agojë*)

(*Hasani i afrohet derës dhe mundohet ta hapë, por me ta kuptuar se dera është mbyllur, thërret të motrën.*)

HASANI: (*Pas derës*) Fatma! Moj Fatma! Akoma nuk je zgjuar? Fatma, hape derën! Fatma! Po ku je, o Fatma? Uah! (*I mëshon derës dhe pasi ajo hapet, hyn brenda dhe e kërkon Fatmën në të gjitha anët*) Mos Fatma! Ç'u bë! Edhe litari është aty i lidhur. Paska ikur! Paskan ikur! Ridvani, mbase Ridvani e ka rrëmbyer! E ç'të bëjmë tani? Ku ta kërkojmë?

DON PEDRO: (*Me të hyrë nga dera*) Ç'të ka ndodhur?

HASANI: Sikur ta kërkonim përreth oborrit. Ah, Fatma paska ikur!

DON PEDRO: Ku na iku ajo?

HASANI: Shufrat e dritares janë prerë. Aty është edhe një litar. Ajo vetë nuk mundur të ikte. Mbase dikush e ka rrëmbyer.

DON PEDRO: Ridvani!

HASANI: Mbase.

DON PEDRO: Rafaeli i gJORë... Do të dëshpërohet tepër kur ta marrë vesh! Në këto dy-tri ditë të fundit ishte në siklet të madh dhe nuk flinte tërë natën: *"A thua Fatma do të pajtohet? A thua Fatma do të martohet me mua?"*. E tani kur ta marrë vesh këtë, do të dëshpërohet tej mase.

HASANI: Vjehërr, nëse Ridvani e ka rrëmbyer, unë motrën time s'kam për ta parë më kurrë! Kush e di se ku e ka dërguar?

LIONORA: *(Duke hyrë nga dera)* Don Alfons, ku është Fatma?

HASANI: Ku është? Ka ikur! E kanë rrëmbyer!

LIONORA: Ka ikur se ju e shtrënguat! Ju e morët në qafë të mjerën! Dashuria nuk jepet me zor. Ajo e donte Ridvanin, ndërsa ju me dhunë donit t'ia jepnit Rafaelit! Ti Hasan, a mund të ndahesh nga unë? E pra as ajo nuk mund të ndahet nga Ridvani! Prandaj nëse e ka rrëmbyer Ridvani, s'më dhimbset fare, por më bëhet qefi.

HASANI: Fatma është motra ime. Nëse e ka rrëmbyer Ridvani, s'kam për ta parë më kurrë.

LIONORA: Nëse asaj do t'i duhet ta lërë dashurinë, atëherë më mirë ti lëre atë. Rafaeli edhe ashtu mund ta harrojë. Por jo edhe i dashuri.

DON PEDRO: Po Rafaeli? Rafaeli që e do Fatmën! Ajo është e dashura e Rafaelit. Rafaeli dëshiron të martohet me të.

LIONORA: Ka kohë që ata janë të dashuruar me njëri-tjetrin. Madje janë fejuar. Ndërsa Rafaeli e ka parë vetëm një herë. Fatma ndoshta asnjëherë s'e ka parë Rafaelin. Po këto janë dallime të mëdha!

RAFAELI: *(Duke hyrë nga dera)* Hë, ç'paska ndodhur ore? Ku është Fatma?

DON PEDRO: Biri im, Fatmën e kanë rrëmbyer.

RAFAELI: *(Me hidhërim)* Mos, po kush e ka rrëmbyer? Si ka ikur?

DON PEDRO: Ja, nga dritarja ka ikur. Dhe sipas të gjitha gjasave e ka rrëmbyer Ridvani!

RAFAELI: Ridvani! Tani shkoj unë dhe e gjej.

LIONORA: Me çfarë të drejte kërkon ta gjesh?

DON PEDRO: Shko, o biri im! Meqë nuk deshi që të vendosë kurorë me ty në zyrtarisht, shko, gjeje dhe merre me zor e dhunoje pamëshirshëm. Hajde, syrin ta pafsha!

HASANI: *(Me nervozizëm)* Motrën time?

LIONORA: Baba! Ki mëshirë! Po çfarë të keqe ju bëri ajo e gjora?

DON PEDRO: Çfarë të më bëjë më! Im bir e do dhe dëshiron që të fejohej me të. Ndërsa ajo refuzon dikë që dëshiron të martohet me celebrim! S'mjafton kjo?

HASANI: (*Me mërzë*) Kjo do të thotë se pasi ta kapni motrën time, do t'më zini rob edhe mua?

LIONORA: Ty!

DON PEDRO: Një herë le ta kapin atë e pastaj...

HASANI: Pastaj...

LIONORA: Jo, nuk ka nevojë as të gjendet e as të kapet. Sepse ai që e ka rrëmbyer, nuk është djalli, por burri i saj.

HASANI: Jo, ai nuk është burri i saj.

RAFAELI: Lionora!

DON PEDRO: Hajde o biri im, hajde ec e mos u vono! Merr armët dhe një dy a tre burra dhe ec e shko. Mos u vono! (*Rafaeli del.*)

HASANI: (*Rafaelit*) Ju lutem që Ridvanin mos ta vrisni!

DON PEDRO: Ha-ha-ha-ha! Nuk të morëm vesh fare... Ridvanin e llogarit si armik, mendon keq për të, ndërsa në anën tjetër edhe të dhimbset!

HASANI: Nëse Ridvani mbetet gjallë, unë nuk kam kurrfarë dobie. Por megjithatë nuk e dua vrasjen e një trimi të tillë. Ridvanin nuk e dua, por kam respekt për.

DON PEDRO: Hasan, do ta duash edhe vrasjen e tij. Ai meriton të vritet. Sepse ai bashkë me Musanë i vranë shumë ushtarë mbretit tonë.

LIONORA: Ah, kjo zemër prindi është prej guri apo diçka tjetër? Uh moj, e gjora Fatma, sa shumë që po më dhimbset!

HASANI: (*Don Pedros*) Jo, edhe nëse është armiku im, nuk e dua vrasjen e një trimi të tillë.

DON PEDRO: Ai le të jetë në daç i gjallë, në daç i vdekur. Së pari, le ta shtiem në dorë Fatmën e pastaj...

LIONORA: Jo, dhëntë zoti të jenë gjallë të dy.

HASANI: Lionora.

DON PEDRO: Lionora, më shiko një herë! Unë në bindjen time nuk bëj dallime mes teje dhe djalit tim. Ashtu si e dua të mirën e tij, e dua edhe të mirën tënde. Ashtu si do të jap ty tek Don Alfonsi, po ashtu edhe atë do ta martoj me Fatmën. Por të dish diçka, nëse nuk e martoj me Fatmën, as ty nuk do të të jap tek Don Alfonsi! E kuptove tani?

LIONORA: Mos, o baba! Amani Të përgjërohem! (*Hasani rri i dëshpëruar*) Alfons, mos ki frikë! Mos mendo kaq shumë! Unë nuk ndahem dot nga ti. Vdes e nuk të lë! (*Don Pedroja del.*)

Skena e gjashtë
Hasani – Lionora

HASANI: Ah, Lionorë, rrezikova kaq shumë për ty. Bëra të pamundurën. Dhe tani nëse përsëri nuk ia arrijmë qëllimit... Ose detyrohem që të ndahemi... Ah, Lionorë ah! Plotësimi i dëshirës sonë varet krejtësisht nga vendimi i Fatmës që të martohet me Rafaelin. Megjithatë ajo nuk do të pajtohet me këtë, kurrën e kurrës!

LIONORA: Aa, jo! Unë nuk dua që ajo të pajtohet për martesë në ato kushte dhe rrethana. Jo, jo! Nuk bën fare. Ndërgjegjja ime nuk e pranon dot këtë. Nuk dua që fati ynë të jetë fatkeqësi e dikujt! Bashkimi ynë t'i ndajë dy të dashuruar të tjerë si ne! Nuk dua që për rehatin tonë, të pësojnë të tjerët.

HASANI: Ah, Lionorë! Më duket se ke hequr dorë nga unë!

LIONORA: Ç'është kjo fjalë!

HASANI: Sepse nëse ne nuk e detyrojmë me forcë Fatmën që të pranojë martesën me Rafaelin, as dëshirat tona nuk do të plotësohen. Ndërsa ti thua që ne mos ta detyrojmë me forcë atë!

LIONORA: Ashtu është! Sepse unë nuk dua që dëshira ime të plotësohet mbi dëshpërimin e dikujt tjetër. Vallë, a nuk është edhe ajo njeri si ne? A nuk bëjmë mëkat nëse ne bëhemi shkaktarë të ndarjes së saj nga i dashuri?

HASANI: Pajtohem! Por nëse Fatma nuk martohet me Rafaelin, atëherë as babai yt nuk të jep tek unë.

LIONORA: Edhe nëse nuk më jep babai im, unë do të bëj ç'është e mundur. Do të rrezikoj çdo gjë! Dhe nëse përsëri nuk do të mund të bëj gjë, atëherë do të vras veten për ty! Por liria dhe ndërgjegjja e Fatmës nuk duhen prekur. Nuk na ka hije ne që ta bëjmë këtë.

HASANI: Por çka të bëjmë atëherë! Të lejojmë që Fatma me Ridvanin të shkojnë në skajin tjetër të botës dhe mos t'i shoh kurrë më! Bëra çmos për ty, ia ktheva shpinën popullit tim, vendit dhe shtetit tim, fesë sime dhe në fund ta shoh edhe vdekjen tënde! Kështu më do ti mua! Ah, Lionorë ah!

LIONORA: Alfons, për atë zot nuk di se çfarë të them! Kur e shoh Fatmën duke vajtuar ashtu me dënësë, shpirti im nuk duron dot.

HASANI: Kam frikë se edhe ne do të vajtojmë njësoj si ajo dhe nuk do t'i arrijmë qëllimet tona! Ah!

Skena e shtatë

Don Pedro – Hasani – Lionora – Fatma – Nja dy burra

DON PEDRO: *(Duke hyrë nga dera)* Mos kini frikë, se dëshirat na u plotësuan! Fatmën e kanë zënë dhe janë duke e sjellë këtu!

LIONORA: Ah, e mjera ajo!

HASANI: Lionorë! *(Rafaeli si egërsirë hyn brenda nga dera. Pas tij dy burra të armatosur e sjellin Fatmën prej krahësh.)*

RAFAELI: Ja e kapa! Tani më nuk kam punë me askënd! Emri i saj le të jetë daç Fatma e daç Meri ... Tani këtë e kam si plaçkë lufte. Nuk ka nevojë as për kurorë... As për pëlqim...

HASANI: Ah, ç'janë këto fjalë ore!

FATMA: *(Në gjendje të pavetëdijshe)* Ah, Ridvan! Ju përgjehem, kam një lutje! T'ju pyes diçka... Ç'u bë me Ridvanin? E vratë... Apo është gjallë?

RAFAELI: E vramë!

FATMA: *(E pikëlluar)* Ah, Ridvan ah! *(I bie të fikët dhe rrëzohet përtokë.)*

LIONORA: Uh, sa njerëz mizorë që jeni! *(I afrohet Fatmës dhe e kap nga dora.)*

FATMA: *(Pasi kthjellohet)* Ah, po ku jam unë! Aman o Zot! Ah, Ridvani, Ridvani! Më vrisni mua, më vrisni! Mos më lini të gjallë! Unë pas Ridvanit nuk kam pse të jetoj! Ridvani për mua ka mbaruar! Ah, Ridvan ah! Hajde më vrisni, ç'më rrini si kodër përpara. Të shpëtoj nga kjo torturë se më plasi zemra! Ah, Ridvan o Ridvan! *(Bie përtokë dhe vajton.)*

DON PEDRO: Bija ime, eja në vete... Mblidhe veten! Ju të tjerë largohuni! Të dalim të gjithë! Le të mbetet vetëm me vëllanë.

FATMA: *(Me të ngritur kryet)* Me vëllanë tim! Me cilin vëlla? Unë nuk kam vëlla, jo! Ju lutem, mos më lini me Alfonsin! Unë nuk dua fare ta shoh Alfonsin!

LIONORA: Ju rrini këtu! Fatma, ti eja me mua! Të dalim në dhomën tjetër. Pusho pak. *(E ngre nga krahët dhe për dore dalin bashkë.)*

Skena e tetë

Don Pedro – Hasani – Rafaeli

DON PEDRO: Unë u lodha duke u marrë me tekat tuaja. Tani duhet të vendosni. Le të bëhet çfarë të bëhet. Kjo punë duhet përfunduar. Ne nuk kemi kohë të merremi me ju gjithmonë!

HASANI: Çfarë përfundimi?

RAFAELI: Baba, çfarë do të thuash?

DON PEDRO: Don Alfons.

HASANI: Urdhëroni!

DON PEDRO: Ti e do apo nuk e do vajzën time?

HASANI: Ua, çfarë pyetjeje është kjo?

DON PEDRO: Jo, jo, më thuaj, e do apo nuk e do.

HASANI: E dua.

DON PEDRO: A mund të heqësh dorë nga ajo?

HASANI: Don Pedro? Po ç'thua kështu!

DON PEDRO: Unë nuk them gjë, vetëm po ju pyes. Më thuaj, po apo jo.

HASANI: Jo, nuk mund të heq dorë! Vdes dhe nuk mund të ndahem nga ajo!

DON PEDRO: Mirë, po ti Rafael, e do Fatmën?

RAFAELI: Po, e dua.

DON PEDRO: A mund të heqësh dorë nga ajo?

RAFAELI: Të heq dorë nga ajo? Ç'lidhje ka kjo! Deri dje ajo ishte nës krye të këtyre punëve. Po sikur ajo mos të ishte e pajtimit, unë nuk do të provoja fare. Kurse sot, puna është ndryshe. Fatmën e kam zënë rob dhe e kam si plaçkë lufte. E zura rob me shpatën time. Nëse dua, e marr për grua. Nëse dua, mund edhe ta vras. Nuk mund të më përziej askush.

HASANI: (*I nervozuar*) Motrën time?

DON PEDRO: Rafael, o biri im, është e vërtetë që ti Fatmën e more me shpatë. Mirëpo, meqë ajo është e motra e Alfonsit dhe ky u bashkua me ne dhe do të bëhet dhëndri ynë, as Fatma nuk duhet trajtuar si robëreshë.

RAFAELI: Nëse Don Alfonsi do që e motra mos t'i trajtohet si robëreshë, atëherë duhet ta bindë motrën që të martohet me mua. Po s'e bëri këtë, Fatma është në duart e mia. Përndryshe, unë nuk mund të heq dorë nga Fatma!

DON PEDRO: Tani e kuptuat si qëndron puna. Don Alfonsi e do Lionorën, por edhe Lionora e do Don Alfonsin. Ndërsa Rafaeli e do Fatmën. E shihni që këtu ajo që prish punë është vetëm Fatma. Prandaj, Don Alfons, tani ju duhet që të zgjidhni njërën nga këto tri mundësi: O duhet ta bindësh Fatmën që ta pranojë martesën me Rafaelin, parapra kisht duke e ndërruar emrin, o duhet të pajtohesh që Fatma të bëhet robëreshë ose, duhet të heqësh dorë nga Lionora.

HASANI: (*Me vete*) Ah, i mjeri unë! Sa gjëra të vështira! Sa gjëra të tmerrshme! Hall mbi hall. Problem mbi problem. Si do të përfundojë e gjitha kjo! Për ta bindur Fatmën që të pranojë martesën me Rafaelin, më duket si punë shumë e vështirë. Nuk pajtohet dot. E do Ridvanin. Ndërsa ta shoh motrën time të dashur si robëreshë! Në duart e dikujt tjetër, të shkatërruar e të rraskapitur vetëm e vetëm që unë të kem titullin e Donit! As kjo nuk bëhet dot! Është e pamundur! Po ndarja nga Lionora... Ah, o Zot! Përse kjo vuajtje! Ç'është ky tmerr!

DON PEDRO: Hej? Ç'thua ti?

HASANI: Që të dyja vendimet janë të vështira për mua, qoftë pajtimi im që Fatma të bëhet robëreshë, qoftë vendimi për ndarjen nga Lionora! Jo, jo, më mirë vdes sesa të bëj njërën nga këto. Por, nëse do të mund të bind Fatmën, do të ishte mirë! Po s'e binda, më mirë të vras veten dhe të shpëtoj! Më mirë të vdes sesa të bëj mëkat mbi mëkate... Ti Don Pedro... Pasi më solle në këtë gjendje me premtimet e tua, mund t'ma marrësh edhe shpirtin! Por duhet të mendosh pak edhe për vajzën tënde...

DON PEDRO: Më shumë se për vajzën, më duhet të menjohem për djalin tim!

RAFAELI: Don Alfons, ti nuk duhet të dëshpërohesh që tani. Së pari shko dhe provo që të bindësh Fatmën. Nëse nuk mundesh, atëherë...

HASANI: *(Me vete)* Është shumë vështirë që ta bind! Sapo të hyj brenda, ajo do trishtohet nga unë! Ah, Fatma ah...

DON PEDRO: Don Alfons, tani nuk është koha e dëshpërimit! Durim! *(Don Pedroja me Rafaelin dalin jashtë.)*

HASANI: *(Me vete)* Ah, nuk kam kurajë për të shkuar. Më dridhen këmbët! Më lidhet gjuha dhe nuk mund t'i them gjë! Ah, kam frikë se do ta humbas Lionorën! Por duhet provuar edhe një herë! Të shohim! *(Del. Pasi i afrohet derës, ndalet në një gjendje gati të pavetëdijshme. Me të parë hyrjen e Rafaelit dhe të Lionorës nga dera, rrëzohet mbi një karrige.)*

Skena e nëntë

Fatma - Lionora

(Lionora hyn brenda duke e mbajtur përdore Fatman, e cila është në gjendje të mjerueshme.)

FATMA: Ah, Ridvan! Ah, Ridvan! Ku je vallë? Mos të kanë vrarë! Nëse ti ke vdekur, si mund të rroj unë? Unë të jetoj pas vdekjes së Ridvanit! Ah, Ridvan, akoma kam shpresë se je gjallë. Nuk besoj se je vrarë, se përndryshe do të vrisja veten!

LIONORA: Fatma, betohem se Ridvani ka vdekur. Ridvanin e kanë vranë.

FATMA: (*Me trishtim*) E vranë! Lionorë, Ridvani është i vdekur!

LIONORA: Fatma, çfarë kuptimi kanë vajtimi dhe vuajtja pas vdekjes së njeriut? Edhe unë Alfonsin...

FATMA: Të Lutem! Të përgjërohem! Nuk dua, mos ma përmend emrin e tij!

LIONORA: E dua. Por mos e dhëntë Zoti që Alfonsit t'i ndodhë diçka, do të bëja durim. E çfarë tjetër përveç durimit mund të bëja? Ti tani i ke humbur shpresat prej Ridvanit dhe nuk beson që ai është i gjallë. Prandaj në vend se të vajtosh kështu dhe ta shkatërrosh veten, është më mirë që të martohesh me Rafaelin...

FATMA: Hesht, moj Lionorë! Të lutem hesht, se vdiqa!

LIONORA: Aq më tepër, edhe vëllanë do ta kesh këtu.

FATMA: Vëllanë tim! Jo, jo, unë nuk kam vëlla!

LIONORA: Ti nuk e ke idenë që Rafaeli të do më shumë se Ridvani. Pastaj edhe ne të dyja do ta duam njëra-tjetrën. Ne burrë e grua, ju vëlla e motër. Do të jemi katër veta që e duan njëri-tjetrin. Po edhe babai im do të jetë babai i të katërve ne. Shyqyr Zotit që nuk na mungon asgjë. Prandaj po të bëhemi të gjithë bashkë, do të kalojmë një jetë të mirë, një jetë që s'e ka bërë askush deri tani.

FATMA: Moj Lionorë! Të lutem më lër të qetë! Kam vënë re se në këtë shtëpi vetëm ti je dashamirëse. E tani më duket se edhe ti fillove të më torturosh! Të gjitha këto fjalë që the, ma shkatërrojnë shpirtin! Kam vetëm një lutje: Ju lutem më thoni që Ridvani është apo nuk është gjallë? Nëse është të paktën të mos mbys veten... Po nëse nuk është i gjallë... Ta mbys veten sa më parë! Se çdo minutë jete për mua pa Ridvanin, është haram. Ah, Ridvan, a Ridvan!

LIONORA: Rafaeli ty të do më shumë se Ridvani. Prandaj edhe ti dashuroje Rafaelin në vend të Ridvanit...

FATMA: (*Me trishtim*) Rafaelin a? Vrasësin e Ridvanit! Atë mizor! Atë njeri të pashpirt!

LIONORA: Fatma, sikur Ridvani të ishte gjallë, edhe unë do të pajtohesha me ty. Dhe nuk do të këmbëngulja... Por Ridvani, ja që ka vdekur.

FATMA: Ka vdekur! Ridvani ka vdekur! (*Me vete*) Jo, nuk e besoj dot! Është gënjeshtër! Ridvani është gjallë! Ai jeton! Nuk ka vdekur! Duhet durim! Duhet vetëm pak durim! Se Ridvani do të gjejë një zgjidhje dhe do vijë të më shpëtojë nga këta njerëz të pashpirt.

LIONORA: Ah, moj Fatma, ah! Keq për ty, keq për ne! Ti duke vajtuar kështu do ta mbysësh veten! Ndërsa kur Rafaeli të dëgjojë se ti ke vdekur, edhe ai do ta vrasë veten! E atëherë edhe mua më duhet që të ndahem nga Alfonsi! Ndërsa unë pa Alfonsin dhe Alfonsi pa mua s'mund t'jetoj-

më dot dhe do vdesim! Atëherë ja pra, ti do jesh shkaktare dhe përgjegjëse për vdekjen e katër vetave...

FATMA: Jo, unë nuk i hyj në gjak askujt! As edhe një thnegle! Shkaktare dhe përgjegjëse për këto gjëra nuk jam unë, por jeni ju... Është e keqja juaj... Është përpjekja juaj! Ju e mashtruat vëllanë tim, ia ndërruat emrin, veshjen dhe fenë! Bëtë gjithëçka deshët dhe ne nuk bëmë zë! Por ju megjithatë nuk na latët! Prandaj ju jeni ata që na hyni në gjak. Ku është drejtësia! A ka mëshirë!

LIONORA: (*Me hidhërim*) Ah, moj ti grua e keqe! Unë të thashë këto fjalë meqë më dhimbsesh, e ti ma kthen mua kështu siç po thua, me këto gjepura! Ti edhe pse e di që Ridvani ka vdekur, megjithatë nuk do që të heqësh dorë nga ai dhe tenton që të më ndash edhe mua nga Alfonsi! Atëherë ja pra, tani e tutje nuk do t'më dhimbsesh aspak! Le të të bëjnë robëreshë menjëherë dhe kjo Lionorë, e cila deri tani të lutej për të mirën tënde, tani e tutje do të bëhet sundimtarja jote... Urdhërestare... Nuk do mund ta hapësh gojën... Nuk do të kesh guximin të më shikosh në sy! Atëherë urdhëro dhe mbaje kryeneçësinë tënde! (*Del. Hasani hyn brenda.*)

Skena e dhjetë **Fatma – Hasani**

FATMA: (*Me të parë Hasanin*) Aman o Zot! Këtu na qenke! Ju lutem më lini të qetë, të vdes rehat!

HASANI: Fatma, do të të them vetëm një fjalë... Vetëm një fjalë...

FATMA: Ende do që të më flasësh? Nuk të dëgjoj dot, o tradhtar! Jo, jo, nuk të dëgjoj fare! Ik! Largohu nga këtu!

HASANI: Fatma, motra ime!

FATMA: Jo jo! Të thashë se nuk të dëgjoj fare! (*E mbulon fytyrën dhe qan.*)

HASANI: Fatma! Don Pedroja më tha që nëse ti nuk martohesh me Rafaelin, as ai nuk do të ma japë Lionorën. Ndërsa unë, nëse nuk a marr Lionorën, mbase do të vdes! Ti do që unë të vdes, apo jo?

FATMA: Ah, ti o zullumqar! E di se ç'je duke thënë? Ridvani inshalla është gjallë dhe unë nuk mund të ndahem prej tij.

HASANI: Ti ende ke shpresë tek Ridvani? Ridvanin e kanë vrarë! Madje që moti!

FATMA: Atëherë nëse Ridvanin e kanë vrarë, edhe unë jam e vdekur... Edhe unë dua të vdes. Qysh tani menjëherë, vetëm më duhet të jem e sigurt që ai është vrarë.

HASANI: Nëse ta dëshmoj se Ridvani është vrarë, a do të martoheshe me Rafaelin?

FATMA: Tradhtar! Mendon se unë jam si ti? Unë sikur edhe ta doja Rafaelin, përsëri nuk do të martohesha me të. Sepse Rafaeli është njëri nga armiqtë tanë. Prandaj duhet ta kuptosh që kjo punë s'bëhet dot. Aq më tepër që Ridvanin jo vetëm që e desha dhe u lidhëm, por dhe i dhashë besën

se nuk mund të jetoj dot pa të. Aman o Zot! Ç'po ndodh kështu me mua!

HASANI: Fatma, moj motra ime!

FATMA: Të lutem edhe një herë, mos më thuaj gjepura të tilla! Nëse mendon të më mbysësh vetëm e vetëm që ty të plotësohet dëshira, atëherë ja ku jam! Më vrit, më ther, më mbyt! Vetëm kështu mos më torturo, se nuk mund të duroj më! (*Pasi i bie para këmbëve të tij*) Të lutem, më mbyt mua!

HASANI: Ah, mbarova! Shpirti më lëshoi! Jo, për mua nuk ka shpëtim tjetër përveç vdekjes! (*Pasi mendon pak*) Fatma!

FATMA: Të lutem hesht! Mos fol! Hesht!

HASANI: (*Me vete*) Ah, o Zot, a është ky dënim për mëkatet e mia apo jo?

FATMA: Mos, ja erdhën! (*Del nga e majta në të djathtë.*)

Skena e njëmbëdhjetë

Hasani – Rafaeli – Don Pedro – Kardinali

RAFAELI: (*Duke hyrë nga dera e fundit*) Kardinali është duke ardhur, po ku mbeti babai?

DON PEDRO: (*Duke hyrë nga dera e djathtë*) Ç'kemi, çfarë u bë?

RAFAELI: Kardinali po na vjen!

DON PEDRO: Po ku është? (*Kardinali duke hyrë nga fundi i dhomës, në shenjë nderi dhe respekti zgjat duart. Këta të tre pasi i heqin kapelet, përkulen para tij. Kardinali i përkëdhel me duar dhe pastaj ecën dhe ulet.*)

KARDINALI: Uluni! (*ata ulen*) Don Pedro, me sa duket, në shtëpinë tuaj kanë ndodhur ca gjëra.

DON PEDRO: Po, ashtu është.

KARDINALI: E përse nuk më njoftuat? Unë patjetër duhet të jem i informuar për këto raste. Mirë, e ku është puna tani?

DON PEDRO: Ju e dini punën e Don Alfonsit, apo jo?

KARDINALI: Po.

DON PEDRO: Don Alfonsi ka një motër. Ajo kishte lidhur martesë me Ridvanin. Mirëpo Ridvani meqë ka luftuar kundër nesh, pas çlirimit të qytetit nuk është parë më. Por as Don Alfonsi nuk dëshiron që motra e tij të martohet me një mysliman e aq më tepër, me një mysliman që është armik i vendit tonë.

KARDINALI: Të lumtë! Të lumtë! Më vjen mirë! (*Hasani i shikon në sy me habi.*)

DON PEDRO: Na e solli në shëpinë tonë. Këtë vajzë e dashka edhe im bir, Rafaeli. Patëm dëshirë që ajo të hiqte dorë nga feja islame dhe ta martojmë me Rafaelin. Mirëpo nuk mundëm ta bindim. Pastaj mbrëmë ka ardhur ai farë

Ridvani, i ka prerë shufrat e dritares dhe nga këtu e ka rrëmbyer vajzën! Ndërsa sot në mëngjes shkoi Rafaeli, e gjeti dha na e solli këtu. Megjithatë, nuk po mund ta bindim dot që të martohet me Rafaelin.

KARDINALI: Mirë! Ju shkoni dhe ma sillni atë vajzë. Unë do ta bind. (*Dalin të tre. Kardinali ngrihet në këmbë dhe shetit.*)

Skena e dymbëdhjetë

Kardinali – Fatma

(*Lionora e fut brenda Fatmën nga dera e majtë dhe largohet.*)

FATMA: (*Pasi është trembur me të parë Kardinalin*) Mos! Aman o Zot! Po ku jam unë! Kush është ky? (*Kardinali zgjat duart drejt Fatmës.*) Ja, po ecën drejt meje. Po kush është ky more, a është djalli, xhelati apo azraili?

KARDINALI: (*Me një zë të thatë*) Mos ki frikë, se unë jam Kardinali i Granadës...

FATMA: (*Me trishtim*) Kardinali a! Po ti... Pse ke ardhur këtu? Ç'ke me mua?

KARDINALI: Erdha që të t'i fal mëkatet.

FATMA: Përveç Zotit nuk i takon askujt që t'i falë mëkatet e dikujt tjetër! E kush je ti, që t'm'i falësh gjynahet e mia?

KARDINALI: Kush jam unë? A nuk e kuptove se kush jam unë? E pra ta them se unë jam kardinali i Granadës! Jam për-

faqësues i Papës! Shenjtëria e tij më ka dhënë leje, që unë, sipas bindjes sime, t'i dërgoj njerëzit në parajsë apo në ferr.

FATMA: Ju lutem respekt! Mos i thoni këto fjalë! Se ferri dhe parajsa i takojnë vetëm Zotit. Kë do e dërgon në parajsë dhe kë nuk e do, e dërgon në ferr... E kush është ai që mund të përzihet në punët e Krijuesit?

KARDINALI: Papa është përfaqësuesi i Zotit...

FATMA: Kurrën e kurrës!

KARDINALI: *(Duke i treguar një grumbull çelësash)* Ja pra çelësat e parajsës janë në duart e mia. Ia jap kujt të dua unë.

FATMA: *(Me vete)* Aman o Zot, ç'janë këto budallallëqe!

KARDINALI: Bija ime, shiko kënde! Unë i di punët e tua... Dhe tani të dërgoj menjëherë në ferr. Por më dhimbsesh se je ende fëmijë... E paditur... Eja që të t'i fal mëkatet... Të tregoj rrugën e drejtë... Po si quhesh ti?

FATMA: Ç'të duhet emri im?

KARDINALI: Ma thuaj.

FATMA: Fatma.

KARDINALI: Ëhë, Fatma a? Akoma ke guxim që ta mbash këtë emër? Të gjitha vajzat dhe gratë e qytetit tonë më këso emrash që ishin, tani i kanë ndërruar! Ato që kundërshtuan

dhe nuk deshën ta bëjnë këtë, disa u mbytën, disa u dogjën dhe disa të tjera u bënë robëresha. Ndërsa ti deri tani ke shpëtuar në krah të Don Pedros. Por tani e tutje nuk do të kesh më shpëtim! Eja dhe ta ndërrojmë këtë emër... Ty po të pagëzojmë me emrin Elizabeta...

FATMA: (*Me vete*) O Zot, thuajse pak më ishin këta zullum-qarë që i pata mbi krye deri më tani e m'u shtua edhe ky?

KARDINALI: Të martojmë me Don Rafaelin që të bëhesh Dona Elizabeta!

FATMA: Unë të martohem me Don Rafaelin! Unë të bëhem Dona! Unë të quhem Elizabeta! Të lutem, o Zot! Ma merr shpirtin sa më parë dhe mos të dëgjojë gjëra të këtilla!

KARDINALI: (*Me vete*) Nuk pajtohet! Nuk do! Hollë- hollë as unë nuk jam për paqe... As mua nuk ma do shpirti... Ia kam zili Rafaelit. Jam kundërshtar i tij, meqë tani unë vetë u bëra i dashuruari i tretë i saj! Po çfarë bukurie është kjo! Çfarë hijeshie! Sa simpatike! Sa tërheqëse që është! Ma mori zemrën menjëherë! Kam dëgjuar për bukurinë e vajzave arabe, por s'kisha besuar kurrë se janë kaq të bukura! Por ndalu e të shohim një herë. Nëse këmbëngul që mos të martohet me Rafaelin, do jetë më mirë... hajt ta provojmë. O Fatma, bija ime! Ti nuk do që të martohesh me Rafaelin, apo jo?

FATMA: Uh, bre!

KARDINALI: Të lumtë, bija ime! Eja dhe tani të t'i fal mëkatet... (*I shtrin duart mbi kokën e saj dhe lehtësisht i prek edhe flokët.*)

FATMA: (*E trembur*) Ah! Ç'je duke bërë ore! Largohu nga unë!

KARDINALI: Elizabetë!

FATMA: Mua më quan Elizabetë?

KARDINALI: Si të duket ky emër, e pranon apo jo?

FATMA: Jo!

KARDINALI: As martesën me Don Rafaelin nuk e pranon apo jo?

FATMA: Jo!

KARDINALI: Bukur, por je robëreshë në duart e tij!

FATMA: Jo, liria ime mund të jetë në duart e tij, por jeta ime është në duart e mia!

Kur të dua, mund të mbys veten dhe të shpëtoj!

KARDINALI: (*Me vete*) Po sa e bukur që është! Duhet dërguar në kishë... (*Fatmës me zë të ulët*) Shikomë, bija ime! Më dëgjo mua se edhe unë jam me ty...Mos u marto me Rafaelin... Unë do të të shpëtoj ty!

FATMA: Ti do më shpëtosh mua!

KARDINALI: Po. Eja në kishë dhe unë do të të shpëtoj.

FATMA: Ah, o Zot! Unë nuk do t'mundem më t'i përballoj këto mundime! (*Me hidhërim del nga dera e majtë.*)

KARDINALI: (*Me vete*) Sa gjë e çuditshme! Aty për aty ma mori zemrën! Unë këtë vajzë nuk e lëshojë më dot! Jo kurrë! Aq më tepër kur puna e saj qëndron kështu kaq e ngatërruar, është më lehtë për ta bërë për vete... Edhe pse duket shumë dinake dhe nuk do mashtrohet lehtë... Por duhet menduar ndonjë dredhi, i duhet bërë ndonjë kurth... Kjo plaçkë kurrsesi nuk duhet lëshuar nga duart... Përndryshe është turp për një njeri nga Inkuizicioni që nuk mund ta imagjinojë një gjë të tillë për ta kryer punën! (*Del.*)

(*bie perdja*)

AKTI I TRETË

PAMJA E TRETË

(Në shtëpinë e Don Pedros është një dhomë e stolisur për mrekulli. Dhoma në fund dhe në të djathtë ka nga një derë. Në të djathtë ka edhe një dritare. Pranë derës në fund është një tavolinë, një kolltuk dhe janë ca karrige. Në mur ka disa fotografi të varura.)

Skena e parë

HASANI: *(Me vete)* E pamë edhe marrëveshjen mes Ferdinandit dhe Izabelës... Në këtë marrëveshje është përfshirë edhe es-Safiri dhe në të është thënë se myslimanët e Granadës do të jenë të sigurt dhe se atyre u garantohen çdo gjë që kanë, jeta dhe feja, morali dhe pasuria e tyre. Këtë marrëveshje përveç Mbretit dhe Mbretëreshës, e kanë nënshkruar edhe gjithë deputetët e parlamentit dhe ministrat. E tani ku janë ato premtime të marrëveshjes? Sepse tani myslimanët janë të detyruar që nga dhuna, o të braktisin pasurinë e tyre dhe ta lëshojnë vendin me duar në xhepa, o të ndërrojnë fenë si kusht për të jetuar në atdheun e tyre. Ndërsa kundërshtarët pa një pa dy, i mbysin. Dijetarët me nam botëror i lidhin me zinxhirë dhe sikur të ishin vrasës, i dërgojnë për në Romë. E përse, çfarë faji paskan bërë këta? Sepse i shërbyen njerëzimit, shkencës dhe dijes! Me qindra vajza të reja virgjëresha i marrin me dhunë nga gjiri i nënave dhe ua dhurojnë mbretërve nëpër Europë. U bënë tri ditë që janë duke u djegur bibliotekat shekullore më të mëdhatë në

botë, të cilat u ngritën dhe u pajisën me mundin dhe përkushtimin e dijetarëve të devotshëm! Të parët tanë kur i pushtuan këto troje, a thua kështu vepruan? Ah, po pse ndodh ky zullum! Vallë, ç'është kjo pamëshirë! Ç'është kjo çnjerëzi! Prej nga vjen i tërë ky barbarizëm! E ka shumë vështirë njeriu për t'i duruar! Po sa me fat paskëshin qenë të gjithë ata djem e burra arabë, që luftuan dhe vdiqën për atdheun dhe nuk i panë këto! Po unë i gjori? A thua ka njeri më fatzi se unë? Nga njëra anë më duhet t'i shoh dhe përjetoj fatkeqësitë e vëllezërve të mi dhe të atdheut tim, ndërsa në anën tjetër njëkohësisht më duhet t'u nënshtrohem urdhërave të armikut! Kjo shenjë e besnikërisë në gjoksin tim, është duke ma shkatërruar shpirtin. Unë të gjitha këto i bëra vetëm për Lionorën, si duket në fund do të më vijë radha që të ndahem edhe prej saj. Sepse njëra nga këto duhet zgjedhur: O duhet të heq dorë unë nga Lionora, o duhet Fatmën ta japim me zor tek Rafaeli! Po sa gjëra të tmerrshme! O duhet hequr dorë nga Lionora! O i duhet dhënë me zor Fatma Rafaelit! Ah, e mjera Fatma! Po çfarë faji pati ajo që ti vuan të gjitha këto tortura! Sa ditë u bënë që është në burg! Ndarja nga Ridvani në njërën anë, torturat tona ndaj saj në anën tjetër, do ta lënë pa shpirt! Ah! Unë megjithëse tradhtova motrën time për Lionorën, si duket në fund nuk do t'ia arrij qëllimit! A thua vallë e gjitha kjo që po më ndodh, është dënim për mëkatet e mia?

Skena e dytë

Hasani – Kardinali

(Kardinali me të hyrë nga dera, i zgjat duart. Hasani e heq kapelën menjëherë.)

KARDINALI: Qofsh i lumtur, o biri im! Unë si konvertues, në mesin e myslimanëve nuk pashë njeri më besnik se ti.

HASANI: (*Me vete*) Po, është e saktë. Jo besnik, por më tradhtar se unë. Dhe në këtë tradhti më solli Lionora.

KARDINALI: Hej, ku ju mbeti puna?

HASANI: Nuk u bë asgjë.

KARDINALI: Elizabeta akoma nuk pranoi?

HASANI: Elizabeta? Cila Elizabetë?

KARDINALI: Motra juaj!

HASANI: Ëhë, Fatma, apo...?

KARDINALI: Hesht... Heeeeeeshshsht.... Heeeeshsht... Nuk di gjë ti për vendimet dhe urdhrat e Inkuizicionit? Tani e tutje, në Spanjë nuk guxon më të dëgjohet asnjë emër mysliman. Ndërsa ata që nuk e respektojnë këtë, digjen në zjarr. E kuptove? Prandaj nëse dikush dëgjon se motra quhet Fatma, e djegin menjëherë në zjarr.

HASANI: (*Me dëshpërim*) Bashkë me të, më digjni edhe mua dhe të shpëtojmë!

KARDINALI: (*Me nervozizëm*) Alfons, çfarë do të thuash me këtë?

HASANI: Po çfarë të them tjetër? Meqë motra ime nuk e pranon dot emrin Elizabeta... As fenë nuk e ndërron... Prandaj nëse ajo duhet të digjet, dua edhe unë të digjem bashkë me të!

KARDINALI: Ty! Po kush është ai që mund të të djegë ty! Ti je një njeri i madh!

HASANI: Nëse më duhet të shoh se si digjet motra ime, më mirë të digjem unë. *(me zë të ulët ngadalë)* Unë e pranoj të digjem!

KARDINALI: *(Mendohet njëfarë kohe duke e lëmuar mjekrën dhe pastaj ecën poshtë e lart)* Alfons, shiko këtu një herë!

HASANI: Urdhëroni!

KARDINALI: Unë e pashë sesa armiqësi dhe urrejtje kishte ndaj nesh.

HASANI: A jo! Jo, Jo! Nuk është e tillë! Ngaqë do Ridvanin dhe ...

KARDINALI: Ti mos ma trego mua këtë! Unë e pashë... Por megjithatë është motra jote. Prandaj, meqë ti je i besuari ynë dhe e do shumë motrën tënde, unë nuk jam që ajo të digjet...

HASANI: Oh!

KARDINALI: Dhe do të mundohem që ta shpëtoj...

HASANI: Oh! Sa mirë, sikur ke zbritur nga qielli!

KARDINALI: Por duhet të më dëgjosh patjetër.

HASANI: Urdhëroni... (*Me vete*) Inshalla nuk është ndonjë kusht i vështirë!

KARDINALI: Meqë unë e di se si qëndron puna, motra juaj tani duhet ta pranojë fenë katolike dhe të martohet me Rafaelin.

HASANI: Po, të martohet me Rafaelin.

KARDINALI: Ti u mundove që ta bindësh motrën, por nuk munde, apo jo?

HASANI: Jo, nuk munda. Dhe as që ka gjasa të bindet!

KARDINALI: Në rregull. Atëherë tani duhet futur në kurth.

HASANI: Dredhi!

KARDINALI: Po pra. Motrën tënde duhet ta mashtrojmë.

HASANI: Po si ta mashtrojmë?

KARDINALI: Do shkosh dhe do t'i thuash motrës se ti nuk je bërë në të vërtetë katolik, ...por vetëm sa për ta marrë Lionorën dhe për të ikur bashkë me të. Prandaj thuaji: edhe ti pranoje fenë katolike, jo sinqerisht por sa për të arritur të ikim...

HASANI: Bukur fort! Po pastaj?

KARDINALI: Për më tutje ti mos e mundo veten. Unë i kam menduar të gjitha. (*Me vete*) Vetëm sa ta fus Fatmën në kishë, e pastaj Alfonsi, Lionora, Rafaeli, le të bëjnë çka të duan... Shumë ma ndien? (*me zë të lartë*) Hajde tani... Mos harro se ç'të thashë! (*Del.*)

HASANI: (*Me vete*) Vallë, ku ta ketë qëllimin ky njeri? Mos është ndonjë intrigë... Por jo. Fatma me të pranuar emrin Elizabeta, nuk ka pengesë për t'u martuar me Rafaelin... Po, hajt të shohim njëherë nëse mund ta mashtrojmë? (*Del nga e majta. Pas pak kthehen me Fatmën.*)

Skena e tretë

Hasani – Fatma

FATMA: (*Me zemërim*) Ah! Të lutem! Ku po më dërgon?

HASANI: Fatma!

FATMA: Jo, nuk të dëgjoj. Jo, jo! Kot e ke. Mos u lodh. Më lër rehat në hallet e mia... Bile le të vdes e qetë! Ja pra, ti mua kështu do më mbysësh me dorën tënde! (*duke ia kthyer shpinën, me zë të lartë*) Ik, largohu! Nuk dua më të t'i shoh sytë!

HASANI: (*Duke ia marrë dorën Fatmës me të mirë*) Mojt motër...

FATMA: (*Duke e hequr dorën me zemërim*) Jo, nuk jam motra jote! Edhe një herë mos më thuaj motër!

HASANI: Moj Fatma! Më mbyte, më shkatërrove! Vdiqa! Unë nuk kam familjar tjetër përveç teje. Dhe kur dëgjoj prej teje fjalë të tilla, atëherë vaj halli për mua! Ah moj, po ti a nuk je ajo motra ime Fatma, që të doja aq shumë?

FATMA: Motra jote! Jo! Ti nuk më do mua si Fatma, si motra jote, por do që të jem si Elizabetë, si gruaja e Don Rafaelit!

HASANI: A nuk jam ai Hasan që më doje aq shumë?

FATMA: Jo, nuk je! Ti nuk je Hasani! Ti je Don Alfonsi!

HASANI: *(Me habi)* Don Alfonsi jam unë! *(Pasi shikon rreth e përqark dhe jashtë dere që mos të jetë dikush)* Jo!

FATMA: *(Me ngazëllim të thellë)* Ti nuk je Don Alfonsi?

HASANI: Jo, unë nuk jam Alfonsi! Jo, kurrë! Unë jam Hasani... Vëllai yt, Hasani, që e doje aq shumë! Po ti a nuk je motra ime Fatma?

FATMA: *(Duke ecur që ta përqafojë)* Ah, more Hasan! *(ndalet menjëherë)* Aaa, jo! Nuk mund të përqafoj një njeri ...me një veshje të tillë!

HASANI: Nëse ai njeri ...bëhet vëllai yt...

FATMA: Vëllai im! Jo! Një njeri me një veshje të tillë nuk mund të jetë vëllai im!

HASANI: Më beso, Fatma!

FATMA: Jo, nuk besojë! Ti nuk je vëllai im! Ka një muaj dhe vetëm Zoti i madh e di se çfarë jam duke hequr nga ti! Ti më ndave nga burri im i dashur! Ma nxive fytyrën! Ti më burgose në burgjet e armiqve tanë!

HASANI: Për të të shpëtuar ty!

FATMA: Çfarë do të thuash me këtë? Unë zaten isha e shpëtuar! Por ti je ai që më burgose!

HASANI: Që të shpëtojmë të dy së bashku.

FATMA: Ti deshe dhe ne u bëmë rob... Ua, po ç'thashë unë? Po ti nuk je rob. Ti je Don!

HASANI: Don! Por të jesh Don është një mijë herë më keq se të jesh rob!

FATMA: Atëherë, përse e pranove?

HASANI: Për të marrë Lionorën.

FATMA: Ah, i poshtër! Ti për të marrë Lionorën mua më sjell gjithë këto tmerre. Më ndan nga burri im i dashur! Tenton me dhunë që të më martosh me... me armikun tim dhe tani pa u turpëruar fare, më thua se të kam motër!

HASANI: Fatma! Unë e dua Lionorën! Pa Lionorën nuk mund të jetoj dot!

FATMA: Po kush të thotë që të heqësh dorë nga ajo? ...Nuk ke nevojë ta bësh këtë... Mua më flijon për dashurinë që ke

për të... E pasi unë të vdes, ti do martohesh me Lionorën dhe të plotësohen të gjitha qëllimet e tua...

HASANI: Fatma! Ti akoma nuk i ke kuptuar qëllimet e mia... *(përsëri pasi shikon nga dera se mos është dikush tjetër)* Fatma, unë nuk e ndërrova fenë. Unë jam po ai Hasani i vjetër. Po ai Hasan që më njeh ti. Emrin Alfons dhe titullin e Donit, gjoja i kam pranuar. Desha vetëm sa të merrja Lionorën dhe pastaj përsëri Hasan do më quanin. Prandaj tani edhe ti, për t'ma bërë të mundshme që të martohem me Lionorën, duhesh që të bësh sikur e pranon emrin Elizabeta dhe po ashtu sikur e jep pëlqimin se do të martohesh me Rafaelin... Dhe pastaj të gjithë së bashku, unë, ti dhe Lionora, ikim dhe shpëtojmë.

FATMA: Oh, Hasan! Seriozisht! Sinqerisht, a mund të të quaj ty Hasan?

HASANI: Jo. Vetëm edhe një dy a tri ditë, ti nuk do më quash Hasan e as unë ty Fatma. Vetëm edhe një dy a tri ditë unë do të them ty Elizabetë e ti mua do më thuash Alfons...

FATMA: Elizabetë! Aa, jo!

HASANI: Fatma! Ti do shkatërrimin tonë? Vdekjen tonë? Veç kësaj, nuk kemi rrugëzgjidhje tjetër. Shpëtimi i të dyve varet vetëm nga kjo.

FATMA: *(Me shqetësim)* Po Ridvani?

HASANI: Pasi të shpëtojmë ne, shkojmë dhe gjejmë edhe Ridvanin.

FATMA: (*Pasi e përqafton Hasanin*) Oh sa mirë! Vërtet? Vërtetë Ridvani është gjallë? Mos Hasan! Po sa gabim të madh që paskam bërë! Sa mëkat të madh që paskam bërë ndaj teje! Po ti paske punuar për mua!

HASANI: (*Me vete si me zemërim*) Ah, e mjera kjo! Sikur të ma dinte qëllimin! Ah, o Zot i madh! Po sa gjëra të këqija më shtyve të bëj! Ah, dashuri moj dashuri! Çfarë mëkatari më bëre ti!

FATMA: (*Pasi bie para këmbëve të Hasanit*) Hasan, të lutem o Hasan, më fal!

HASANI: (*Me vete*) Uh bre! Vdiqa! Zemra më lëshoi! Por, megjithatë, durim! (*Befas me zë të lartë*) Jo Fatma! Ti më fal, se unë jam fajtor... Ti nuk ke kurrfarë faji!

FATMA: (*Pasi e përqafton Hasanin*) Ah, Hasan, o Hasan! Po unë i pata humbur të gjitha shpresat prej teje! Të falem o Zot! Shumë faleminderit! A do ta gjejmë edhe Ridvanin, o Hasan?

HASANI: (*Me vete*) E mjera motër! (*me zë*) Mos ki dyshim fare se do ta gjejmë.

FATMA: Oh, shumë faleminderit! (*Hasani i fshin lotët.*) Ah, Hasan! Po qan! Ç'u bë? Mos i ka ndodhur gjë Ridvanit?

HASANI: Jo, Fatma, jo! Për besë nuk i ka ndodhur gjë! Ridvani është gjallë. Por më kujtohen vuajtjet që t'i solla pa

dashjen time dhe më vjen të qaj. Unë prej kohësh kam dashur që të t'i tregoj qëllimet dhe dëshirat e mia, por ja që nuk kisha kohë. Kisha edhe frikë.

FATMA: Nuk ka asgjë! Sepse tani nuk je Don Alfonsi... Por je Hasani... Sepse je vëllai im... Nëse do të gjeshe edhe Ridvanin, të qofshin falë të gjitha. Unë nuk qaja për vete time... Por qaja për ty! Meqë tani je vëllai im Hasani, nuk kam frikë për asgjë! Oh, sa mirë që u bëmë!

HASANI: *(Me vete)* Ah, o Zot! *(me zë)* Mojtë motra ime! Duhet të bësh durim edhe dy-tri ditë! Duhet patjetër të pranosh emrin Elizabetë.

FATMA: Ah, o Zot! Me të dëgjuar këtë emër Elizabetë, zemra më dridhet!

HASANI: Fatma ime e dashur! Durim! Gajret! Nuk ka rruge tjetër! Duhet të detyrosh veten!

FATMA: E pranoj, do ta detyroj veten! Vetëm e vetëm që të shpëtoj më së bashku dhe t'u kthehem atyre kohërave tona të vjetra... Që të takohem me Ridvanin... Hë për hë do ta pranoj emrin Elizabetë. Ah, të lutem o Zot! M'i fal gabimet e mia!

HASANI: Motra ime e dashur! Duhet të bësh kujdes që mos të zbulohesh se gjoja e ke pranuar emrin Elizabetë... Tani eja dhe të shkojmë te Kardinali...

FATMA: Mos! Është këtu ai njeri? Të lutem, nuk mund ta shoh atë! E ndiej veten shumë keq kur e shoh atë! Nuk ...di se çfarë njeriu është ai!

HASANI: Fatma! Mos ki frikë se edhe unë e urrej atë njeri, por s'kemi ç'bëjmë! Eja dhe të shkojmë së bashku! Gjunjëzo-hu para tij dhe i thuaj se jep pëlqimin që të quhesh Elizabetë dhe se do të martohesh me Rafaelin...

FATMA: Dyshoj! Nuk i besoj dot vetes se mund ta bëj këtë! Të gjunjëzohem para dikujt që e urrej dhe të shqiptoj fjalë që nuk përkojnë me fenë time, të shqiptoj fjalë tradhtie ndaj atdheut dhe Ridvanit tim! Aa, jo jo! Fjalë të tilla nuk mund të dalin nga goja ime!

HASANI: Fatma! Zoti nuk i merr për bazë fjalët që thua, por atë që ndien në shpirt. Për shpëtimin tonë, eja dhe bëje këtë, ashtu siç të thashë... Mëkatet i marrë unë përsipër!

FATMA: Do ta provoj edhe këtë! Do ta detyroj veten! Jo për mua! Por për ty, për Ridvanin. Zoti e di këtë. Sa për vete, nuk do ta bëja kurrë. Më mirë të vdisja se t'i shqiptoja ato fjalë... Pra, vetëm për ty dhe Ridvanin do ta bëj këtë. Por ja që nuk më shkohet. Nuk mund të hyj në dhomën e tij. Kam frikë se do t'më ndodhë ndonjë e keqe!

HASANI: Në rregull! Atëherë ti rri këtu dhe unë po shkoj dhe ta sjell këtu... Shkova... Durim!

FATMA: O Hasan! A s'bën që ai mos të vijë këtu?

HASANI: Jo, Fatma! Jo, nuk bën. Të lutem, durim! Nëse do lumturinë tonë, duro edhe pak!

FATMA: Vetëm për Ridvanin... Vetëm për ty... (*Hasani del.*) Ah, more Ridvan! Po ...të tradhtoj ty me gjuhën time! Por

shpirti im është me ty! Këto gjëra i bëj vetëm e vetëm që unë e ti të jemi së bashku! Vallë, a thua do t'më falësh? Po nëse jo! Mos, si është e mundur që unë të bëj diçka pa pëlqimin tënd! Po çfarë faji ...bëra unë, o Zot! Po ky është mundim i madh! (*Kardinali hyn nga dera e përparme. Pas tij hyn edhe Hasani. Fatma me të parë Kardinalin, rrëqethet dhe largohet në një cep. Kardinali ulet në një karrige luksoze.*)

Skena e katërt

Kardinali – Fatma – Hasani

KARDINALI: (*Pasi është ulur, me vete*) Shih çfarë bukurie! Sa trup i mahnitshëm! A thua se është engjëll i zbritur nga qielli! Çfarë fat i madh për mua, nëse ia arrij qellimit! (*Kardinali duke i pëshpëritur me vete këto fjalë, Hasani i afrohet Fatmës dhe i thotë diçka në vesh. Kardinali i drejtohet Fatmës*) Zoti i madhërishtëm nuk lë askënd vetëm... Më vjen mirë që edhe ti tani, o bija ime, je udhëzuar mirë, apo jo?

HASANI: (*Fatmës me zë të ulët*) Po, i thua, po.

FATMA: (*Duke u dridhur*) P.....po.

HASANI: (*Fatmës me zë të ulët*) Ec dhe përkulu... Hajde... (*Fatma është shtangur dhe nuk lëviz dot.*)

KARDINALI: Hajde, o bija ime, eja... Afrohu... Mos ki frikë!

HASANI: (*Fatmës me zë të ulët*) Fatma! Ashtu si u morëm vesh! Të lutem tani gjunjëzohu para tij, se përndryshe mbaruam!

FATMA: (*Duke u dridhur*) Të përgjërohem, o vëlla! Të lutem, mos më detyro se do t'më bjerë pika!

KARDINALI: Don Alfons, mos e shqetëso... I vjen turp... (*Me vete*) Po sa e egër që është! Vallë, a thua do ta zbusim pak? (*Fatmës*) Mirë, o bija ime? Ti e pranove fenë katolike, apo jo?

HASANI: (*Fatmës me zë të ulët*) E pranova i thua.

FATMA: (*Duke iu dridhur zëri*) Ee...pra...pra...nno...ooo...v...a.

KARDINALI: Të lumtë! Si e ke emrin?

HASANI: (*Fatmës me zë të ulët*) Elizabetë, i thua Elizabetë!

FATMA: Ee...llli...zza..bbe...të.

KARDINALI: Dona Elizabeta... Shumë mirë! Qofsh e lumtur gjithmonë, bija ime! (*Pasi ngrihet në këmbë, duke ecur*) Mirë, po me Don Rafaelin do të martohesh?

HASANI: (*Fatmës me zë të ulët*) I thua po, do të martohem i thua.

KARDINALI: Hajde, më thua... Mos të të vijë turp... Mos u turpëro.

HASANI: (*Po ashtu*) Fatma! Po i thua... Sa më shpejt! I thua po, do të martohem, i thua!

FATMA: Uh, more!

KARDINALI: Hajde bija ime, më thuaj... Mos të të vijë turp.

HASANI: (*Ngadalë*) Fatma!

FATMA: Ppp...o... Dd...ooo... ttë...mma...rr...tto...hem. (*Me vete*) Ah, o Zot! Po sa e rëndë qenka të thuash me gojën tënde, atë që nuk ta do shpirti!

KARDINALI: Nga ai Ridvani i rrezikshëm ke hequr dorë apo jo?

FATMA: (*Pasi trishtohet*) Ah!

HASANI: (*Ngadalë*) Fatma! Të lutem, o Fatma! Eja në vete! Çfarë po bën?

FATMA: Hasan! Po më bie të fikët! Vdiqa! Më largo nga këtu! Nuk mund ta shoh këtë njeri të keq!

HASANI: Hee...shsht!

KARDINALI: (*Me vete*) Sa i bukur është përvetësimi kur arrihet me vështirësi! Po ashtu edhe bindja është më e vështirë. Po nuk e arrita qëllimin, do ta kem shumë keq punën. Ndoshta do të çmendem. (*Don Pedroja hynë brenda dhe me përgjërim ...ecën drejt kardinalit. Kardinali e bën ceremoninë duke ia shtrirë duart mbi kokën e tij.*)

FATMA: (*Hasanit me zë të ulët*) Të lutem! Nuk mund të rri! M'u këputën këmbët! Më mbaj! Më hiq nga këtu! (Hasani e mban Fatmën nga krahu dhe që të dy dalin jashtë nga e majta.)

Skena e pestë
Kardinali – Don Pedro

KARDINALI: *(Me kënaqësi)* E more vesh?

DON PEDRO: Çfarë?

KARDINALI: Vajza u bind...

DON PEDRO: Vërtet?

KARDINALI: Po. E bindi i vëllai. Ajo e pranoi fenë katolike, e pranoi emrin Elizabetë... E dha edhe besën se do të martohet me Rafaelin!

DON PEDRO: Oh, lavdi o Zot! Shpëtova nga një hall i madh... Meqë vajza ime e do kaq shumë Don Alfonsin, ndërsa im bir Fatm... këtë... Elizabetën, sepse cilado ndarje nga këta të dashuruar do të shkaktonte vdekjen time!

KARDINALI: *(Me vete)* Po unë! Mua s'më llogarit fare! Unë e dua vajzën më shumë se djali i tij. Por unë nuk e mbys dot veten... Le të rrojë Inkuizicioni! Në saje të Inkuizicionit, unë e mbroj veten prej gjithçkaje!

DON PEDRO: Pengesë për plotësimin e dëshirave të djalit tim dhe vajzës sime, ishte Fat... Kjo... Elizabeta. Prandaj meqë edhe ajo është bindur më në fund, atëherë duhet bërë dasmë sa më parë... Duhet martuar këta... Ç'thoni ju?

KARDINALI: Po... (*Me vete*) Ose sa më parë që të jetë e mundur, vajzën duhet ta dërgojmë në kishë... E pastaj, sido që të jetë, duhet bërë festë... Ashtu ose kështu.

DON PEDRO: Mua më lini, ndërsa ju urdhëroni uluni. Po të sjell edhe Don

Alfonsin. Ndërsa unë po shkoj t'u jap sa më parë lajmin e mirë Lionorës dhe Rafaelit. E pastaj të shohim se si do t'ia bëjmë për dasmë, apo jo? Mendoj që nuk është rasti për të humbur kohë.

KARDINALI: Po, po, shko dhe ma dërgo Don Alfonsin.

DON PEDRO: Që sot mund ta bëjmë celebrimin, apo jo?

KARDINALI: Posi, posi! (*Me vete*) Vajza që sot duhet dërguar në kishë... (*Don Pedroja del.*) Punët na ecën mirë... Do bëhet... Nuk ka gjë më të mirë se të jesh kardinal në këtë botë! Parajsa dhe Ferri janë në duart e mia; kë e dua e dërgoj në parajsë, kë nuk dua e dërgoj në ferr... Ndërsa për vete marr vajzat e bukura! (kap grumbullin e madh të çelësave që ka në brez) Ja, secili nga këta e hap nga një derë të parajsës... Por, sikur kjo bukuroshe të më pranonte mua, do t'ia jepja asaj që të gjitha... Edhe pse është mysli-manë, s'më prish punë. Gjysma e parajsës le të jetë e saj... Vetëm le t'më pranojë mua e pastaj... Për mua nuk ka parajsë më të madhe se trupi i saj... Po edhe ky rast nuk na vjen çdo ditë. Vajzat arabe shiten me qindra. Po edhe dhurohen. Prandaj edhe unë nuk dua ta humbas këtë rast të mirë. Disa nga ato duhen marrë në kishë... Prandaj të fillojmë nga kjo. (*Hyn Hasani.*)

Skena e gjashtë
Kardinali – Hasani

KARDINALI: Juve ju përgëzoj! Ja pra, puna mbaroi. Don Pedros i tregova dhe ai u gëzua shumë. Sot do të bëjmë celebrimin menjëherë dhe pas dy a tri ditësh, do të bëjmë edhe dasmën.

HASANI: Oh, sa mirë! Shyqyr o Zot. Faleminderit... Faleminderit! Shumë faleminderit! Këtë mrekulli e bëtë ju, lartmadhëri! (*Gjunjëzohet para tij.*)

KARDINALI: (*Me vete*) Sa për mua! E bëtë ju e jo unë. Sido që të jetë, ne do t'ia arrijmë qëllimit... Rafaeli le të bëhet gati për dhëndër...

HASANI: Por... Kam frikë... Se mos pendohet motra... Me të parë se do t'i vihet kurora, do të heqë dorë dhe nuk do ta pranojë.

KARDINALI: (*Me vete*) Po ku është ai fat... Zaten po të mos kisha këtë shpresë, si do t'i hyja kësaj loje? (*me zë*) Ti a je djegur ndonjëherë me zjarr? E di ti se ç'do të thotë të digjesh në zjarr? Ha! Ha! Ha! Ha! Kush është ai që një herë e pranon fenë katolike e pastaj tenton të heq dorë prej saj? E di ti se çfarë dënimi jepet për këtë? Dënim me djegie në zjarr!

HASANI: Mos!

KARDINALI: E di ti këtë? E ke parë ndonjëherë udhëzimin e Inkuizionit të shenjtë? (*nxjerr nga xhepi një libër dhe pasi e hap*

një faqe) Ja, shikoni! (E lexon vetë.) “Dënohen me djegie në zjarr të gjithë ata të cilët një herë e kanë pranuar fenë katolike, por pastaj janë penduar dhe e mohojnë atë.” E di ti se çfarë do të thotë djegie në zjarr? Të digjesh në zjarr, or burrë!

HASANI: Ah! E kam të qartë... Unë do t'i hyj në gjak motrës sime! (*Me vete*) Vallë, a thua përveç meje edhe dikush tjetër ka bërë mëkate të tilla?

KARDINALI: Jo, jo! Po kush të lejon që t'i hysh në gjak? Vetëm një pikë e gjakut të saj vlen sa e tërë kjo botë... Sa thashë, sa e tërë kjo botë? Jo vetëm kaq, por sa edhe bota tjetër. Tani më dëgjo vetëm mua (*duke i mbajtur në dorë çelësat*) dhe unë jam i gatshëm që të jap të gjithë çelësat e parajsës.

HASANI: Po si do t'ia bëjmë? Patjetër duhet menduar diçka... Ju përgjërohëm, të keni mëshirë! Por unë dyshoj se motra nuk do të pajtohet që të vërë kurorë... Mbase do ta mohojë premtimin e dhënë. E pastaj ç'do të... Uh, bre! Kur i mendoj këto, sikur më vret rrufeja!

KARDINALI: Jo, jo. Mos ki frikë, se nuk ndodh asgjë.

HASANI: Ah, e gjora ime motër! Unë jam ai që e binda dhe do ta djegin në zjarr!

KARDINALI: (*Me vete*) Jo, mos ki merak! Do ta dërgosh në kishë... Pranë meje...

HASANI: Të qofsha falë, premtimin e motrës sime nuk e dëgjoi askush përveç teje. Të lutem shumë që mos ta marrë

vesh ...askush këtë, se do t'i hyjmë në gjak motrës sime!
Mos, mos ta dëgjojë askush!

KARDINALI: Hesht...ttt! Ç'thua kështu? Mos ke hequr dorë nga Lionora, apo jo?

HASANI: Ah, jo bre! Jo!

KARDINALI: Atëherë?

HASANI: Por... Nuk mund ta duroj djegien e motrës sime në zjarr! Aq më tepër kur shkak për këtë jam unë! Jo, jo! Po sa gjëra të tmerrshme! Ose duhet të ndahem nga Lionora! Ose duhet të shoh motrën time duke u djegur në zjarr! ...Uh bre! Të lutem o Zot, ma merr shpirtin dhe mos t'i shoh këto!

KARDINALI: O biri im! E di ti se kush jam unë? Unë jam kardinali i këtij vendi dhe përfaqësuesi i Inkuizicionit të shenjtë. Sot në kohën e krishterëve, kardinali është shumë më i madh se mbreti! Nuk ka gjë që nuk varet nga njerëzit e Inkuizicionit! Nuk ka gjë që Inkuizicioni nuk mund ta bëjë! Ajo që për të tjerët mendohet se është e pamundur, për ne është lehtësisht e mundur. Ne o i bëjmë vetë, o i detyrojmë të tjerët ta bëjnë dhe kaq, puna merr fund! (*Hasani i habitur mbetet me sy hapur.*) Ja pra, këtë desha të them! Nëse unë dua – pa marrë parasysh se si qëndron puna - motrën tënde e shpëtoj nga zjarri. Dhe nuk do të digjet. Të jeni të sigurt dhe ta jap besën se nuk do të digjet!

HASANI: (*Pasi bie para këmbëve të kardinalit*) Oh! Ju faleminderit shumë! Po sa human, sa njeri i mirë që jeni ju!

KARDINALI: Por shiko pak këtu! Motra kurrresi nuk duhet t'i bëjë me dije Don Pedros dhe Don Rafaelit se gjoja ka dhënë pëlqimin. Ata le të jenë të bindur se këtu nuk ka kurrfarë dredhie. Përndryshe, nuk ta japin Lionorën!

HASANI: *(Pasi përsëri bie para këmbëve të kardinalit)* Ah, zotëria juaj! Do të veproj vetëm ashtu si thoni ju! Nuk do lëviz asnjë presje! Sepse ju qenkeni engjëlli që paskeni zbritur nga qielli për të plotësuar dëshirat e mia!

KARDINALI: *(Me vete)* Sikur të ma dinte qëllimin! Ky i gjo-ri mendon se unë jam duke punuar për të! *(Nga dera hyn Don Pedroja.)*

Skena e shtatë

Kardinali – Don Pedro – Hasani

DON PEDRO: *(Pasi gjunjëzohet para kardinalit)* Oh, falemin-derit shumë! Rrofshi! Zoti ju bekoftë! Pikërisht sot morën fund vuajtjet, mundimet dhe hallet e mia! Lionora dhe Rafaeli janë çmendur nga gëzimi. Dëshën të vijnë dhe të përkulen para jush, por më besoni, nga gëzimi që i ka pushtuar, nuk patën forcë që të ecnin. I qofshim falë Zotit! Atij i qofshim falë! Don Alfons, eja njëherë tek unë që të të puth në ballë. Tani je dhëndri im! Sot do ta bëjmë kurorëzimin. *(Kardinalit)* Apo jo zotëri Kardinal? Sot kemi për ta bërë kurorëzimin, apo jo?

KARDINALI: Po, sot. Ju bëhuni gati e unë po shkoj në kishë. T'u them që t'u bien kambanave! Le të mbliidhen njerëzit.

DON PEDRO: Në rregull. Unë do të shkoj dhe do ta bëj gati vajzën time, meqë unë jam edhe babai, edhe nëna e saj. Po edhe ju Don Alfons, bëni gati motrën tuaj, që mos të humbasim kohë. (*Kardinali del dhe pas tij edhe Don Pedro.*)

Skena e tetë

HASANI: (*Me vete*) Nuk e di a është ëndërr apo e vërtetë? Sot do të bëjmë kurorëzimin! Por... Ah, po sikur ky kurorëzim të bëhej vetëm mes meje dhe Lionorës! Pra, jo edhe mes motrës sime dhe Rafaelit! Por jo! Për fat të keq, ja që njëkohësisht do të bëhen që të dy. Prandaj do të përjetoj njëkohësisht një gëzim dhe një hidhërim! Ah, tani motrës ...edhe njëherë më duhet ...t'i kujtoj se gjoja ...e ka emrin Elizabetë dhe se pas një a dy ore duhet të shkojmë në kishë për të bërë kurorëzimin me Rafaelin! Ndërsa ajo, do të pranojë ose nuk do të pranojë! Ose nuk do të mund ta durojë këtë dhe do të vdesë! Mbase do ta humbas motrën time! Atë e solla para një fatkeqësie të paparë! Ah, më erdhi rasti që ta marr Lionorën dhe ...të më plotësohet dëshira ime! Ah, sa gëzim i madh do të jetë ky rast për mua! Por, sa vlen ky gëzim kur hidhërimi i motrës sime është për mua një mijë herë më i madh! Ah, Fatma, Ah! Unë do të jem shkaktari i vdekjes sate. Do kishte qenë më mirë të lejoja që të shkoje me Ridvanin! Është e saktë që unë nuk do ta kisha parë më... Por shumë më mirë do të ishte që mos ta shihja, sesa kështu ta mbys me duart e mia! Aq më tepër madje nuk do të ndaja dy të dashuruar. Ndërsa tani më duhet t'i përgatis rrobat e nusërisë për të shkuar në kishë. Më duhet ta bind edhe një herë se aty do të kurorëzohet me Rafaelin! Po sa gjëra të vështira janë këto! Sa të tmerrshme që janë! Kam frikë se ajo

nuk do t'i përballojë këto mundime dhe do të vdesë! Ose para kardinalit dhe para gjithë të pranishmëve të tjerë, do ta mohojë atë që e ka pranuar dhe pastaj do të digjet në zjarr! Uh bre! Por megjithatë, Kardinali ma dha besën se nuk do ta djegë në zjarr... Inshalla e mban fjalën! Sa për fillim duhet ta bind për t'i veshur rrobat e nusërisë për të shkuar deri në kishë e pastaj... (*Lionora hynë nga dera e fundit me një shportë të nusërisë në dorë.*)

Skena e nëntë

Lionora – Hasani

LIONORA: (*Pasi e lë shportën mbi tavolinë*) Alfons, na u plotësuan dëshirat! (*Dëgjohen të rënat e kambanave.*) Alfons, i dëgjon këto kambana? Këto bien për nder të kurorëzimit tonë! (*Pasi e përqafton Alfonsin*) Oh, më në fund! Lavduar qofsh o Zot! Po sa ditë e lumtur që është kjo e sotmja! Sa ditë e shenjtë! Mundimet dhe vuajtjet morën fund!

HASANI: (*Pasi e përqafton Lionorën*) Ah, Lionorë moj! Që nga sot, unë do të jem burri yt, e ti gruaja ime! Je e sigurt, apo jo?

LIONORA: (*E shastisur*) Ç'thua Alfons?

HASANI: Ah, nuk mund ta besoj!

LIONORA: Ah!

HASANI: Kam frikë se mos na del ndonjë pengesë përsëri! Ndonjë telash i papritur!

LIONORA: Alfons, ç'je duke thënë, o Alfons? Ç'është ai telash i papritur ore? Pengesa jonë ishte mospranimi i motrës sate. E tani ajo ka pranuar dhe e ka dhënë pëlqimin që të quhet Elizabetë. Ajo tani është Elizabetë e jo Fatma.

HASANI: Jo mirë!

LIONORA: Ah, e përse? Ende nuk e ka dhënë pëlqimin? Si është e mundur kjo? Sot do ta kurorëzojnë me Rafaelin. E nëse ajo akoma nuk e ka dhënë pëlqimin e...

HASANI: Ah!

LIONORA: A nuk e dha pëlqimin? (*Hasani hesht.*) Hajde, më thuaj? Të lutem! Më thuaj, ...akoma nuk e dha, apo?

HASANI: E dha, por...

LIONORA: Ç'është kjo? E dha, por...?

HASANI: Mirë, e dha.

LIONORA: Atëherë, nëse është kështu, puna është e kryer... Përse po mendon? Koha po kalon... (*Pasi shikon nga dritarja*) Të gjithë janë duke ardhur në kishë. Po shkoj edhe unë të bëhem gati. Ti merri këto rroba dhe vishja motrës sate... Shpejt se nuk mund të pres më! (*Pasi e kap për dore*) Uh, edhe vetëm një orë! (*E gëzuar del jashtë.*)

HASANI: Inshalla! (*Me vete*) Nuk besoj fare! (*duke i shikuar rrobat në shportë*) Është gjë e pamundur që këto rroba t'i veshë Fatma! E kotë, është e kotë!

Skena e dhjetë
Hasani – Fatma

FATMA: *(Duke hyrë nga e majta)* Ah! Hasan! Po përse bien këto kambana? *(duke shikuar nga dritarja)* Të gjithë janë duke nxituar për tek xhamia e madhe... Jooo, për tek kisha, desha të them... Uh bre!

HASANI: Ah, e mjera kjo! Sikur ta dinte përse bien kambanat! Por tani më duhet t'i tregoj... Por si t'ia bëj, kam frikë!

FATMA: *(Duke iu afruar Hasanit)* Hasan!

HASANI: Ah! Të lutem! Mos më thuaj Hasan!

FATMA: Po si të quaj ndryshe? Akoma me të vjetrën?

HASANI: Mos, se na dëgjojnë! Na dëgjon dikush dhe pastaj nuk mund të ikim.

FATMA: *(ngadalë me zë të ulët)* Po kur do ikim? E binde Lionorën?

HASANI: Pa vënë kurorë nuk mund ta bind Lionorën. E pra sot do kurorëzohemi dhe tani pas dy a tri dite, do ikim.

FATMA: Hasan! Po ç'thua ti ore? Sot do kurorëzoheni? Po i ati i saj e pranoi?

HASANI: E miratoi, por...

FATMA: Ç'do të thotë por...?

HASANI: Nëse e bëjmë edhe kurorëzimin tënd...

FATMA: Mos! Të lutem! Ç'je duke thënë ore? Ah ti, o i poshtër, më mashtrove! Më more në qafë! *(Sikur i bie të fikët, rrëzohet mbi një karrige.)*

HASANI: Fatma! Moj Fatma! Po përse bën kështu, moj? Ti vetëm do thuash se pranon që të martohesh me Rafaelin, ndërsa në të vërtetë nuk do të martohesh me të, e kur ata të binden për këtë, do t'ju lënë të lirë. Pastaj edhe unë do ta bind Lionorën dhe që të tre do ikim së bashku.

FATMA: Po unë e pohova para ...Kardinalit e tani... Çfarë duhet bërë tjetër?

HASANI: Fatma, motra ime e dashur! Për t'i bindur ata dhe pastaj për të ikur, në mënyrë që unë ta kem Lionorën e ti Ridvanin dhe t'i arrijmë qëllimet tona, na duhet që ta pranojmë çdo propozim të tyre... Kurorëzimi do të bëhet sipas dokeve të tyre... Ti do veshësh këto rroba dhe krah për krah me Rafaelin, pa u dalldisur fare, dhe unë krah për krah me Lionorën, të gjithë së bashku do të shkojmë në kishë. Aty do jenë gati për të bërë kurorëzimin zyrtar, Kardinali dhe gjithë kishtarët e tjerë... Pastaj, me të kaluar nja dy a tri ditë, nëse nuk të shpëtojnë...

FATMA: *(Duke vajtuar me pikëllim)* Jo! Nuk dua! Një tradhti të tillë nuk e pranoj dot! Thjesht, nuk bën!

HASANI: Ah, Fatma! Të lutem mos! Se mbarojmë që të dy! Të kesh mëshirë qoftë për mua, nëse s'ke ndaj vetvetes! Meqë ti para Kardinalit e pranove emrin Elizabetë... E tani ç'kemi për t'i thënë? Kur Inkuizicioni një herë të pranon si të tyren, kush heq dorë nga ai pranim, i jepet dënimi me djegie në zjarr. Të qofsha falë, mos u bëj shkaktare e djegies sonë në zjarr!

FATMA: Ti nëse do, shpëtoje veten. Ndërsa unë jam gati për të vdekur... Po qe se duhet bërë një tradhti e tillë, unë jam gati të vdes! Çfarë më duhet jeta pa Ridvanin? Tani e kam të qartë! Prandaj dua vetëm të vdes dhe kaq! Se vetëm vdekja për mua është shpëtim dhe asgjë tjetër!

HASANI: Fatma! Nëse nuk të dhimbsem unë dhe nuk të dhimbset vetja, nuk të dhimbset as Ridvani?

FATMA: As Ridvani! E ku është ai? Ty nëse po të dhimbset Ridvani, përse më ndave nga ai?

HASANI: Isha i detyruar t'ju ndaja që të martohesha me Lionorën. E kur ta marr Lionorën për grua, do t'ju bashkoj edhe juve! Ti mos dysho fare, se unë e gjej Ridvanin!

FATMA: *(me mallëngjim)* Ah, po si ta besoj?

HASANI: Mos ki frikë fare! Por duhet të pranosh atë që të thashë...

FATMA: *(Me britmë)* Jo! Nuk e bëj dot! Sikur edhe mos ta shoh kurrë më Ridvanin, përballe tij nuk mund të zë në gojë asnjë fjalë tradhtie. Mund të jem e ndarë përgjithmonë nga

ai, por do vdes si gruaja dhe e dashura e tij besnike! Ashtu si e kam dashurinë në zemër, po me aq dashuri do ta ruaj edhe emrin e Ridvanit në gjuhën time! Unë nuk mund të jem ajo që frikësohet nga vdekja dhe e tradhton Ridvanin me gjuhën e saj! Jo, jo! Kurrë nuk e bëj këtë!

HASANI: Moj motra ime! Por unë asnjëherë nuk të kam thënë që ti të harrosh Ridvanin, sepse duhet të martohesh me Rafaelin. Të thashë dhe të them që ta thuash atë fjalë, vetëm e vetëm që ne të shpëtojmë nga duart e tyre, për të takuar Ridvanin.

FATMA: Jo, nuk mund ta them! Kam frikë se Ridvani do ta dëgjojë!

HASANI: Po çfarë ankthi është ky ore! Po kush e di sa larg është Ridvani nga këtu.

FATMA: Ai mund të jetë larg, por dashuria ime për të është shumë e afërt. Prandaj si mund të më dalë një fjalë e tillë nga një zemër e dashuruar?

HASANI: Po mirë! Ti pak më parë the që para Kardinalit e pranove... E tani ç'është ky pendim?

FATMA: Po dhe ia thashë! Por a më pe se si u bëra derisa i thashë... E tani aq më keq, meqë duhet thënë para një mijë vetave, e jo vetëm para Kardinalit.

HASANI: Atëherë, nëse thua kështu, puna jonë mbaron me kaq! Nuk ka shpëtim për ne! Ti para Kardinalit u betove,

ndërsa tani nuk e mban fjalën. prandaj për këtë faj, sipas rregullave të Inkuizicionit, ti dënohesh me djegie në zjarr.

FATMA: Si the, për këtë faj a?

HASANI: Po, unë mendoj se është faj. Dhe për këtë faj, dënimi është me djegie në zjarr. Po nëse edhe ty të djegin në zjarr (*Vajton*)... Ah moj motra ime!

FATMA: Sikur Ridvani të ishte gjallë, vdekja në rrugën e dashurisë për të, apo edhe djegia në zjarr, do të ishte një kënaqësi për mua! Por ai nuk është gjallë! Po sikur unë të vdisja e Ridvani të jetonte, nuk do doja kurrë! Do t'ia kisha zili jetës! Do t'i kisha zili diellin, hënën dhe qiejt që do ta shihnin fytyrën e Ridvanit! Jo, jo! Përse unë të vdes, kur Ridvani është gjallë! Sido që të jetë, tani për tani, mes meje dhe Ridvanit megjithatë ka një lidhje, ka një marrëdhënie. Që të dy jemi gjallë! Po nëse unë vdes e Ridvani më harron mua dhe dashuron dikë tjetër... Ah! Jo! Nuk dua të vdes! Jo, jo, nuk dua të vdes!

HASANI: (*Me vete*) Ah, e gjora motër! Edhe kjo është e dashuruar si unë! Dhe unë duke e ditur se ç'do të thotë të jesh i dashuruar, më bie që dashurinë time ta sakrifikoj për dashurinë e saj! Ç'kuptim ka kjo! Thua se lumturia ime varet nga fatkeqësia e saj! (*me britmë*) E dashura motër, për çdo punë duhet maturi. Tani këtu janë vetëm dy rrugë: Ose do ta tërheqësh atë fjalë që the pak më parë, ose do të bësh atë që të them unë. Nëse nuk e mban fjalën, ti do digjesh në zjarr, ndërsa unë do vdes nga vuajtjet!

FATMA: Ah!

HASANI: Ndërsa po më dëgjove mua, ne do t'i mashtrojmë këta. Do shpëtoj unë me Lionorën dhe ty do të të dërgoj tek Ridvani.

FATMA: Ah! Si mendon ti, a ka mundësi? Unë nuk besoj fare!

HASANI: Ka mundësi, nëse bën ashtu si të them unë...

FATMA: Ah, po sa kusht i vështirë!

HASANI: *(duke shikuar nga dritarja)* Të lutem Fatma, se koha na iku! Merri këto rroba dhe vishi. Shpejt dhe mos u vono!

FATMA: Ridvan! Më beso se këtë e bëj vetëm për ty! Se këtë tradhti ndaj shpirtit tim dhe dashurisë sime për ty, e bëj vetëm për hatrin tënd. Prandaj, më fal o Zot! *(I afrohet shportës dhe me të marrë në dorë njërën nga ato rroba, sikur i bie të fikët dhe sa nuk rrëzohet.)* Të lutem, o Zot! Ç'po ndodh me mua! Uh bre! Vdiqa!

HASANI: *(Duke e sjellë Fatmën për rdore)* Uh bre! Nuk po mundem! *(me zë të lartë)* Durim, moj motër! Durim! Ky është një rast i mirë për lumturinë tonë dhe të Ridvanit.

FATMA: Të Ridvanit a!

HASANI: Po, vetëm edhe pak durim nëse do lumturinë e Ridvanit!

FATMA: Të lutem o Zot, m'i jep trupit tim forcë dhe shpirtit tim gajret! *(Pasi e merr shportën, del nga e majta.)*

HASANI: Vishu dhe unë do vij të të marr. (*Del nga dera e fundit, bie perdja.*)

PAMJA E KATËRT

(*Shihet brendia e një kishe me shumë shtylla të stolisura. Në të djathtë disa priftërinj të rrethuar nga shumë të pranishëm. Ridvani i veshur me rroba spanjolle, hyn nga e majta duke shikuar me habi anekënd.*)

Skëna e njëmbëdhjetë

RIDVANI: (*Me vete*) Para një muaji, kjo ishte një xhami. (*duke treguar vendin*) Sa herë jam falur mu në këtë vend. Po sa ndryshim i madh! Ndërrim marramendës! Ah, o vatan, vatan i dashur! (*pas një meditimi mallëngjyes*) Po Ajo! Fatma... A thua ku është ajo? Është gjallë? Ende më dashuron? Ah, e mjera ajo, edhe nëse është gjallë, mbase është në duart e armikut! A thua do ta gjej? A do të mund ta shpëtoj? Ah, nuk besoj fare! Po sido që të jetë... Sikur ta gjeja dhe të vdisja para këmbëve të saj! Vetëm ta shihja edhe një herë! Ah, po eci që nga mëngjesi dhe nga ajo nuk mora vesh asgjë! E nuk guxoj të pyes askënd. Hajde të shohim... Po sa kallaballëk që është këtu, mbase duhet dëgjuar ndonjë lajm. (*Duke iu afruar një plaku që është mbështetur pas një shtylle dhe mendon*) Babaxhan! Më falni, dua t'ju pyes diçka. (*Plaku ngre kokën dhe shikon në sytë e Ridvanit*) Për çfarë janë grumbulluar këta njerëz? Ka vdekur dikush?

PLAKU: (*Pasi kollitet*) Hej, ti o biri im! Po përse nuk the diçka për të mirë! Ç'kuptim ka kjo që përmend vdekjen? (*përsëri pas një kollitjeje*) Dasmë ka... Dasmë!

RIDVANI: Dasmë! Po kush martohet?

PLAKU: Po përse e fut veten në siklet, or ti? Apo ke frikë nga dasma, ndërsa vdekja ...s'të prish punë? Ha! Ha! Ha! (*Të qeshurat i kthehen në kollitje.*) Po, po, tani e kam të qartë. Ti mbase do jesh ushtar meqë ngazëllehesh kur sheh njerëz të vdekur... Prej nga je?

RIDVANI: Nga Aragona.

PLAKU: Hë, nga Aragona!

RIDVANI: Po kush thatë që martohet? (*Plaku ngaqë nuk mund të përgjigjet nga kollitja që e ka zënë, bën me gishta se bëhet fjalë për dy martesë.*) Urdhëroni?

PLAKU: (*Duke u kollitur*) Dy... (*përsëri kollitet*) Dy veta... Në fakt katër... veta... Pra janë dy dasma.

RIDVANI: Kush dhe me kë martohet?

PLAKU: Të parët janë Don Alfonsi me Lionorën...

RIDVANI: Don Alfonsi! Po kush është ky Don Alfonsi?

PLAKU: Është një mysliman i konvertuar.

RIDVANI: (*Me vete*) Ah, ai duhet të jetë! (*plakut*) Po deri sa ishte mysliman, si quhej?

PLAKU: Hasan... I biri i ibn-i Hatibit me famë... Mbase keni dëgjuar?

RIDVANI: (*Me vete*) Ah, i poshtër! (*plakut*) Kush tjetër mar-tohet?

PLAKU: Don Rafaeli me Dona Elizabetën.

RIDVANI: Dona Elizabeta?

PLAKU: Po... (*kollitet*) Motra e Don Alfonsit... (*Kollitet dhe për të pështyrë e ul kokën dhe përkulet.*)

RIDVANI: (*I hidhëruar tej mase, me vete*) Uh bre! A është e mundur kjo? Fatma! Ajo të ma bëjë këtë tradhti! Ah, të lutem o Zot! Ma merr shpirtin mua! (*Qan për një kohë i mbështetur në një shtyllë, ndërsa kryet e mban me duar.*) Por jo! Do të hakmerrem! (*pasi i afrohet plaku*) Nuset me dhëndurët a vijnë këtu?

PLAKU: Po do vijnë... Tani.

RIDVANI: Ah! A është e mundur që Fatma të ma bëjë këtë tradhti?! Këtë pabesi! Si duket besën nuk po e mbajtkë askush! (*Nga e djathta hynë Kardinali duke u prirë murgjvë. Ata i përcjell Don Pedroja, ndërsa pas tij hyjnë të kapur dorë për dorë Hasani me Lionorën dhe Rafaeli me Fatmën. Ridvani me të parë Fatmën, tmerrohet, struket në një qoshe dhe shikon me habi. Nu-*

set me dhëndurët parakalojnë dhe pastaj me rend qëndrojnë në këmbë. Don Pedroja rri pas tyre, ndërsa Kardinali u del përpara. Fatma është zverdhur e tëra dhe dridhet.)

Skena e dymbëdhjetë

Ridvani – *(pastaj) një shok i tij - Amrui*

RIDVANI: *(Duke shikuar me vëmendje nga Fatma. Me vete)* O Zot! Është ajo?

Apo nuk është? Ose unë e kam gabim, mashtrohem? Jo, jo! Ajo është! Fatma, Fatma! Ajo vetë është! Ah! Aman o Zot! Ç'po ndodh me mua! Vdiqa! Mbarova! Por jo! Megjithatë nuk do vdes pa u hakmarrë... Pa u hakmarrë ndaj tyre, nuk dua të vdes! Së pari t'i mbys që të katër e pastaj edhe vetveten! *(E nxjerr shpatën dhe merr hov për të ecur.)*

AMRUI: *(Pasi vrapon dhe mbërrin ta kapë për krahu)* Ç'je duke bërë, Ridvan?

RIDVANI: *(Me t'u kthyer)* Uh bre, a nuk je duke parë? Ajo nusja atje është Fatma!

AMRUI: Ti mos u merr me ata. Mos ki merak se kjo e tëra është një intrigë, një kurdisje. Unë e di këtë.

RIDVANI: *(I gëzuar)* Ah, ashtu thua!

AMRUI: Po unë e kuptova. Kjo e tëra është një kurdisje, një intrigë. Fatma është e jotja dhe së shpejti do të jeni bashkë! Ti tani shko e unë pastaj do të të jap sihariqin!

RIDVANI: Po, ç'je duke thënë, o vëlla?

AMRUI: Të thashë ti tani shko e unë pastaj të tregoj më hollësisht.

RIDVANI: Amru, të lutem, më trego sa më parë? Nuk mund të pres!

AMRUI: Jo, ti tani nuk duhet ta dish! Nëse e do lumturinë tënde, nuk duhet ta dish. Ik prej këtej sa më parë!

RIDVANI: *(Pasi e fut shpatën në këllëf)* Atëherë po shkoj... Por, të lutem mos u vono! Eja sa më parë, se nuk duroj dot! Të qofsha falë! *(Del.)*

Skena e trembëdhjetë

*Kardinali - Hasani - Lionora - Rafaeli - Fatma -
Don Pedro - Murgjit me murgeshat - Amrui*

KARDINALI: Don Alfons, a e pranon ti për grua Lionorën?

HASANI: Po.

KARDINALI: Lionorë! E pranon ti Don Alfonsin për burrë?

LIONORA: Po.

KARDINALI: Ja pra, me lejen e Zotit dhe me pajtimin e Don Alfonsit dhe të Dona Lionorës u bë ky kurorëzim martesor i tyre. Zoti i bekoftë!

TË GJITHË: Amin!

KARDINALI: Tani u vini kurorat. (*Një murg i vendos kurorat në kokën e Hasanit dhe të Lionorës.*)

KARDINALI: Ti Don Rafael, a e pranon Elizabetën për grua?

RAFAELI: Po. (*Fatmës i keqësohet gjendja nga të dridhurat dhe nuk mund të rrijë në këmbë. Don Pedroja i afrohet nga pas dhe e kap nga krahu.*)

AMRUI: (*Me vete*) Pale të shohim se a do të mund të dalë nga goja e Fatmës fjala “po”? Tani është radha e saj.

KARDINALI: Ti Elizabetë, a e pranon Don Rafaelin për burrë? (*Fatma nuk mund t'i përgjigjet.*) Hë! Hajde, përgjigju! Thuaj të vërtetën dhe vetëm të vërtetën! Këtu nuk gënjehet dot!

AMRUI: (*Me vete*) Ah, nuk mund të flasë!

HASANI: (*me zë të ulët i pëshpërit Kardinalit*) Ju lutem! Shkëlqesi!

DON PEDRO: (*Fatmës me zë të ulët*) Po thuaj, bija ime! Po!

MURGU: E gjora, si duket nuk e di rendin e meshës!

KARDINALI: Jo që nuk e di rendin e meshës, por mendoj se nuk e do Rafaelin! (*Me vete*) Dhëntë Zoti e thotë “jo”!

RAFAELI: Ah!

KARDINALI: Bija ime, tani nuk është çasti për të menduar. Unë të pyeta dhe pres përgjigjen... Dhe të kuptohemi, dua përgjigjen e vërtetë dhe jo të gënjeshtër. Dua të ma thuash atë që ndien në zemër. Dhe mos të kesh frikë nga askush!

HASANI: *(Kardinalit me zë të ulët)* Shkëlqesi, ju lutem!

KARDINALI: Hajde, më thuaj tani? Don Rafaelin e pranon për burrë? Apo s'e pranon?

DON PEDRO: Thuaje, pa frikë!

FATMA: Ee pra...

DON PEDRO: Shumë bukur!

HASANI: Oh, mos!

KARDINALI: Të thashë he, vetëm të vërtetën të më thuash!

FATMA: Ee pra... Uh more! Ju lutem! Po përse të gënjej? S'e pranoj! Nuk e pranoj dhe fund! *(Tërhiqet prapa.)*

RAFAELI: Ah!

HASANI: Motra ime!

AMRUI: *(Me vete)* Oh, shyqyr more! Po sikur edhe Ridvani të ishte këtu dhe ta dëgjonte!

DON PEDRO: Medet!

MURGIT DHE MUREGESHAT: Oh, oo! Oh, o o!

KARDINALI: E dëgjuat apo jo? Mbase edhe krishterimi i saj nuk është i vërtetë... (*Fatmës*) Po si quhesh ti?

FATMA: Fatma! Fatma quhem! Jam e bija e ibn-i Hatibit... Gruaja e Ridvanit...

Fatma! Nuk mund ta tradhtoj edhe më tutje atdheun dhe burrin tim, fenë time! Ky (*Duke treguar me gisht Hasanin*) më mashtroi dhe më solli këtu! Më bëri me turp para jush! Tani jam në duart tuaja dhe më bëni çfarë të doni! Në botën tjetër do të përgjigjeni ju dhe ky!

AMRUI: (*Me vete*) Ah, Ridvan more, po ku je?

HASANI: (*Kardinalit me zë të ulët*) Po ku është premtimi juaj?

KARDINALI: (*shpërthen*) Çfarë të duhet ty? Ti e more Lionorën, apo jo?

HASANI: Ej, po nëse unë them që ti e mashtrove?

KARDINALI: (*Dukshëm i zemëruar por me zë të ulët*) Atëherë edhe unë të ndaj ty nga Lionora! Po e bëre dhe e zbulove të fshehtën, harroje Lionorën përgjithmonë.

HASANI: (*Me vete*) Ah! Më në fund, motrën time e flijova për Lionorën... Për dashurinë time!

DON PEDRO: Ç'thoni ju, ore? Se ky gjoja e mori Lionorën apo jo? Jo, kurrë! Nëse motra e tij nuk pranon, as ky kurrë ...s'ka për ta marrë vajzën time!

LIONORA: Oh more!

HASANI: Ah! (*Me vete*) E humba edhe motrën, edhe Lionorën!

KARDINALI: Don Pedro! Ç'thua kështu? Ti mendon se nëse je Don mund të bësh çfarë të duash, apo jo? Tani sapo i shkrova Inkuizicionit, ...do mbarojë puna juaj! Vendimin e Inkuizicionit nuk mund ta prishë jo një Don, por as një mbret... Madje as një perandor! Kurorëzimi i tyre ka marrë fund dhe këta nuk mund të ndahen më!

LIONORA: Oh!

HASANI: O Zot!

RAFAELI: Ah! Unë mbeta i vetmuar dhe i dëshpëruar!

DON PEDROJA: Ah, o biri im! (*E përqafton të birin.*)

KARDINALI: (*Murgjve*) Merreni këtë (*duke bërë me dorë nga Fatma*) dhe çojeni në kishë! Dhe deri sa të vij unë, mbajeni në burg! (*Murgjit e kapin Fatmën nga krahët dhe e çojnë.*)

FATMA: (*Duke qarë*) Ah, Ridvan more!

AMRU: (*Me vete*) Ah, e mjera kjo! E mendon Ridvanin! Vallë, a thua Ridvani do të ketë mundësi që ta shpëtojë? Sikur ta dija se mund të bëja diçka, që tani do t'u isha vërsulur menjëherë dhe do t'i kisha vrarë një dy a tre dhe... Por s'e vlen barra qiranë!

HASANI: Ah, motra ime!

(*bie perdja*)

AKTI I KATËRT

PAMJA E PESTË

(Është një dhomë e kishës. Në fund të dhomës dhe në të djathtë, ka nga një derë. Ndërsa pranë derës së fundit, është një tavolinë dhe një dollap me libra. Mbi tavolinë, ...është një glob dhe një kurorë kardinali. Në të majtë, një kolltuk dhe disa karrige të tjera. Në mur janë varur ca ikona, ndërsa mbi derë një kryq i madh.)

Skena e parë

KARDINALI: *(Me vete)* Faleminderit o Zot, që ia arrita qëllimit! Tani kjo vajzë është në duart e mia... Prandaj meqë liria e saj varet nga unë, kjo nënkupton që edhe jeta i saj gjithashtu varet nga unë. Po desha mund ta mbys, mund ta djeg... Por jo, nuk dua. Sepse ajo më hynë në punë... Por a thua do të kem sukses që ta bind? Nuk dyshoj aspak, meqë tani e kam shumë më lehtë! Sepse nëse dënohet, dënimi për të do të jetë me djegie në zjarr. Kur ta bëj me dije për dënimin që e pret, do t'i them se është e detyruar që ose të pranojë çfarë i themunë, ose e pret dënimi me djegie në zjarr. Dhe me këtë puna mbaron... Kur njeriu bëhet kardinal, pa mëdyshje që pastaj mund të bëjë çfarë të dojë... Është i suksesshëm në çdo punë. Sot fuqinë që ka Papa i shenjtë, cili mbret tjetër mund ta ketë? Sot autoritetin që kanë kardinalët dhe murgjit, kush tjetër mund ta ketë? Atë që sot mund ta bëjë Inkuizicioni, a mund ta bëjë dot dikush tjetër? Inkuizicioni është ai që i dëboi nga Spanja arabët, të cilët e push-

tuan këtë vend me njëqind kuaj, për dhjetë ditë dhe sunduan në Spanjë gati shtatë-tetë shekuj me radhë! Vetëm në sajë të Inkuizicionit, sot në Spanjë nuk dëgjohet asnjë emër mysliman! Qëllimi i Inkuizicionit është, që të jetë mbi çdo gjë të mundshme dhe të sundojë në mbarë botën. Papa i shenjtë do të jetë mbret i njerëzimit! Përveç nesh nuk do të ketë sundimtarë të tjerë! Të gjitha këto do bëhen në sajë të Inkuizicionit! Rroftë Inkuizicioni! (*Murgesha kryesore hyn nga dera me duar të lidhura në gjoks dhe qëndron në këmbë.*)

Skena e dytë

Kardinali – Murgesha kryesore

KARDINALI: (*duke u kthyer, me të parë murgeshën*) Ju jeni apo jo? Doni të thoni diçka?

MURGESHA: Desha t'ju bëj me dije lidhur me atë vajzë që dërguam dje në kishë... E kemi vendosur në bodrum... Si të vep-rojmë më tutje? T'ia vëmë prangat? Ta lëmë pa bukë? Çfarë dënimi t'i japim? Mua më duhet të di fajin e saj në mënyrë që...

KARDINALI: Faji i saj është tejet i madh. Prandaj edhe dënimi do të jetë gjithashtu i madh... Vetëm nëse ajo do, do t'ia fal.

MURGESHA: Urdhri është juaji.

KARDINALI: Gabimi i saj është, se një herë e pranoi krish-terimin, por pastaj e mohoi.

MURGESHA: Ëhë! Atëherë si mund t'ia falni? A është faj që mund të falet ky?

KARDINALI: Po nëse ia fal, kush mund të më thotë diçka?

MURGESHA: Të lutem! Mos po e zemëroni Papën dhe Inkuizicionin me këtë!

KARDINALI: Iha! Ku do ta marrë vesh Papa apo Inkuizicioni? Apo mos vallë, këtu brenda në kishë ka edhe spiunë?

MURGESHA: Ah!

KARDINALI: Mirë, shiko këtu se çfarë po ju them! Ata që nxjerrin fjalë jashtë kishë, se çfarë ndodh këtu brenda, kam për t'i djegur në zjarr që të gjithë! Ta keni parasysh këtë!

MURGESHA: Eej! Kush është ai që guxon t'i zbulojë të fshehtat tona?

KARDINALI: Po, do t'ia fal ... Vetëm nëse ajo do vetë...

MURGESHA: Natyrisht që ajo do! Po, si ka mundësi që mos të dojë?

KARDINALI: Po ka mundësi, sepse unë do t'ia fal, por vetëm me një kusht... Nëse nuk e plotëson atë kusht...

MURGESHA: E çfarë kushti është ai?

KARDINALI: Unë kam shtënë dashuri në të... Syri më ka mbetur tek ajo...

MURGESHA: Aha! Por ku ka logjikë që të falet një mëkatare e tillë dhe pastaj të... Kam frikë se mos ju ndodhë ndonjë

gjë e keqe për... Në kishë kemi aq shumë vajza, secila është më e bukur se tjetra... Dhe ti në çdo kohë mund ta...

KARDINALI: Hej ti! Mos më hidhëro më shumë! Atë e dua dhe pikë! Ju doni të më shisni mend mua?

MURGESHA: Jo, jo, larg asaj! Por...

KARDINALI: Mirë, mirë... Në rregull është. U kuptuam. Tani shko dhe ma sill vajzën.

MURGESHA: Si urdhëroni, shkova...

Skena e tretë

KARDINALI: (*Me vete*) Të shohim a do të mund ta bind? A do ta pranojë ofertën time? Do t'i them që ia lejoj predikimin e fesë islame, por në mënyrë të fshehtë. Por emrin megjithatë duhet ta ketë Elizabetë. Duhet të vishet si murgeshë dhe para njerëzve duhet të thotë se është e krishterë. Publikisht, patjetër duhet të marrë pjesë në meshë, ndërsa pastaj nëse do, le të falet fshehurazi edhe sipas fesë islame. Do t'ia ofroj këtë kusht në mënyrë që ajo të më dorëzohet. Pastaj do ta bëj kryemurgeshë... E çfarë mund t'i bëj më shumë? Duke qenë e dënuar me djegie në zjarr, unë i ofroj një mundësi të tillë për shpëtim dhe lumturi! Prandaj nëse nuk është dakord edhe me këtë... Por jam mëse i bindur se do të pranojë... Nëse jo sot, atëherë nesër mbase... Por deri sa te pranojë, do ta lë në bodrum. Do t'ia vë prangat në këmbë e duar. Nuk do t'i jap as të hajë e as të pijë! Ose do pranojë ose...

(Me britmë) Ose le të vdesë! (Kryemurgesha hyn nga dera me Fatmën përdore, e cila duket e raskapitur dhe në gjendje të mjerueshme.)

Skena e katërt

Kardinali – Fatma -Kryemurgesha

MURGESHA: Eja dhe përkulu para kardinalit... Ai do të të shpallë të pafajshme.

KARDINALI: Ti para disa ditësh, në praninë time, a nuk e pranove emrin Elizabetë?

A nuk e dhe besën se do të martoheshe me Rafaelin?

FATMA: ...

KARDINALI: Hajde më thuaj. E pranove apo nuk e pranove? Hë!

FATMA: *(duke u dridhur)* E pranova... Por...

KARDINALI: *(duke ia ndërprerë fjalën)* Atëherë, si pate guxim që në kishë, para gjithë atyre njerëzve ta mohojë një gjë të tillë?

FATMA: Mua... Vëllai im...

KARDINALI: *(duke ia ndërprerë fjalën)* Nëse nuk do që të martohesh me Rafaelin... Atëherë mos u marto... Unë nuk të detyroj.

FATMA: *(me gëzim)* Vërtet!

KARDINALI: Por krishterimin mos e lër...

FATMA: Po unë as që u bëra e krishtere që...

MURGESHA: Mos!

KARDINALI: Hesht!

MURGESHA: Po a e dëgjove se ç' tha?

KARDINALI: *(pasi nxjerr nga xhepi udhëzimin e Inkuizicionit)*
A e di ti dënimin për fajin që ke bërë dhe je duke bërë akoma? Ja tani më dëgjo, ta them unë... *(Shfleton një faqe dhe fillon ta lexojë.)* “Ata të cilët njëherë e pranojnë fenë katolike, por pastaj e mohojnë, duke u penduar, dënohen me djegie në zjarr.” E kuptove?

FATMA: Po e kam të qartë dhe jam e gatshme edhe për atë!

MURGESHA: Mos moj, po sa inat i fortë! Çfarë fanatizmi!

KARDINALI: Bija ime! Nëse nuk do që të martohesh me Rafaelin, atëherë mos u marto dhe për këtë askush nuk të detyron. Por emrin Elizabetë pranoje dhe unë të shpall murgeshë. Do të jesh këtu në kishë... Ky rast për ty është një shpëtim për lumturinë tënde. A i sheh këto murgesha këtu sa të lumtura që janë! Sa respekt dhe autoritet që kanë! Pasi ai Ridvani që do ti, nuk është i gjallë...

FATMA: Ah!

KARDINALI: Dhe ti nuk do dikë tjetër... Atëherë përveç kishës, për ty nuk ka vend tjetër për shpëtim.

FATMA: Ridvani është gjallë!

KARDINALI: Ridvanit, tanimë edhe eshtrat i janë zhdukur... Përveç teje, sot askush nuk mendon për Ridvanin!

FATMA: Aa, jo jo! Mua më erdhi lajmi... Ridvani është i gjallë! *(Me vete)* Ah, o Zot! Çdokush e do vdekjen e Ridvanit! Gjithë dynjaja u bënë armiq me të dhe me mua! Vallë, po çfarë bëmë ne që të kemi kaq shumë armiq?
(Kardinali me një shenjë urdhëron kryemurgeshën që të dalë jashtë dhe pasi shpëhet, bie në mendime.)

Skena e pestë **Kardinali – Fatma**

KARDINALI: *(Pasi i afrohet Fatmës)* Shikomë një herë kënde! Unë ty të dua...

FATMA: *(e shastisur)* Ah, medet!

KARDINALI: Për të të futur ty në dorë, bëra një mijë e një intriga... Dhe lavdi Zotit tani të kam në dorë dhe nuk mund të ikësh më! Do të dorëzohesh për mua...

FATMA: *(Me vete)* Aman o Zot! Ç'janë këto që po më ndodhin njëra pas tjetrës? Deri kur kështu?

KARDINALI: Nëse nuk dorëzohesh me dëshirë, atëherë me dhunë...

FATMA: Ah exhel A exhel! Po përse nuk ma merr shpirtin?

KARDINALI: Unë të shpëtova nga duart e Rafaelit... Dhe nëse ti nuk do vetë, nuk do shkosh tek ai... Një herë e prano-ve fenë e krishterë, por pastaj hoqe dorë përsëri dhe u ktheve në fenë e mëparshme islame... Dënimin për këtë, e pate me djegie në zjarr... Por unë të fala... Dhe nëse nuk do, nuk je e detyruar që të jesh e krishterë! Por patjetër duhet të jesh imja!

FATMA: Nëse më bashkon me Ridvanin, do të të jem mirë-njohëse deri sa të jem gjallë... Të përulem dhe përkulem... Por, nëse doni të më ndani nga ai, atëherë nuk dua të më fal-ni asgjë dhe jam e gatshme për çdo dënim... Për çdo vuajtje. Më dënoni me dënimin më të madh të mundshëm... Më dig-ni në zjarr... Më bëni copë e grimë! Më mbytni! Më vrisni dhe më shpëtoni, sepse unë nuk mund të jetoj dot pa Ridvanin!

KARDINALI: Shikomë një herë! Sikur Ridvani të ishte gjallë... edhe pse ai ishte armiku më i madh i popullit dhe shtetit tonë, unë do të provoja që t'ju bashkoja... Por meqë ai ka vdekur...

FATMA: Jo! Ai nuk ka vdekur! Betohem se ai është gjallë.

KARDINALI: Unë të them se ai ka vdekur e ti nuk më beson? E meqë ai nuk është gjallë, çfarë do të bësh? Ku do të shkosh? Ku do të vendosesh? Ty ligji të ka dënuar... Të gjithë kërkojnë vdekjen tënde... Ti do të ishe që moti e vdekur, sikur mos të ishe nën fuqinë e mbrojtjes sime... Ti po të dilje tani jashtë nga dera e kësaj kishe, do të të bënin copë e grimë... Ti në këtë botë, përveç se në këtë kishë, nuk ke strehim tjetër! Unë isha dhe jam mbrojtësi yt më i madh! Unë

jam ai që të shpëtova nga të gjitha këto rrezeqe... Prandaj eja edhe ti dhe ma plotëso një herë dëshirën time... Mos më mundo... Mos më dëshpëro! (*Do ta përqafojë.*)

FATMA: (*Trembet dhe duke u tërhequr pas*) Ah, ju lutem më lini të qetë! Kjo kishë për mua nuk është vend strehimi, por ferr! Ti nuk më je mbrojtës, por roje ferri! S'është asgjë për mua dënimi me djegie në zjarr! Nëse më duhet t'i humbas shpresat nga Ridvani, vdekja për mua është shpëtim! Më mirë të më kishe mbytur se më torturon kaq shumë!

KARDINALI: Jo... Tani nuk të të mendoj më... Nuk ka më torturë pas pranimit të dëshirës sime...

FATMA: Ah, ti o mizor! I pashpirt! Po a ka torturë më të madhe se kjo kërkesa jote? Është vetë tortura! Përndryshe burgu... Bodrumi... Vetmia.. Mundimi... Prangat.. Më janë ngushëllime! Shpirti im ngushëllohet me to! Sepse vuajtjet që më vijnë si dënim për shkak të Ridvanit, nuk më janë vuajtje, por qetësim për shpirtin tim!

KARDINALI: Nuk do të të prek as në ndërgjegjen tënde... Mbaje fenë tënde myslimane... Mjafton që ti vetëm në pamje të dukesh si e krishtere dhe unë pavarësisht se je myslimane, do të të bëj ty kryemurgeshë... Unë dhe ti kemi për të jetuar në këtë kishë, më mirë se i shenjtë Papa! Ndërsa këtë kryemurgeshën, e përzë tani menjëherë dhe në vend të saj të caktoj ty, se gjoja je e krishterë... Dhe atëherë, ne të dy do të sundojmë në këtë kishë. E nëse ti do, mund të predikosh fenë tënde lirisht. Çfarë mund të bëj më shumë për ty? E nëse nuk je mirënjohëse as për këto...

FATMA: Si the, mirenjohëse? Nëse do që të jem mirënjohëse.. Atëherë të lutem, më mbyt sa më parë, që të shpëtoj... Ose më liro...

KARDINALI: Hajde moj, lëre këtë inat dhe këtë fanatizëm... Më prano, që t'i plotësoj të gjitha premtimet që t'i dhashë...

FATMA: Nuk ka gjasa fare! Më lër të qetë! Hiq dorë nga unë!

KARDINALI: Uh moj! Po sa më shume je kryeneçe, aq më e bukur më dukesh...

(dëshiron ta përqafojë Fatmën.)

FATMA: *(Pasi largohet)* Ah! Të lutem largohu! Ik, o derr!

KARDINALI: Haa, ashtu më thua ti, apo jo? Pa ndalu njëherë, se tani ke për ta parë! *(Thërret)* Eja! *(Hyn kryemurgesha)* Merreni këtë... Hiqjani krejt rrobat përveç këmishës së natës dhe futeni në bodrumin pa drita. Hidhini prangat në këmbë e duar dhe kujdes, derën mbylleni mirë! Mos të gabojë kush t'i japë bukë, apo ujë! Po ta bëjë dikush këtë, do të futet edhe ai vetë aty! *(Fatmës)* Hajde të shohim tani! Do pranosh apo jo? Hajde, zbatoni urdhrin menjëherë! *(Kryemurgesha e kap për dore Fatmën dhe e nxjerr jashtë.)*

Skena e gjashtë

KARDINALI: *(Me vete)* Nuk munda ta bind! Po si t'ia bëj ndryshe pra? I premtova se nuk do ta prekja në ndërgjegjen e saj, megjithatë nuk e pranoi! U pa se e do Ridvanin. I thashë se ai ka vdekur, por ajo përsëri nuk u bind. Po sikur t'i kur-

disja diçka, duke i thënë se Ridvani kinse ka hequr dorë nga ajo ... Ndoshta atëherë do të bindet... Por përse të ngutemi? Të presim edhe nja dy a tri ditë... Në atë bodrumin pa drita, pa ujë e pa bukë, ajo do ta harrojë Ridvanin... Dhe s'ka çfarë të bëjë tjetër... veçse të dorëzohet... (*Hyn kryemurgesha.*)

Skena e shtatë

Kardinali – Kryemurgesha

MURGESHA: Zotëri, në xhepin e saj gjetëm një libër... Përveç këmishës së natës, të gjitha rrobat e tjera ia hoqëm. Nuk kundërshtoi fare. Veçse një libër që e kishte në dorë, nuk mundëm t'ia merrnim.

KARDINALI: Po çfarë libri ishte ai?

MURGESHA: Ku ta di unë? Ishte një libër në gjuhën arabe. Mund të jetë Kurani... Vetëm kur të flerë ndoshta mund t'ia marrim. Përndryshe, nuk e jep.

KARDINALI: E përse t'ia marrim? S'ka nevojë, le ta mbajë.

MURGESHA: Aaa! Kurani të lexohet brenda në kishë!

KARDINALI: Ti je përgjegjëse për këtë! (*Kardinali del.*)

Skena e tetë

Kryemurgesha – (pastaj) Një murg

MURGESHA: (Me vete) Ëhë! Siç duket ky njeri s'e ka problem fare nderin e kishës... I shërben vetëm për të kënaqur

veten! Do që të më largojë mua dhe të bëjë kryemurgeshë një vajzë myslimane mëkatare, e cila është dënuar me vdekje! Ah, i poshtri, i pashpirti! Unë isha dashnorja e tij dhe i kam shërbyer që njëzet vjet e tëhu! Ma kishte dhënë besën dhe ishte përbetuar se përveç meje nuk do të donte dikë tjetër! Derisa isha e re më donte, ndërsa tani jo vetëm që më harron mua dhe do një tjetër, po e shkel besën dhe betimin e dhënë, do që të më largojë dhe atë ta bëjë kryemurgeshë! E si mund ta duroj unë këtë? Jo, jo! Duhet bërë diçka! Të veproj në dy drejtime! Më duhet patjetër t'i shkruaj Vatikanit, por njëkohësisht të punoj edhe për dënimin e saj me vdekje! Derisa ai tenton të më largojë mua, më mirë ta largoj unë atë! *(I afrohet tavolinës me kujdes që mos ta shohë askush dhe fillon të shkruajë me respekt. Pasi e mbaron shkrimin, e fut në një zarf dhe tek është duke shkruar mbi të, hyn një murg. Në fillim murgesha përpiqet ta fshehtë letërën, por pastaj duke iu afruar)* Haa, ti qenke apo jo? *(Nxjerr një qese dhe ia lë në dorë.)*

MURGU: *(I habitur)* Ç'është kjo, moj?

MURGESHA: Shpërblimi i një shërbimi që do të më bësh mua.

MURGU: Për shërbimin ndaj jush!

MURGESHA: Po, për një shërbim të fshehtë.

MURGU: Shërbim të fshehtë? *(Me vete)* Çfarë na qenka ky shërbim i fshehtë?

MURGESHA: Ç'thua për këtë?

MURGU: Si urdhëron. Jam në shërbimin tuaj.

MURGESHA: *(Duke ia dhënë letrën)* Merre këtë letër. Gjei një njeri dhe le ta dërgojë në Romë. Mos të ndalet ditë e natë dhe këtë letër t'ia çojë Vatikanit! Por të keni shumë kujdes, ai që e dërgon duhet të jetë njeri i besës...

MURGU: Mos u shqetësoni fare për këtë. *(Del.)*

MURGESHA: *(Duke vrapuar pas tij)* Të lutem, këtë të fshehtë mos ta dijë askush tjetër, se pastaj mbarojmë që të dy!

MURGU: *(Duke dalë)* Të jeni e sigurt për këtë.

MURGESHA: *(Me vete)* Fjalët që shkrova duhet të tërheqin vëmendjen e Vatikanit... Mbase këtë njeri të dyshimtë do ta largojnë nga këtu... Edhe dekreti për vdekjen e saj nuk do të vonojë... *(Kardinali hyn nga e djathta dhe një murg nga fundi.)*

Skena e nëntë

**Kardinali - Kryemurgesha - Një murg -
(pastaj) Nëpunësi nga Roma**

MURGU: Nga Vatikani ka ardhur një nëpunës... Nga Ati ynë, Papa i shenjtë, ka sjellë një dekret...

KARDINALI: Mos! O Zot!

MURGESHA: *(Me vete)* Oh, lavdi zotit! Mbase ka të bëjë me këtë punë.

KARDINALI: Le të hyjë brenda! (Me vete) Pale të shohim për çfarë ka ardhur? Le të jetë çfarë të dojë, vetëm mos ketë të bëjë me qëllimin tim... (Murgu hyn me nëpunësin nga Roma. Nëpunësi fillimisht, pasi i përkulet kardinalit, e heq nga qafa dekretin, i cili është vendosur në një këllëf të artë, dhe ia jep atij. Kardinali bie në gjunjë, e puth dekretin dhe e sjell rreth kokës. Pastaj e hap dhe fillon ta lexojë): “Përkundër asaj që jemi të lumtur për njoftimet që na vijnë se Spanja tanimë, gati e tëra, është pastruar nga myslimanët, falë veprimeve tona të shenjta dhe të zellshme, jemi mjaft të shqetësuar nga lajmi se disa myslimanë martohen me vajzat tona të krishtera. Prandaj me të marrë këtë dekret të shenjtë, duhet të jeni të kujdesshëm dhe syhapur që gjëra të këtilla mos të ndodhin më. Gjaku i tyre nuk bën të përzihet me gjakun tonë! Përndryshe, tani e tutje nëse ndodh kjo, përgjegjës do të jeni ju” (Pasi e lexon, e palon dekretin dhe e fut ne xhep.)

MURGESHA: (Me vete) Po thonë se në Spanjë nuk kanë mbetur më fare myslimanë! E nuk e di Vatikani se jo vetëm në Spanjë, por madje edhe këtu brenda në kishën tonë, ka myslimane?

KARDINALI: (I jep urdhër murgut) Lajmëroni që t’i bien kambanës së madhe... Do ta lexojmë dekretin... (Me vete) Tani mori fund edhe puna e Don Alfonsit! (Murgu del nga fundi i dhomës, ndërsa Kardinali me nëpunësin nga e djathta.)

MURGESHA: (Me vete) Dhëntë zoti së shpejti me një dekret tjetër na vjen edhe përgjigja e letrës që dërguam ne. (Del nga e djathta. Bie perdja)

PAMJA E GJASHTË

(Është e njëjta dhomë si në pamjen e tretë)

Skena e dhjetë

HASANI: *(Me vete)* Ne u lidhëm... Pas dy a tri ditësh do të martohemi. Sa fat i mirë! Çfarë lumturie! Por... Edhe sa keq! Për këtë lumturi flijova motrën time! Kështu kjo lumturi më doli si shumë e shtrejtë! Për ta arritur këtë, Fatmën e lashë në duart e atyre murgjve dhe murgeshave të pamëshirshme dhe të pashpirt! Në duart e atyre barbarëve dhe gjakatarëve! Ah, Fatma, moj shpirti im! Kush e di se ku je? Tani kur unë jam i gëzuar dhe i lumtur se do të martohem, nuk di për ty se në çfarë gjendje dëshpërimi, mundimi apo torture je! Unë, sepse e doja Fatmën aq shumë, desha që të ndahej nga Ridvani, që mos ta humbisja një herë e përgjithmonë! Por e bëra këtë që tani na ndodhi! Fatmën e ndava nga Ridvani, edhe e futa në burg! E mjera Fatma! Kush e di tani se çfarë është duke hequr në kishë nga ata kishtarë, të cilët nuk e dinë fare se ç'është sjellja njerëzore! Unë e mashtrova të gjorën! Duke u mbërthyer pas atij derr kardinalit, e lashë motrën time në duart e xhelatëve! Vallë, a thua ka njeri më zullumqar, më barbar dhe më të pashpirt se unë? Ndonjëherë më thotë mendja që ta sulmoj kishën... T'i mbys të gjithë ata që më dalin përpara! Ta marr motrën dhe të ikim! Të iknim diku së bashku me motrën dhe mos t'i shihja më kurrë këta njerëz! Mos të shkelja më kurrën e kurrës në këtë tokë! Por... Sa keq! Ja që vetëm një shikim apo një buzëqeshje e Lionorës më bën t'i harroj të gjitha! Dashuria për Lionorën më bëri që t'i harroj të gjitha detyrimet e shenjtë! Ah,

Lionorë ah! A më bëre magji, apo diçka tjetër, nuk e di! (*Bie kambana.*) Ç'është kjo kambanë? Ja pra, mbase edhe ndonjë gjë tjetër që ta prek ndërgjegjen! Deri dje nga minarja e kësaj xhamie të madhe, muezini e thirrte ezanin, ndërsa sot bien kambanat! (*Lionora hyn nga dera.*)

Skena e njëmbëdhjetë

Hasani – Lionora

LIONORA: Don Alfons, ç'je duke menduar?

HASANI: Eja Lionorë, eja dhe më shpëto nga këto ankthe! Më shpëto nga këto vrasje të ndërgjegjes sime! Se vetëm kur je ti afër meje, jam i lumtur, jam i gëzuar! Pa ty më pushtojnë hallet, mërzitë dhe shqetësimet! Aq shumë jam dëshpëruar sa që jam në gjendje të vras veten!

LIONORA: Ç'je duke thënë, o Alfons? Po ne ia arritëm qëllimit tonë. Çfarë të shqetëson, apo të dëshpëron tani? Nëse edhe sot vajtojmë, atëherë kur do të qeshim? Për ne ditë më të bekuar se kjo që është sot, as ka patur e as që do të ketë më kurrë! Këto ditë do të jenë ditët më të lumtura të jetës sonë! Sepse ne do të bashkohemi!

HASANI: Po, pasi flijova motrën time.

LIONORA: E mjera ajo! Alfons, të lutem mos ma kujto, se më kap dëshpërimi! Të gjorën, ashtu si ne, edhe atë e ndjekin të njëjtat derte! Po sikur mos të ishte rasti i saj, sa të kënaqur do të ishim edhe ne! Si duket bafti e paska shkelur fatin e njerëzve! Pas çdo gëzimi, paska lënë një dëshpërim!

HASANI: (*Me vete*) Mos moj! Edhe kjo kambanë nuk ka të ndalur? (*me britmë*) Oj Lionorë? Po përse bie kjo kambanë?

LIONORA: Aha! Harrova të të them se duhet të shkojmë në kishë.

HASANI: Në kishë! E përse?

LIONORA: Nga Papa i shenjtë ka ardhur një dekret dhe do të lexohet aty.

HASANI: Dekret! Nga Papa!

LIONORA: E përse habitesh kaq shumë, Alfons?

HASANI: Sepse fjala dekret nuk do të thotë asgjë tjetër, përveç vrasjes apo zhdukjes së mijëra myslimanëve!

LIONORA: Ah, çfarë të them! Fatkeqësisht këtë shekull, vrasja është bërë po aq e lehtë sa edhe një tungjatjeta! Por... Alfons, çfarë pune, ç'lidhje ke ti me myslimanët?

HASANI: Çfarë pune? Ah!

LIONORA: Të lutem Alfons! Mos po na sjell përsëri ndonjë ngatërresë!

HASANI: Ah, moj Lionorë! Po si nuk kam lidhje? Dhe jo vetëm unë, por edhe ti ke lidhje! Vallë, a nuk janë njerëz edhe ata? A nuk jemi ne të gjithë robt e një Zoti, banorët e një bote? Madje ata kur e pushtuan këtë vend, kështu u so-

llën apo jo? Çfarë të keqe ka parë Spanja nga ata? Sikur edhe ata të vepronin kështu, si këta të krishterët, kush e di se çfarë do të bëhej... Kur ata i pushtuan këto vende, a e prekën ndërgjegjen e dikujt? A e mbytën, a e vranë dikë? Gjynah! Ç'është ky zullum!

LIONORA: Të lutem, Alfons! Ç'u bë me ty kështu? Kurrë nuk ke folur kështu... Ashtu është dhe ke të drejtë. Ajo që bënë, pa mëdyshje, që është zullum dhe pandërgjegjshmëri. Por, neve ç'na hyjnë në punë këto tani? Ne nuk jemi njerëz të politikës. Çfarë mund të bëjmë ne? Ne jemi dy të dashuruar... Ne duhet të mendojmë për veten tonë...

HASANI: Mirë, nëse thua kështu, atëherë përse duhet shkuar në kishë për të dëgjuar dekretin?

LIONORA: Sepse... Babai me vëllanë shkuan dhe më thanë që të shkojmë të gjithë së bashku... Mos të bëhet pastaj ndonjë keqinterpretim... Ja, kambana u ndal dhe filloi leximi i dekretit.

HASANI: E rregulloj unë atë... Eja ulu dhe të rrimë pak unë e ti në qetësi... Po, sa qejf e kam takimin me ty pa ndonjë telash! Të kujtohet atëherë, kur ne ishim të pashpresë, por takimet na ishin shumë të këndshme... Ndërsa tani këto fatkeqësi që i dëgjojmë çdo ditë, na i shkatërrojnë nervat. Në çdo takim, nuk ka më gëzim dhe kënaqësi, por vetëm lotë dhe brengë! Pa eja njëherë, madje sikur edhe një minutë qoftë, le t'i harrojmë të gjitha këto dhe le t'i kthehemi dashurisë sonë! Këto zemra të thyera le t'i gëzojmë për një çast! Ah, moj Lionorë! Kur më shikon me ata sy të bukur dhe kur më flet

me ato buzë të holla, pothuajse e tërë bota bëhet imja! Hajde më fol diçka, më thuaj diçka, moj Lionorë! Të dëgjoj atë zërin tënd të bukur! (*Ia puth dorën.*)

LIONORA: Alfons! Dua te të pyes për diçka. A më do, sa të dua unë ty? Nuk e besoj! Dhe të them menjëherë se juve meshkujve gjuha nuk u është lidhur për zemër... Ndërsa tek ne femrat është e kundërta, e sidomos me mua, sepse gjuha ime kurrë nuk mund të thotë diçka që nuk buron nga zemra, nga shpirti! Sesa shumë të dua, këtë e di vetëm shpirti im, zemra ime! Gjuha ime nuk mund ta thotë kurrë!

HASANI: O Zot! O çfarë lumturie! O sa i gëzuar jam që më do Lionora! Ah, moj Lionorë! Ti me të vërtetë më do mua?

LIONORA: Shumë më tepër sesa më do ti mua.

HASANI: Jo, jo, nuk ka mundësi! Jo, kurrë Lionorë! Mjafton të më duash vetëm gjysmën e asaj që të dua unë ty... Më shumë nuk do të kisha dashur. E them me bindje të plotë! Por nuk besoj që më do aq!

LIONORA: Po ç'je duke thënë, o Alfons? Nuk qëndron fare bindja jote! Unë të dua! Të dua shumë! Shumë më tepër se ajo që mendon ti! Alfons (*E kap për dore.*)

HASANI: Ah, Lionorë ah! (*Ia puth dorën dhe e përqafton.*)

LIONORA: (*pasi qëndrojnë një kohë ashtu të përqaftuar*) Hë! Erdhën! Dëgjohen zhurmët e këmbëve! (*Ngrihen në këmbë. Hyjnë Don Pedroja.*)

Skena e dymbëdhjetë

Hasani – Lionora – Don Pedro – (pastaj) Kardinali

DON PEDRO: Përse nuk erdhët në kishë? U lexua dekreti i ardhur nga Vatikani... I cili në thelb kishte të bënte me ju.

LIONORA: Mos!

HASANI: Ëhë! Mbase na doli edhe një pengesë! Si duket, fati i zi akoma është duke na ndjekur!

DON PEDRO: Mosardhja juaj e shtyu Kardinalin e shenjtë që të vinte tek ju! Ja, është duke ardhur!

HASANI: *(Me vete)* Ah! Iu theftë këmba atij e mos ardhët! I mallkuar qoftë! Ashtu si futi motrën time në kurth, do të më fusë edhe mua!

LIONORA: Të lutem, o babai im! Ç'kemi? Ç'u bë?

DON PEDRO: Tani do ta kuptoni... *(Kardinali hyn nga dera. Të pranishmit heqin kapelet dhe i përkulen Kardinalit.)*

KARDINALI: Don Alfons dhe Dona Lionora! Ju nuk erdhët ta dëgjoni dekretin nderdhënës që na ka ardhur nga Vatikani i shenjtë...Ti Don Alfons! Katolicizmi nuk mbahet kështu! Ai që është bërë katolik, është i detyruar jo vetëm të dëgjojë dekretin e ardhur nga Vatikani, por duhet të dojë dhe të nderojë madje edhe çdo qen apo mace të Romës, çdo grimcë dheu të saj!

HASANI: Shkëlqesia juaj, lajmi na erdhi me vonesë.

KARDINALI: Mos provo të më bindësh! Unë jam në gjendje t'i kuptoj edhe gjërat e fshehta! Çdo gjë e marr vesh unë!

HASANI: *(Me vete)* Zoti ta theftë qafën ty! Zaten ti s' merr vesh gjë tjetër përveç djallëzive!

KARDINALI: Por, sido që te jetë... Meqë në fenë katolike je akoma rishtar, këtë herë po ua fal! Por meqë pëmbajtja e këtij dekreti të shenjtë ka të bëjë me ju, unë erdha vetë personalisht që t'jua kumtoj... *(Nxjerr dekretin.)*

HASANI: *(Me vete)* Paska të bëka me ne! Me se ka lidhje vallë?

LIONORA: *(Me vete)* Të lutem, o Zot! Për hir të zotit, mos pastë të bëjë me ndonjë telash lidhur me martesën tonë!

KARDINALI: *(Duke e mbajtur dekretin para syve të Hasanit)* Ja pra! Lexoje!
(Hasani e lexon me habi dhe shqetësim.)

HASANI: *(Pasi e lexon një pjesë, me trishtim)* Ah, të shkretën! Të lutem, o Zot! A thua e pashë mirë? A thua e lexova gabim?

KARDINALI: S'ka gabim, ç'gabim!

HASANI: Ah, ah, i gjori unë! Lionorë! Moj Lionorë! Si duket puna jonë mbaroi! *(Qan.)*

LIONORA: *(Me habi)* Të lutem, o Zot! Alfons!

KARDINALI: Nuk ka nevojë ta dëgjosh nga Alfonsi! Eja dhe lexoje vetë! (*Ia jep dekretin. Lionora fillon ta lexojë duke u dridhur.*)

LIONORA: Ah, Alfons, ah! (*I bie të fikët dhe rrëzohet.*)

HASANI: Lionorë! Oj Lionorë! (*Vrapon pas saj.*) Ah! Lionora ime! Ç'po ndodh me mua! Lionorë! (*Lionora kthjellohet.*)

LIONORA: Hasan!

DON PEDRO: Vajzë! Eja në vete! Je çmendur?

LIONORA: Po! Hasan! Hasan quhet ai! Pasi ju nuk ma jepnit pa e ndërruar emrin, për t'u martuar me mua, ai e pranoi emrin Alfons! Por ai nuk e do këtë emër! Prandaj unë do ta thërras Hasan e jo Alfons!

HASANI: Lionorë!

KARDINALI: Uh, more! Këto fjalë në praninë time janë fyerje për mua, për Inkuzicionin dhe Vatikanin!

LIONORA: (*Me vete*) Qofshi të mallkuar të gjithë ju! Toka ju mbuloftë! Poshtë Inkuizicioni! Poshtë jezuitët!

KARDINALI: Vajzë! Eja ne vete! Ky djalë ashtu si e pranoi ndërrimin e emrit në Alfons për t'u martuar me ty, po ashtu edhe tani mund të quhet Hasan nëse e pranon dënimin me varje! Alfons, ç'thoni ju për këtë!

HASANI: Unë nuk them asgjë! Edhe po desha të them, nuk kam fuqi! Dua të vdes! Dua vetëm të vdes!

LIONORA: Hasan! Ti me këtë dëshmon se më do më shumë sesa të dua unë! Unë tani nuk dua të jetoj më! Nëse edhe ti e pranon, le të vdesim që të dy së bashku! Dhëntë zoti në botën tjetër shihemi! Ndërsa hakun tonë na e merr i madhi Zot!

HASANI: *(Me vete)* Tmerr! Meqë unë edhe botën tjetër e flijova për ty, për mua nuk ka më shpresë as në këtë botë e as në botën tjetër! Sa keq! Por jo! Me tradhti nuk ka lumturi! Fundi i dinakërisë është i frikshëm! Këtë dënim e kam merituar! Në këtë vorbull hyra me dëshirë! Duhet t'i kthehemi drejtësisë! Atdhetarisë. Gabimet duhen ndrequr! Nëse duam që mos të mbetemi të mjerë në këtë dhe në botën tjetër! Të vdesim me nder dhe faqebardhë! *(Pasi i afrohet mengadalë Lionorës)* Lionorë! Mos u dëshpëro! Besën ta jap se do shpëtojmë!

LIONORA: *(Ngadalë dhe me shqetësim)* Ah! Vërtet? A është e mundur kjo?

HASANI: Durim!

KARDINALI: Don Alfons! Ti je besnik... Prandaj të dua! Eja të të jap ndonjë vajzë tjetër, e cila po ashtu është konvertuar nga feja islame dhe të të martoj... Të jap besën se do të të gjej një vajzë tjetër, madje edhe më të bukur se Lionora. Dhe betohem se po të martohesh me të, do ta duash dhe do ta harrosh Lionorën.

HASANI: *(Me vete)* Ah, ti derr i urryer!

LIONORA: Mos, çfarë po thotë!

KARDINALI: Mirë, ç' thua ti?

HASANI: Si urdhëroni, Zotëri! Pajtohem!

LIONORA: Uh, more! Hasan!

HASANI: Durim!

KARDINALI: Të lumtë! Eja të puth në ballë. (*Hasani i afrohet dhe Kardinali e puth në ballë.*) Të thashë se do të të gjej një grua tjetër. Po ashtu edhe Don Pedroja le t'i gjejë një burrë tjetër vajzës së vet... Eja me mua, eja!

HASANI: Me lejen tuaj, nëse më lejoni t'i them nja dy fjalë Lionorës... I kam lënë një amanet prandaj... Vetëm dy minuta!

KARDINALI: E po mirë! Don Pedro, ti eja dhe të dalim. (*Don Pedroja del me Kardinalin.*)

Skena e trembëdhjetë

Lionora – Hasani

LIONORA: (*Me dëshpërim*) Hasan! Këtë pabesi kurrë s'e kisha menduar prej teje!

HASANI: Pabesi! Prej meje! Unë i pabesë ndaj teje!

LIONORA: Do të marrësh një tjetër!

HASANI: Unë!

LIONORA: A nuk i the kardinalit?

HASANI: Uha, mendon se e pata me gjithë mend unë? I thashë për të të shpëtuar ty... Lionorë, unë të dua ty! Mos e dhëntë Zoti që ta marrë një tjetër!

LIONORA: Oh! Shyqyr o Hasan!

HASANI: Edhe mua kështu më pëlqen! Hasan më quaj, Hasan! Meqë unë jam ai Hasan i vjetër. Nuk dua ta dëgjoj më emrin Alfons! Nuk e dua as titullin e Donit! Ja edhe këtë shenjë krenarie! *(E këput nga gjoksi dhe e flak përtokë, duke e shkelur edhe me këmbë pastaj.)* Ja edhe këtë dekret me të cilin m'u dha titulli i Donit *(E nxjerr dekretin nga xhepi dhe e bën copë e grimë.)* Don Alfons nuk kam për ta dëgjuar më! Hasani jam unë, Hasani! Emri Hasan a nuk është më i mirë se emri Alfons?

LIONORA: Shumë herë më i mirë madje!

HASANI: Unë jam Hasani! Oh! Ai Hasan, i dashuri yt!

LIONORA: Burri im Hasani!

HASANI: Ah! Domethënë më pranon a! Më pranon me emrin Hasan, apo jo?

LIONORA: Uh more! Ne jemi në ëndërr! Nuk ka më shpresë për ne, sepse na ndau Inkuizicioni!

HASANI: Por na bashkon Islami! Të gjorët, i bën të lumtur Islami!

LIONORA: Ah!

HASANI: Po deshe, të rrëmbej dhe ikim!

LIONORA: Po desha! Edhe më pyet, apo jo? Po si nuk dua?

HASANI: Të rrëmbej dhe ikim në një shtet mysliman! Atje jetojmë bashkë!

LIONORA: Vallë, a është e mundur? Atëherë, të qofsha falë! Të ikim sa më parë! Nëse duhet të ndahem nga dikush, atëherë më mirë të ndahem nga vëllai dhe babai, sesa nga ti! Meqë është me rrezik të jetohet në një vend që udhëhiqet nga Inkuizicioni... Në një vend ku sundojnë jezuitët!

HASANI: Oh, të lumtë moj Lionorë, të lumtë goja! Ah, jo! Jo Lionorë... Nuk dua të quaj Lionorë... Eëë... Jo Lionorë! Por Mazlume! Mazlume do të të quaj ty... Si thua?

LIONORA: Mazlume! Oh! Sa emër i qëlluar!

HASANI: Mazlume, është emër i bukur, apo jo?

LIONORA: O Hasan, çdo fjalë që del nga goja jote, është e bukur?

HASANI: Mazlume, ti mos u bëj merak! Mos ki gajle! Unë do të të rrëmbej dhe do të të shpëtoj! Po pres momentin e

duhur! Do gjej kohën e duhur! Do vij në mbrëmje dhe do të të marr! Ikim në një vend mysliman... Viktimat e Inkuizicionit mund t'i shpëtojë vetëm Islami!

LIONORA: Hasan! A ka edhe në Islam ndonjë organizatë të tillë si Inkuizicioni tek Katolikët që jep urdhra?

HASANI: Jo! E kundërshtoj këtë! Islami nuk pranon gjëra të tilla! Urdhërues i myslimanëve është Sheriati dhe ata që e predikojnë atë pa kushte!

LIONORA: Ashtu si në katolicizëm që ka priftërinj jezuit, a thua si këta ka edhe në Islam?

HASANI: Ah, çfarë krahasimi! Jo, në Islam nuk ka gjëra të tilla! "*ta ruhbaniyete fi'llIslam*" Ndërgjegjen e myslimanëve e udhëheq Zoti i madh.

LIONORA: Nëse është kështu, atëherë lumturinë tonë ne mund ta gjejmë vetëm në Islam.

HASANI: Posi, posi!

(bie perdja)

AKTI I PESTË

PAMJA E SHTATË

(Është po ajo skenë si në Pamjen e pestë, ku shihet dhoma e kishës)

Skena e parë

Kardinali – Don Pedro

DON PEDRO: *(Me të hyrë me shqetësim nga dera)* E more vesh?

KARDINALI: Ç'ke? Ç'ka ndodhur?

DON PEDRO: Ah! Ja ç'do të thotë t'i besosh armikut... Po sa gabim i madh është t'i besosh armikut!

KARDINALI: Hajt, më thuaj... Ç'u bë?

DON PEDRO: Ç'gjë ka për t'u bërë? Alfonsi... Ai i poshtri i botës, i harroi të gjitha të mirat e privilegjet që i mundësoi mbreti dhe është bërë përsëri mysliman. Madje edhe vajzën time e ka bërë myslimane. Dekretin e ka bërë copë-copë, ndërsa kurorën e ka hedhur përtokë! *(i nxjerr copëzat e letrës nga xhepi dhe duke ia hedhur)* Merri... Ja copëzat e dekretit! I gjetëm brenda në dhomë!

KARDINALI: Pa shihe njëherë të poshtrin! Mirë, po përse nuk ma sollët? Do ta kishim burgosur.

DON PEDRO: Po ku ta gjej? Ka ikur!

KARDINALI: Nëse ka ikur, le shkojë në fund të ferrit!

DON PEDRO: Ah, po çfarëpo thoni kështu? Ai ka rrëmbyer edhe vajzën time! Ka marrë edhe vajzën time!

KARDINALI: Mos!

DON PEDRO: Mbrëmë e ka rrëmbyer...

KARDINALI: Po mirë, atëherë çfarëpo prisni ju? Duhet ndjekur! Duhet dërguar njerëz pas tyre!

DON PEDRO: I dërgova... Në mëngjes Rafaeli shkoi me ca kalorës.

KARDINALI: Zotrote, ju u mashtruat! Sikur ta merrte vesh Inkuizicioni... Se ju i keni dhënë titullin e Donit një myslimani... E keni bërë dhëndër pa dijeninë e tij, do të hidhërohej tej mase! A nuk e patë dekretin e Inkuizicionit? Myslimanët që i përshtaten kohës janë të lirë. Ama edhe dhënia e titullit të Donit çdokujt, nuk pëlqet! Prandaj ja, ky është fryt i gabimeve tuaja!

DON PEDRO: *(Me vete)* Jo imi! Por fryt i dekretit!

Skena e dytë

Kardinali – Don Pedro – Një djalë

DJALI: *(Duke hyrë nga dera)* Ju lutem... Me leje... Don Rafaeli erdhi! E kanë zënë!

DON PEDRO: E kanë zënë! Oh, shyqyr! (Nxiton të shkojë.)

KARDINALI: Ku do të shkosh?

DON PEDRO: Të shkoj ta shoh...

KARDINALI: Jo! Nuk ka nevojë të shkosh! Le ta sjellin këtu!

DON PEDRO: Në rregull... (*djalit*) I thuaj Rafaelit, le ta sjellë këtu.

DJALI: Si urdhëroni... (*Del.*)

Skena e tretë

Kardinali – Don Pedro

DON PEDRO: Ju lutem, Shkëlqesia juaj! Më ndihmoni! Ma morën në qafë vajzën! Ah, bija ime, ah! Po sikur ta mbulonim disi fajin e saj! Sikur mos të zbulohej ajo, ndërsa atë të poshtrin ta vrasim! Atëherë vajza ime do të shpëtonte... Do t'i mbushej mendja dhe do të hiqte dorë nga ai...

KARDINALI: Faji i saj është tepër i madh! Është bërë myslimane!

DON PEDRO: Ju lutem, Shkëlqesi! I themi që ta mohojë! Ju qofsha falë! Kërko çfarë të duash nga unë... Ju ofroj gjithë pasurinë time... Merr sa të duash e më lër çfarë të duash, vetëm vajzën ma shpëto! Ju lutem të keni mëshirë! (*I bie para këmbëve.*)

KARDINALI: Haj pra, të shohim nëse mund tërregullojmë diçka.

DON PEDRO: Ja erdhën! (*Rafaeli me shpatë në dorë hyn brenda duke iu përkulur së pari Kardinalit. Pas tij hyjnë disa ushtarë, duke e futur brenda Hasanin me Lionorën.*)

Skena e katërt

*Kardinali - Don Pedro - Rafaeli - Hasani -
Lionora - Disa ushtarë*

KARDINALI: (*Rafaelit*) Të lumtë, biri im! Bëhu krenar!

DON PEDRO: (*Lionorës*) Ç'bëre kështu, o vajza ime! Më shkatërrove! Më turpërove! (*Hasanit*) Po ti, o tradhtar! Kështu na i shpërblen të mirat që të bëmë?

KARDINALI: Don Pedro! Hesht! (*Hasanit*) Ti je katolik? Apo nuk je? (*Hasani hesht.*) Hajde më thuaj! Më thuaj!

HASANI: Lartmadhëri... Të gjithë e dinë se unë e dua Lionorën! Meqë nuk e duroja të ndahesha nga Lionora... Vetëm e vetëm që të martohesha me të, e pranova fenë katolike...

KARDINALI: Po ne të thamë që të hiqje dorë nga Lionora. Ti a e pe dekretin e Vatikanit? Kush është ai që mund të veprojë në kundërshtim me vendimin e shenjtë të Vatikanit?

HASANI: Lartmadhëri! Nuk mund të heq dorë nga Lionora! Më mirë vdes sesa të jetoj pa të! Madje vdes pa fajn tim! Vdes me nder!

KARDINALI: Ç' do të thuash me këtë?

HASANI: Katolik nuk jam dhe kaq! Meqë edhe ashtu u dashka të ndahem nga Lionora, nuk dua as të jetoj! Më dënoni ashtu si mendoni dhe të vdes!

LIONORA: Mos!

KARDINALI: Ti, edhe sikur të duash të jetosh, meqë e ke mohuar katolicizmin, gjithsesi do të vdesësh! (*Ushtarëve*) Kapeni këtë dhe futeni në burg! Në birucë!

LIONORA: (*Pasi bie para këmbëve të Kardinalit*) Ju qofsha falë! T'i puthsha këmbët, ki mëshirë!

KARDINALI: Mbylle gojën! Ti më mirë mendo për fajin tënd, sesa të kërkosh ndihmë për dikë tjetër! (*E ngre Lionorën duke i dhënë një shtytje.*)

LIONORA: Uh more! Ju lutem! O Zot! (*Bie para këmbëve të babait*) Të qofsha falë, o baba! Shpëtoje! Shpëtoje Alfonsin!

DON PEDRO: (*Me hidhërim*) Ik, largohu nga unë! Nuk dua të të shoh! Si guxon akoma të më quash baba?

LIONORA: Ah! O Zot! E morën! E dërguan! Çfarë të bëj unë e mjera! Kujt t'i lutem! (*Kardinalit*) Atë e dënuat... Përse nuk më dënoni edhe mua? Nëse Hasani do të vdesë, as unë nuk dua të jetoj! Edhe unë jam myslimane! Edhe unë dua të vdes! Nuk jam katolike! Kam frikë nga katolicizmi! Rrëqethem nga ai! Dua të vdes bashkë me Hasanin!

KARDINALI: Madje ke guxim që edhe para meje ta quash Hasan, apo jo?

LIONORA: *(Me zemërim)* Po! Ai quhet Hasan, ndërsa unë Mazlume! Na dënoni si të doni dhe si të mendoni! Mjafton që ne të vdesim bashkë!

KARDINALI: *(Me hidhërim)* Mirë! Dëshira juaj u pranua! Do të vdisni që të dy! *(Ushtarëve)* Kapeni edhe këtë dhe futeni në birucë! *(Dy ushtarë e kapin Lionorën dhe e dërgojnë.)*

RAFAELI: Ah!

DON PEDRO: Ju qofsha falë, lartmadhëri! Po premtimi?

KARDINALI: Sikur mos ta pranonte vetë, atëherë do bënim diçka..... Por, a nuk e shihni ju se ajo para nesh pohon se është bërë myslimane?

DON PEDRO: Ju lutem! Është vajza ime!

KARDINALI: Le të jetë e kujtdoqoftë! Unë nuk pranoj për askënd që të dalë kundër Inkuizicionit dhe Vatikanit! Në vend që të thyej rregullat e Inkuizicionit, është më mirë që ajo të marrë dënimin e merituar dhe ju të vuani! Unë do ta kryej punën time dhe kaq! *(Del me hidhërim.)*

DON PEDRO: *(Me vete)* Ah, bija ime! *(Del duke qarë dhe pas tij del edhe Rafaeli. Perdja mbyllet.)*

PAMJA E TETË

(Shihet një pyll dhe ca maja malesh.)

Skena e pestë

Ridvani - Sa'd Osmani - Xhaferi - Abdullai - Ibrahim

RIDVANI: (*Me vete*) Kurrë s'më kishte shkuar mendja që Fatma të ma bënte këtë! Ajo të më harrojë mua? Të pranojë të martohet me dikë tjetër! Të vishet me rroba spanjolle dhe krah për krah me një spanjoll, të shkojë në kishë! Jo, jo! Nuk mund ta besoj se Fatma do të bënte gjëra të tilla! Nuk e kam të qartë. Por, ja që unë e pashë me sytë e mi! Prandaj puna ime mori fund! Do të vras veten, por po pres derisa të vijë Amrui. Sepse ai nuk më lejoi të mbysja veten... Më tha: "**Jo, mos, se Fatma është jotja. Fatma të dashuron vetëm ty, ndërsa kjo e tëra është vetëm shpifje.**" Këtu mbase po ndodh diçka! Edhe për një çast, mos ta vras veten. Më duhet ta marr vesh këtë punë... Por prej kujt! Amrui akoma nuk po vjen! Që nga ai moment, nuk u pa më kurrë! A thua vallë edhe atij i ka ndodhur gjë? (*Shokëve*) Shokë, Amrui akoma nuk na erdhi! Kam frikë mos i ka ndodhur diçka!

SA'DI: Ke frikë!

OSMANI: Po, nëse e kanë njohur...

XHAFERI: Tani nuk është koha për muhabet. Duhet të shkojmë dhe ta kërkojmë! Është faj i madh ta lësh shokun vetëm! Të shkojmë, ta kërkojmë... Dhe ta gjejmë... Qoftë

edhe në burg, nëse është! Ose ta nxjerrim nga burgu, ose të vdesim edhe ne pranë tij! Nëse e kanë vrarë, t'ia gjejmë eshtrat dhe t'i marrim ato! Mos ta lëmë në duart e armikut! Amrui është djalë trim dhe patriot!

RIDVANI: Amrunë e kam si vëllanë tim! Amrui e vuri veten në rrezik për mua! Më shpëtoi nga një gabim i madh! Por megjithatë, jeta ime varet nga lajmi që do të sjellë ai.

ABDULLAI: Atëherë mos të humbasim aspak kohë...Të gjithë ne të shpërndahemi dhe ta kërkojmë në çdo anë, në çdo skutë! Hajde, menjëherë!

IBRAHIMI: Prit, o vëlla, mos nxito! Ja, Amrui është duke ardhur!

RIDVANI: Po ku është ore?

IBRAHIMI: A nuk e sheh në atë majë mali? A e sheh një dru në krahun e djathtë? Tek ai dru është duke ecur një njeri... Duke ardhur këndeje... Ja pra, e shihni, ai është Amrui!

XHAFERI: Mos të të vijë keq, o Ibrahim! Ama, frikacak që je!

IBRAHIMI: Unë?

XHAFERI: Po. Ti! E kuptove që do të shkojmë për të gjetur Amrunë... Për të mos shkuar, na thua se Amrui është duke ardhur. Po a shihet njeriu nga kjo largësi ore?

IBRAHIMI: Unë ju garantoj se ai njeri që është duke ardhur, është Amrui!

RIDVANI: Po si e dallon ti?

IBRAHIMI: Nga të ecurit.

ABDULLAI: Vërtet, të ecurit i ngjason... Por nuk jam i sigurt...

IBRAHIMI: Po ju përse nxitoni? Sa vjen e po na afrohet. Tani do ta shohim.

RIDVANI: Dhëntë Zoti e është Amrui!

OSMANI: Ibrahim ka të drejtë! Ai është Amrui!

RIDVANI: Ah! Je i bindur se është ai?

OSMANI: Posi, posi! Ai vetë është!

TË GJITHË: Ai është!

IBRAHIMI: Po nëse doni, mos besoni.

RIDVANI: Ai është! Oh shyqyr! Dhëntë Zoti e na sjell ndonjë sihariq! Ah, po kur po arrin? Nuk mund të pres më!

SA'DI: Uh bre! Na humbi, nuk shihet më!

RIDVANI: Ah! Po ku na iku, ore? Atëherë nuk qenka ai!

IBRAHIMI: Po po. Është duke ardhur... Por rruga është e tillë...Tani nuk e dallon, por pak më vonë do të jetë këtu.

RIDVANI: Këtu! Oh, Zot! (*Me vete*) Çfarë lajmi do më sjellë nga Fatma? E gjora ajo! Po nëse është martuar... Me Rafaelin... Ah, o Zot! (*Pasi nxjerr hanxharin*) Hanxhari le t'më rrijë gati në dorë. Me fjalën e parë të Amruit, osedo ta ngul në gjoksin tim, ose do ta gjuaj përtokë! (*Amru hyn nga e djathta.*)

Skena e gjashtë
Ata të mëparshmit – Amrui

IBRAHIMI: Ja pra, a u bindët që është Amrui!

RIDVANI: Amru! (*dhe e përqafton*) Ç'u bë me Fatmën? Shpejt më thuaj të lutem! Nëse është lajm i mirë, ta flak këtë hanxhar dhe të gjunjëzohem para teje... Po nëse është i keq, ta ngul në gjoksin tim...

AMRUI: Vëllaçko! Lajmi nuk është as i mirë, as i keq! As nuk të kënaq, as nuk të zemëron!

RIDVANI: Nuk të kuptoj. Ç'do të thuash? Apo mos vallë Fatma u martua?

AMRUI: Jo.

RIDVANI: (*Me gëzim*) Jo, nuk u martua! A më do mua?

AMRUI: Po, sikur vetëm ta shihje se në çfarë rreziqesh hyri ajo vetëm sepse të do ty...

RIDVANI: Më the që më do, apo jo?

AMRUI: Po ashtu është. Të do vetëm ty dhe askënd tjetër!
Jeton vetëm për ty!

RIDVANI: *(Pasi e hedh hanxharin në tokë, bie para këmbëve të Amruit)* Oh, shyqyr o Zot! Vëllaçko! Ti më shpëtove jetën!
Faleminderit shumë! Shumë faleminderit!

IBRAHIMI: *(Amruit)* Vëllaçko! Po çfarë ndodhi që u vonuat
kaq shumë?

AMRUI: Më mirë mos më pyet, o vëlla!

RIDVANI: E përse?

AMRUI: Sepse mua më njohën! Më burgosën dhe m'i vunë
prangat! Shkurt, nuk lanë gjë pa bërë! Hoqa shumë! Por në
fund shpëtova duke u bërë një dredhi... Ç'të bësh! S'pata
rrugëzgjidhje tjetër! Për jo më shumë se dy a tri orë u bëra
katolik!

IBRAHIMI: Rëndësi ka që ke shpëtuar!

AMRUI: Deri këtu, po! Tani e tutje të shohim!

IBRAHIMI: Po përse tani e tutje?

AMRUI: Çfarë po presim ne këtu? Duhet shpëtuar Fatma!
Ta shpëtojmë Fatmën dhe të ikim nga ky vend!

RIDVANI: Të lutem! Po Fatma ku është? Si është?

AMRUI: Kur ti u largove, erdhi Kardinali dhe i pyeti çiftet se a pranonin apo nuk e pranonin atë martesë. Të tjerët thanë “**po, e pranojmë**”, por kur i erdhi radha Fatmës, ajo tha “**jo**”...

RIDVANI: Jo tha apo....? Oh, Zot i madh!

AMRUI: Prandaj nja dy murgesha e morën Fatmën nga krahët dhe e dërguan në kishë!

RIDVANI: Në kishë! Mos more! Ato kishat janë vende të zullumeve!

AMRUI: Në kishë, kardinali paskësh shprehur simpati ndaj vajzës...

RIDVANI: (*Me nervozizëm*) Kardinali! I paska shprehur simpati! Ah! O derr kardinal!

AMRUI: I ka ofruar dashurinë e tij, por Fatma nuk e ka pranuar. Prandaj e kanë futur në një bodrum. E kanë prangosur këmbë e duar! Për ta bindur që të pajtohet dhe të dorëzohet, kohë pas kohe e nxjerrin para kardinalit. Por meqë ajo nuk bindet, e kthejnë përsëri në bodrum!

RIDVANI: Ah, o Zot! Fatma, o Fatma! Ti qenke besnike e unë mendoja keq për ty! Ah! Po ti po më dashke, ti për mua ke rrezikuar dhe ke vuajtur kaq shumë, e unë tani mos të rrezikoj për shpëtimin tënd! Por Amru, më thuaj si ka ndodhur dhe përse e kanë dërguar në kishë? Me dhunë, apo jo?

AMRUI: Jo me dhunë! Por e ka mashtruar i vëllai... Se gjoja pastaj do ta shpëtonte... Do iknin...

RIDVANI: Ah, ai tradhtar! I pafe!

AMRUI: Por edhe atë e ka mashtruar kardinali. Sepse kardinalit i ka pëlqyer vajza. Prandaj, duke e ditur se ajo nuk do të të pajtohej të martohej me Rafaelin, e ka trilluar gjithë këtë.

RIDVANI: Ah! I mallkuar qoftë ai qafir!

ABDULLAI: Unë habitem me këta kardinalë... Në një anë sillen sikur të jenë engjëj, ndërsa në anën tjetër bëjnë punët më të këqija të mundshme. Nga njëra anë thonë se janë ata që mund t'i falin mëkatet e të tjerëve, ndërsa në anën tjetër janë pikërisht ata mëkatarët më të mëdhenj! Inshalla Zoti na shpëton nga e keqja e tyre!

RIDVANI: E mjera Fatma!

AMRUI: Po a e dini fatin e Hasanit?

RIDVANI: Të lutem mos ma përmend këtë të pafe tradhtar! Nuk dua të di asgjë për fatin e tij! Fundi i tij është zjarri i ferrit!

SA'DI: Po si ka ndodhur, si?

AMRUI: Nga Papati ka ardhur një dekret me të cilin ndalohet martesë e një katolikeje me një mysliman që është bërë katolik.

RIDVANI: Oh, sa mirë!

AMRUI: Prandaj pikërisht për këtë, Hasani e bëri copë-copë dekretin me të cilin i është dhënë titulli i Donit. Kurorëzimin e shkeli me këmbë... Dhe u kthye përsëri në fenë islame.

RIDVANI: *(Me kënaqësi)* Oh!

AMRUI: E bindi edhe Lionorën që të bëhet myslimane dhe ajo e pranoi. E pagëzoi me emrin Mazlume. Dhe pastaj ikën së bashku...

RIDVANI: Oh! Shyqyr!

AMRU: Por të tjerët i ndoqën dhe i kapën. I sollën në kishë dhe i prangosën!

RIDVANI: Domethënë nuk qenka vetëm Fatma që duhet ta shpëtojmë.

XHAFERI: Duhet shpëtuar shpirti i tre myslimanëve!

RIDVANI: Jo tre, por katër! Nëse nuk e shpëtojmë dot Fatmën, do të jem i vdekur edhe unë!

IBRAHIMI: Hej! Fshihuni! Janë duke ardhur tre murgj! I shihni, apo jo?

XHAFERI: Ata janë tre, por ne jemi shtatë! Atëherë kush duhet të fshihet, ne apo ata?

ABDULLAI: Ibrahim, vëllaçko! Ti vetëm vëzhgo... Dhe nëse sheh diçka larg, na bëj me dije. Sepse sytë i ke mashalla! Po edhe frikacak je! Prandaj të takon të merresh me këtë punë.

IBRAHIMI: Para shokëve dukem se jam frikacak... Por jo para armikut!

OSMANI: Jo, nuk është ashtu. Ta quash Ibrahimin frikacak, është fyerje dhe sikur të isha unë në vendin e tij, do të fyhesha!

IBRAHIMI: Ta ndiesh veten i fyerr nga shokët, nuk është burrëri!

SA'DI: Të lumtë, o Ibrahim!

ABDULLAI: Na rrofsh, o Ibrahim!

AMRU: Hë! Se mos harroj... Edhe kardinali është ndërruar dhe në vend të tij do vijë një tjetër.

RIDVANI: Oh! Bukur! Ndoshta është një rast i mirë për të liruar Fatmën.

AMRUI: Ah! Ibrahim, o vëlla! Fatma, Hasani dhe Mazllumja, që të tre janë të dënuar me djegje në zjarr...

RIDVANI: Mos more!

AMRUI: E di ti përse kardinali i mëparshëm nuk i dogji? Sepse po t'i digjte ata të tjerët, atëherë do të ishte i detyruar

të digjte edhe Fatmën! Por meqë atë e dashuronte dhe shpresonte ta bënte për vete, nuk i dogji.

RIDVANI: Ah! Fatma e ka në rrezik edhe jetën, edhe nderin e saj! Të lutem, o Zot! Ne nuk kemi forcë, prandaj na shpëto ti! Na ndihmo ti!

IBRAHIMI: Amru, si the, po vjen Kardinali i Ri, apo jo?

AMRUI: Po. Është caktuar një kardinal i ri dhe ai duhet të vijë gjatë këtyre ditëve.

IBRAHIMI: Ja, janë duke ardhur! Njëri nga këta murgj është kardinali. Dallohet edhe nga veshja... Vijnë duke ecur në këmbë.

XHAFERI: Duhet të kalojnë këtu, apo jo?

IBRAHIMI: Po, patjetër meqë nuk ka rrugë tjetër!

XHAFERI: Trupi i këtij kardinali, medoemos duhet hedhur në erë! Përndryshe, po hyri ky në Granadë, do t'i djegë në zjarr që të tre.

ABDULLAI: Ashtu është, duhet ekzekutuar patjetër!

RIDVANI: Pajtohem edhe unë! Për të shpëtuar tre myslimanë të pafajshëm, mendoj se nuk është turp që në emër të Zotit dhe për të mirën e njerëzimit, të vriten tre zullumqarë ngatërrestarë!

AMRUI: Duhet vepruar me kujdes! Ja, na u afruan! Ridvan, neve të dyve na ka hije. Të rrimë këtu dhe të sajojmë diçka për ta... T'u ulemi e përkulemi, t'ua puthim duar e këmbë dhe të diktojmë a është ai Kardinali i Ri dhe përse vjen? Ndërsa shokët le të fshihen... Dhe gjatë kohës që ata janë të hutuar duke folur me ne, këta le të gjuajnë dhe le t'i vrasin!

RIDVANI: (*Shokëve*) Si thoni ju, e pranoni?

TË GJITHË: Posi! Posi! Bukur! Taktikë shumë e goditur!

XHAFERI: Atëherë, hajt të fshihemi! Armët i mbani në gatishmëri! (Fshihen pas pemëve.)

Skena e shtatë

Ridvani – Amrui

AMRUI: Ridvan! Duhet ta mbash veten! Mos e trego shqetësimin, sepse mund të na diktojnë!

RIDVANI: A thua do të kemi ndonjë përfitim ?

AMRUI: Pa mëdyshje! Tek ata do të gjejmë dekretë, dokumente dhe letra të tjera si këto. Përmes tyre, pastaj mund të bëjmë diçka... Po sido që të jetë, atë të poshtrin kem për ta fluturuar... Nëse ai shkon në Granadë, Fatmën ka për ta djegur menjëherë në zjarr!

RIDVANI: Ah!

AMRUI: Ti mos mendo asgjë, por vetëm bëj atë që të them unë!

RIDVANI: Si urdhëron!

AMRUI: Ja ku janë! Erdhën! (*Kardinali me dy murgj hyjnë nga e majta me dinjitet dhe krenari.*)

Skena e tetë

Amrui – Ridvani – Kardinali – Dy murgj

KARDINALI: (*Murgjve*) Këta burra përse janë këtu? Kujdes, mos janë hajdutë!

NJËRI NGA MURGJIT: Shkëlqesi, nëse janë hajdutë spanjollë, nuk na prekin... Por duket nga veshjet e tyre që nuk janë hajdutë arabë!

MURGU TJETËR: Megjithatë, kujdes!

KARDINALI: Nuk bëmë mirë që u ndamë nga njerëzit tanë... Por sido që të jetë, t'u themi që t'i dorëzojnë armët... (*Amrui me Ridvanin me të parë ardhjen e Kardinalit, ecin në drejtim të tij dhe bëhen gati për heqjen e kapelës.*) Djema! Ndaluni njëherë! Nuk dyshoj fare që ju nuk jeni nga tanët dhe natyrisht që nuk mund të jeni të këqij... Por, megjithatë kërkoj që t'i dorëzoni armët.

AMRUI ME RIDVANIN: Si urdhëroni! Ja, menjëherë! (*I dorëzojnë armët.*)

KARDINALI: Ashtu pra! Tani ejani, o djemtë e mi! (*Kardinali i zgjat duart. Ridvani me Amruin ecin dhe bien para këmbëve të tij.*) E dini ju që unë jam Kardinali i Granadës?

AMRUI: Po, e dimë, lartmadhëri! Sa fatlum jemi ne sot që nga Vatikani i shenjtë në Granadë na dërgohet një kardinal epror si ju, kurse deri dje në këtë vend sundonin myslimanët!

KARDINALI: Po kardinali i mëparshëm si ishte? Ishit të kënaqur me të?

AMRUI: Lartmadhëri, e çfarë mund të themi ne?

KARDINALI: Edhe nëse jeni të kënaqur ju, nuk është i kënaqur Vatikani me të... As Papa i shenjtë nuk është i kënaqur! Vatikani ka dhënë urdhër që këtu nuk duhet të mbetet asnjë mysliman... Ndërsa ai ata dy a tre myslimanë të cilët duhej të digjeshin në zjarr, i mban në kishë! Ky gabimi i tij është trashanik! Të jesh kardinal dhe t'i mbrosh myslimanët, është çudi!

AMRUI: Atëherë këta myslimanë, meqë tani jeni ju kardinal, do të ekzekutohen, apo jo?

KARDINALI: Posi! Posi! Në bazë të ligjit të Inkuizicionit do të digjen në zjarr! Dekreti për djegie në zjarr... *(nxjerr dy dekretët dhe pasi e hap njërin prej tyre)* Ja, ky ka të bëjë me emërimin tim si Kardinal. *(duke e hapur të dytin)* Ndërsa ky i dyti, me vendimin për djegien e atyre tre myslimanëve dhe dërgimin nën masat e sigurisë të kardinalit të parë dhe të njëfarë Don Pedroje, për në Romë.

AMRUI: *(Duke vajtuar rrejshëm)* Ah, këto dekrete të shenjta! Këto janë duke na shpëtuar ne nga myslimanët! Ju lutem... M'i jepni për një çast... T'i puth, t'u marr erë! Sepse vijnë nga Vatikani i shenjtë! Vijnë nga toka e bekuar e Vatikanit!

KARDINALI: Merri, o biri im! Bëhu krenar! Besimi yt qenka i fortë! *(Amrui pasi i merr dekretët, tek është duke i puthur, duke u marrë erë dhe duke i përkëdhelur nëpër sy e faqe, shokët e tij me hanxharë në duar afrohen pas tyre dhe pa një, pa dy, sulmojnë Kardinalin dhe murgjit.)*

KARDINALI: *(Thuajse është duke dhënë shpirt)* Ah bre! Vdiqa! Ah, ju o tradhtarë! Jeni myslimanë apo çfarë jeni? Ah, ah! Vdiqa! Mbarova!

AMRUI: Vdeksh e u shofsh! Qafir! Zullumqar! Do t'i digje në zjarr ata tre myslimanë të pafajshëm... Ata nuk kanë shpirt, apo jo? Tani e kupton... sesa e vështirë është vdekja! Të vrasësh është fare lehtë, por të vdesësh është shumë e vështirë! A ju bien ndërmend ndonjëherë vuajtjet dhe dhimbjet e atyre qindra e mijëra njerëzve që i dogjët në zjarr? Ndërsa ne tani megjithatë nuk po ju djegim në zjarr, që t'i kuptoni edhe ju ato dhimbje dhe vuajtje... Madje, as që mund ta bëjmë një gjë të tillë!

KARDINALI: Ah! Ju lutem! Ç'doni të bëni me këto dekretë? M'i jepni... Të paktën t'i gris...T'i copëtoj...

AMRUI: Jo! Se na duhen neve!

KARDINALI: Ah! Vdiqa! Shkova! Mbarova! Ah, ah! *(Kardinali vdes. Pas pak vdesin edhe murgjit.)*

Skena e nëntë

Ridvani – Amrui – Shokët e tyre

RIDVANI: *(Duke e mbajtur Amruin për dore)* Amru, o vëlla! Këto të mira që bëre për mua, deri më sot, në këtë botë, as-

kush nuk ia ka bërë kurrkujt! Ah! Të faleminderit shumë!
Ma jep dorën të ta puth!

AMRUI: Prit, o vëlla... Ende asgjë nuk kemi bërë... (*të tjerëve*) Shokë! Së pari, duhet të fshehim këto kufoma! Pastaj të veshim rrobat e tyre! Ato të kardinalit, do t'i veshë Ridvani. Rrobat e njërit murg do t'i vesh unë. Ndërsa të tjetrit, le t'i veshë Xhaferi. Ju të tjerët, nëse gjeni diku rroba murgjish, mund t'i vishni!

TË GJITHË: Posi! Posi! Do t'i gjejmë patjetër!

AMRUI: Hajdeni atëherë! Kapeni! (*Amrui pasi kontrollon xhepat e kardinalit, gjen ca letra dhe ia jep Ridvanit. Pastaj i tërheqin kufomat. Bie perdja.*)

PAMJA E NËNTË

(*Dhoma e kishës e cila është paraqitur në Pamjen e pestë dhe të shtatë*)

Skena e dhjetë

Kardinali – (pastaj) - Kryemurgesha

KARDINALI: (*Me vete*) U shkarkova... Në vend tim është duke ardhur një tjetër! As këtë vajzë nuk munda ta bind... A nuk është turp për mua? Që prej sa kohësh e mbaj në kishë dhe nuk munda që nuk munda ta bind! Ajo është në gjendje të vdesë dhe të mos dorëzohet! Nuk paska qenë fati im dhe pikë! Ose i ka ardhur Gabrieii, lajmëtari i vdekjes... Ai kardinali që vjen, ka për t'ia treguar kësaj... Nuk kam dyshim

fare...(Kryemurgesha hyn nga dera.) Ee! Ç'u bë? Nuk mund ta bindësh?

KRYEMURGESHA: (*Me zemërim*) Jo, shkëlqesi jo! Ajo nuk bindet! Është tepër fanatike... Nuk bindet dot!

KARDINALI: Po çfarëpo bën ajo? Ç'thotë?

KRYEMURGESHA: Herë vajton, herë lexon Kuranin! A nuk është turp për ju kjo që është duke ndodhur? Si është e mundur që këtu brenda në kishë, të lexohet Kurani!

KARDINALI: Po ç'të bëjmë tjetër?

KRYEMURGESHA: Duhet zbatuar dënimi i saj!

KARDINALI: (*Me vete*) S'më bën dora! S'mund ta bëj atë punë! (*befas me zë të lartë*) Po si është e mundur të bëhet ajo punë kur unë jam i shkarkuar! Më është pamundësuar zbatimi i vendimeve të tyre! Sot vjen kardinali juaj i ri... Nëse ai do, le t'i zbatojë vendimet... (*Me vete*) Sikur të kisha mundur ta bind, derisa nuk ka ardhur ai! (*me britmë*) Ma sillni vajzën edhe një herë... Ndoshta bindet.

KRYEMURGESHA: Shkëlqesi, mos u lodhni kot... Nuk bindet! Madje as që ka nevojë të bindet, sepse katolikët nuk kanë për t'u shtuar me të! Duhet ekzekutuar vendimi për të dhe kaq!

KARDINALI: Ti ma sill, e nëse ajo nuk bindet, dënimin le ta zbatojë Kardinali i Ri!

KRYMURGESHA: (*Me vete*) Nëse letrat që i dërgova kanë mbërritur në Vatikan, Kardinali i Ri ka për të zbatuar jo vetëm dënimin e saj, por edhe tëndin! (*Del.*)

Skena e njëmbëdhjetë

KARDINALI: (*Me vete*) Më duhet ta provoj edhe një herë! Nëse e bind, do ikim së bashku... Nëse jo... Po sido që të jetë, kam për ta bindur! Kur t'i them se do të vijë një kardinal i ri, do të frikësohet edhe ajo! Sepse mua nuk ma ka frikën më! E kupton që e dua, prandaj... Ah, ç'më bëri ky shkar-kim! Sikur të isha edhe për pak kohë, mbase do ta bindja... Por, megjithatë, sot gjithsesi duhet ta bind! Hajt të shohim... Ja, erdhi! (*Kryemurgesha hyn nga dera me Fatmën, e cila është prangosur në këmbë e duar dhe është në gjendje tepër të keqe. Kryemurgesha del jashtë, pasi Kardinali i bën me shenjë.*)

Skena e dymbëdhjetë

Kardinali – Fatma

KARDINALI: A nuk është mëkat që mos ta dish vlerën e bukurisë tënde hyjnore dhe të dergjesh trupin tënd nëpër burgje e bodrume! Në ato llërët e bardha të tua, në vend të byzylykëve të lidhin zinxhirët! Në ato kërcinj si ari, në vend të rrethit të vendosin prangat! Vajzë! Eja në vete! Kujdesu për bukurinë! Zemërimi është duke të shkatërruar çdo ditë! Bukuria jote është e denjë për mbret... Por unë të them se rehatinë dhe kënaqësinë që do ta kesh tek një kardinal, nuk do ta gesh kurrë tek një mbret... Nëse do rehatinë, kënaqësinë dhe lumturinë e vetvetes, eja dhe më dashuro mua!

FATMA: (*Me hidhërim dhe mlllef*) Hesht! Nuk dua t'i dëgjojë këto pallavra! Më dëno ashtu si do, por këto fjalë harroji! Këto ma hëngrën shpirtin! (*Me vete*) Uh bre! Po i zuri në gojë edhe një herë këto budallallëqe, do t'ia fus në fytyrë me çfarë të kem në dorë! Përse më nxjerrin nga bodrumi! Aty e ndiej veten shumë mirë! Nuk shoh dhe nuk dëgjoj asgjë! Mendjen gjithnjë e kam te Ridvani! Përfytyrimi gjithnjë më sillet rreth Ridvanit!

KARDINALI: Ti mbase e ke dëgjuar se unë jam shkarkuar nga kjo detyrë dhe së shpejti do largohem... Do të vijë një kardinal tjetër.....

FATMA: (*Me vete*) Oh! Shyqyr o Zot!

KARDINALI: Gëzohesh, apo jo? Mendon ti se ky kardinali që vjen, është më i mirë se unë... Jo, jo! E ke gabim! Ai ka për të të djegur sapo të mbërrijë... Nëse do shpëtimin tënd, më dashuro mua... Nëse më do mua, nuk ka për të të ndodhur gjë. Pastaj largohemi së bashku... Unë të gjitha këto i bëj vetëm për shpëtimin tënd. Prandaj nëse përsëri më refuzon, unë nuk jam fajtor!

FATMA: Jo, nuk dua!

KARDINALI: E pra, nëse nuk do, atëherë ta dish se që sot ke për t'u djegur në zjarr!

FATMA: Ah! S'e kam atë fat! Sikur t'më digjinin, do ishte shumë më mirë! Dhe ndoshta sot kanë për të më djegur... Sepse që nga mëngjesi kam një ndjenjë të tillë! Ndoshta sot

është dita e fundit e vuajtjeve të mia dhe mbase sot do të vdes dhe do shpëtoj!

KARDINALI: Moj budallaqe! Mos ke luajtur nga mendtë? Do vdesësh dhe do shpëtosh thua. Ç'janë këto gjeputura!

FATMA: Po, ashtu po them! Ajo që mund të më shpëtojë nga duart e tua, është vetëm vdekja!

KARDINALI: Jo! Nuk është ashtu! Ajo që të ka shpëtuar deri tani dhe që do të të shpëtojë edhe më tutje, është dashuria ime e jo vdekja jote! Prandaj më dashuro dhe mos ki frikë nga asgjë!

FATMA: (*Me mlllef*) Ah! Ti i poshtër! Qafir!

KARDINALI: (*Pasi është hidhëruar*) Sa e ndyrë që qenke! Unë sillem me mirësi, ndërsa ti më fyen... Ik! Shporru që këtu! Mos të t'i shoh më sytë! Shko në ferr! (*Kryemurgesha hyn brenda.*) Merre këtë tradhtare dhe largoje nga këtu! Dyfishojani torturat! Dhëntë zoti deri sa të vijë kardinali i ri, vdes dhe shkon në ferr! (*Kryemurgesha e merr Fatmën prej krahësh dhe e nxjerr jashtë.*)

Skena e trembëdhjetë

Kardinali – (pastaj) - Kryemurgesha

KARDINALI: (*Me vete*) Po çfarë inati, ore! Çfarë fanatizmi! Gjithsesi nuk munda ta bind! Asnjë puthje nuk munda t'ia marr! Por, sikur mos të isha dashuruar pas saj, deri tani në duart e mia do të kishin kaluar shumë femra arabe! Por u mashtrova pas saj dhe mbeta pa asnjë!

KRYEMURGESHA: *(Duke hyrë nga dera)* Erdhën! Na erdhi Kardinali i Ri!

KARDINALI: Ëhë! *(Del me nxitim.)*

Skena e katërmbëdhjetë

KRYEMURGESHA: *(Me vete)* Letrat që dërgova ndoshta kanë mbërritur në Vatikan... Ky kardinal nuk do mbetet pa u dënuar... E sheh se si njeriu kur mendon keq për tjetrin, e pëson vetë! Kardinali deshi të më largonte nga këtu dhe në vendin tim të caktonte një vajzë myslimane mëkatare... Ndërsa tani unë jam ajo që do ta largojë kardinalin nga këtu, do ta shohë këtë vajzë duke u djegur dhe përsëri do të jem kryemurgeshë... Hajde pra, tani të shohim se kush është më dinak, unë apo kardinali? Ha! Ha! Ha! Ha! Ja! Erdhën! *(Del. Menjëherë pas saj, i veshur me rroba të kardinalit, hyn Ridvani me gjashtë shokëte tij të veshur si murgj. Pas tyre hyn edhe kardinali.)*

RIDVANI: *(Kardinalit)* Këtu na qenka një burrë me emrin Don Pedro.

KARDINALI: Po, shkëlqesi, është! Edhe shtëpinë e ka këtu afër... *(Me vete)* Çfarë ka për t'i bërë atij?

RIDVANI: A ka mundësi ta thirrni?

KARDINALI: Si urdhëroni, Shkëlqesi. *(Del. Dhe menjëherë kthehet)* Dërgova dikë. Tani vjen.

RIDVANI: *(Pasi nxjerr dy letra nga xhepi, njëren ia jep kardinalit)* Lexoje këtë.

KARDINALI: *(E merr atë dhe pasi e lexon duke iu dridhur duart, me vete)* Ah! *(Duke shikuar nënshkrimin)* Maria! Kryemurgesha! Ah! Spiunia!

RIDVANI: *(duke ia dhënë edhe letrën tjetër)* Lexoje edhe këtë!

KARDINALI: *(pasi e lexon, me vete)* Ah! Edhe kjo e saja! Çfarë tradhtie! Çfarë spiunimi! Dhe asgjë nuk përfituam... Po u bëmë edhe me dekret... *(Don Pedroja me të hyrë brenda, i për-kulet me respekt Ridvanit.)*

Skena e gjashtëmbëdhjetë

Ata të mëparshmit – Don Pedroja

RIDVANI: *(Don Pedros)* Ju jeni Don Pedroja, apo jo?

DON PEDRO: Po Lartmadhëri, unë jam.

RIDVANI: *(Nxjerr letrën nga xhepi dhe duke ia dhënë Don Pedros)* Merre! Lexoje këtë dekret të shenjtë bashkë me kardinalin Mysjy. *(Don Pedroja merr dekretin dhe pasi e hap, i afrohet kardinalit dhe fillojnë ta lexojnë kokë më kokë.)*

DON PEDRO: Ah!

RIDVANI: E keni të qartë, apo jo? Tani, që të dy ju, nën masat e sigurisë, do të shkoni në Romë! *(Kardinalit)* Ti Kar-

dinal Mysjy, këtu në kishë mban një vajzë mëkatare myslimane dhe madje provon që ta bësh kryemurgeshë! Ajo vajzë është bërë katolike, por pastaj është penduar dhe përsëri është bërë myslimane. Në kundërshtim me porosinë që dënimi i merituar për këtë tradhti është djegia në zjarr, ti akoma e mban në kishë! Madje ajo po lexuaka edhe Kuranin tërë natën!

KARDINALI: Shkëlqesi!

RIDVANI: Hesht! Nuk dua kundërshtime për këtë! Hiqe nga koka kurorën e kardinalit! (Kardinali e heq kurorën, e lë në një anë dhe rri i druajtur.)

RIDVANI: (*Don Pedros*) Edhe ti Don Pedro ke dashur t'ia japësh vajzën tënde një myslimani. E ai mysliman, vajzën tënde e ka bërë myslimane dhe e ka rrëmbyer... Ju pastaj i keni kapur dhe në vend t'i ekzekutoni, edhe ata të dy i mbani këtu në kishë! Turp, turp! Kisha Shën Maria është mbushur me myslimanë! Prandaj edhe ti Don Pedro, meqë ke vepruar bashkë me kardinalin Mysjyn për qëllimet dhe dëshirat e tua vetjake, keni bërë gjëra që gjithsesi nuk tolerohet të bëhen në kishë!

DON PEDRO: Shkëlqesi!

RIDVANI: Nuk dua t'ju dëgjoj më! (*Amruit*) Mysjy Karlos! Merri këta dhe dërgoi për në Romë! (*Amrui i kap dhe fillon t'i nxjerrë jashtë. Ndërsa Ridvani Kardinalit*) M'i jep ato letra! (*Kardinali i jep ato letra dhe dekretin. Amrui i nxjerr jashtë që të*

dy. Ridvani i drejtohet Xhaferit) Këtu na qenka një kryemurgeshë me emrin Maria. Ma gjej dhe ma sill. (Xhaferi del. Pas pak kthehet Amrui dhe pas tij Xhaferi me kryemurgeshën. Kryemurgesha i përkulet Ridvanit.)

Skena e shtatëmbëdhjetë
Ata të mëparshmit – Kryemurgesha

RIDVANI: (*Kryemurgeshës*) Jeni ju Maria, kryemurgesha e kësaj kishe?

KRYEMURGESHA: Po Shkëlqesi, unë jam!

RIDVANI: Në burg gjenden tre myslimanë, apo jo?

KRYEMURGESHA: Po, Shkëlqesi! Nëse doni, mund t'jua sjellim.

RIDVANI: Jo, ju mos m'i sillni, se do të shkojmë ne aty ku do të digjen ata.

KRYEMURGESHA: Oh! Shyqyr o Zot që më në fund u nderuam me një kardinal si ju, i cili do t'i zbatojë plotësisht urdhrat e Inkuizicionit!

RIDVANI: (*Me vete*) Tani ke për t'i parë ti urdhrat e mia! (*me zë*) Hajde, na dërgo në burg, që t'i djegim ata myslimanët!

KRYEMURGESHA: Shkëlqesi. T'u biem kambanave që të grumbullohen njerëzit. Le të marrin mësim nga ky pësim!

RIDVANI: Jo, nuk ka nevojë, meqë ky është një dënim që duhej të kryhej më herët... Pastaj nëse populli e sheh këtë, nuk do jetë mësim për ta, por do bëhet pësim për ne!

KRYEMURGESHA: Ëhë! Ne fakt ashtu është. Shkëlqesi, sikur mos të isha unë, ai atë vajzë myslimane as që do ta burgoste madje... Por ja që qëllova unë. Prandaj ai që e caktonte atë dënim, unë ia dyfishova.

RIDVANI: *(Me vete)* Qofsh e mallkuar ti! Gjithsesi duhet të të shpërblej ty! Prit pak dhe ke për të parë! *(me zë)* Hajde na prij! *(Kryemurgesha del e para dhe pas saj, dalin të gjithë të tjerët. Perdja mbyllet.)*

PAMJA E DHJETË

(Si në terr, shihet pjesa e jashtme e një burgu me shumë shtylla. Dyer burgu në të gjitha anët.)

Skena e tetëmbëdhjetë

Ata të mëparshmit – (pastaj) - Fatma – Hasani – Lionora

RIDVANI: *(Kryemurgeshës)* Po ku janë ata moj? Hajde nxirri!

KRYEMURGESHA: Njëra është këtu. *(duke ia treguar derën.)* Dy të tjerë janë atje. *(duke i treguar derën tjetër.)*

RIDVANI: Hajde hapi dyert. Le të dalin. *(Kryemurgesha hap derën e parë dhe hyn brenda, e kap Fatmën nga krahët dhe e nxjerr jashtë. Fatma është nën pranga dhe mezi rri në këmbë.)*

FATMA: Ka ardhur Kardinali i Ri dhe do të më djegin! Po sikur edhe mos të më djegin, sot do vdisja! Trupi nuk më mban më! Duart, këmbët më janë bërë zi nga prangat! Lagështia e burgut më ka hyrë deri në palcë!

RIDVANI: (*Me vete*) Ah, moj Fatma! Aman o Zot! Po si je bërë kështu! Ah s'mund të duroj dot më!

AMRUI: (*Pasi i afrohet Ridvanit, me zë të ulët*) Ridvan! Çfarë po bën? Durim! (*Ridvanit i dalin lot nga sytë.*)

RIDVANI: Ti, o vajzë, shikomë një herë!

FATMA: (*me habi*) Oh more! Ç'është ky zë! Aman o Zot! Më është afruar vdekja, apo çfarë? Më vjen sikur dëgjoj zërin e Ridvanit! (*Duke parë fytyrën e Ridvanit*) Ah! Ç'po ndodh me mua!

RIDVANI: Vajzë! Ti njëherë u bërë katolike dhe pastaj përsëri u ktheve dhe u bërë myslimane... Apo jo?

FATMA: Aman o Zot, po ky zë është i Ridvanit!

RIDVANI: M'u përgjigj!

FATMA: Zotrote! (E ngre kokën dhe duke shikuar në fytyrën e Ridvanit) Oh more! O Zot! Edhe sytë i ka të njëjtë si të Ridvanit! Apo, mos ndoshta më duken mua ashtu?

RIDVANI: Hajde, më thuaj? Do ta mohosh, apo jo?

FATMA: Jo! Unë u bëra katolike! Por isha myslimane! Jam myslimane! Dhe do të vdes myslimane!

RIDVANI: Po ti a the para Kardinalit se u bëre katolike?

FATMA: Vëllaçko! Mua më tradhtoi ai i pabesi... Më tha jo ashtu, jo kështu, se gjoja do të më shpëtonte... Prandaj edhe unë i thashë se gjoja..... Por unë jam myslimane, do të vdes myslimane dhe kaq! (*duke i treguar Kurandin që ka në dorë*) Ja ku e kam dëshmitarin! Ja ku është Kurani! Babai im i ndjerë këtë Libër të shenjtë e ka shkruar vetë me dorën e tij! Unë këtë Libër të shenjtë nuk e hoqa nga duart e mia për asnjë çast, me gjithë torturat që përjetova ! Dhe nuk do ta lë derisa të vdes!

RIDVANI: Domethënë as duke vdekur, nuk do heqësh dorë nga feja myslimane.

FATMA: Në asnjë mënyrë! Kurrë!

RIDVANI: Atëherë ke për t'u djegur në zjarr.

FATMA: Jam e gatshme dhe mezi po e pres!

RIDVANI: Veç kësaj, ke pranuar se do të martohesh me Rafaelin.

FATMA: Nuk është e saktë! Është gënjeshtër... Më mashtroi vëllai im, më detyroi me forcë të bindem.

RIDVANI: A do të thotë kjo se vdes dhe nuk martohesh dot me Rafaelin?

FATMA: Hesht! Hesht dhe mos i zër në gojë edhe një herë këto gjepura! Dënimi im a nuk është me djegie në zjarr? Atëherë, hajde më digjni që të shpëtoj!

RIDVANI: Qenka një djalë me emrin Ridvan e ti e dashuroke atë!

FATMA: (*Rrëqethet*) Ah, Ridvani! Ridvan, a Ridvan! Të lutem! Ridvanin mos ma përmend! Se kur përmendet emri Ridvan, pothuajse më pushon zemra!

RIDVANI: Domethënë e do atë edhe duke vdekur!

FATMA: E dua! Do ta dua! Do ta ëndërroj derisa të vdes! Duke dhënë shpirt, fjala e fundit në buzët e mia do të jetë emri i tij! Do bëhem kurban i tij!

RIDVANI: Po ai paska vdekur prej kohësh!

FATMA: Ah! Paska vdekur a! Ju lutem, ndizeni zjarrin sa më parë! Më digjni mua sa më shpejt! Të humbas! Ta gjej Ridvanin në botën tjetër!

RIDVANI: (*Me vete*) Në rregull! (*Shokëve*) Ndizeni zjarrin! (*Me vete*) Ah o Zot! Mbarova!

PAMJA E NJËMBËDHJETË

(Nja dy a tre veta sjellin dru për ta ndezur zjarrin.)

RIDVANI: *(Kryemurgeshës)* Hape edhe atë derën tjetër, se u mjafton edhe atyre. *(Kryemurgesha e hap derën dhe nxjerr jash-të Hasanin me Lionorën, të cilët janë lidhur me pranga, në këmbë e duar.)*

Skena e nëntëmbëdhjetë

Ata të mëparshmit – Hasani me Lionorën

FATMA: *(Pasi e sheh Hasanin, me habi)* Mos! Hasan! Ti je këtu! *(Ngrihet në këmbë dhe tenton t'i afrohet Hasanit, por e pengojnë prangat dhe rrëzohet në tokë.)*

HASANI: *(Me të parë Fatmën)* Ah! Fatma! *(Pasi vëren zjarrin)* Mos! Zjarri! Kanë për të të djegur në zjarr! Tmerr! *(Duke iu afruar Fatmës)* Do të digjesh Fatma! Ah! Për fajin tim do digjesh, o Fatma! Unë jam fajtor!

RIDVANI: Edhe ti do digjesh bashkë me të!

FATMA: E përse?

RIDVANI: Ti njëherë u bërë katolik. Pastaj të është dhënë titulli i Donit dhe je bërë njeri i privilegjuar. Por ti përsëri je kthyer në fenë islame dhe je bërë mysliman. Veç kësaj, edhe vajzën e Don Pedros e ke bërë myslimane dhe e ke rrëmbyer! E ke grisur dekretin për titullin e Donit, ndërsa kurorën

e ke hedhur përtokë! Prandaj ti dhe kjo vajzë, do të digjeni bashkërisht!

LIONORA: Mos!

HASANI: *(Pasi bie para këmbëve të Ridvanit)* Shkëlqesi, është e vërtetë që unë e kam rrëmbyer këtë vajzë. E rrëmbeva meqë e doja, por ata nuk ma jepnin... Por mysliman nuk jam bërë! Jam katolik!

FATMA: Ah, i poshtër! Tani ke për të marrë shpërblimin për shërbimin tënd ndaj armiqve!

LIONORA: *(Pasi bie para këmbëve të Ridvanit)* Ju qofsha falë, shkëlqesi! Mëshirë!

RIDVANI: *(Pasi e ngre Lionorën duke e larguar me zemërim)* Mos u lodhni kot! Ju do të digjeni dhe kaq! Edhe sikur të doja, nuk mund t'ju shpëtoja! Ja ku është dekreti i Vatikanit! Edhe udhëzimi i Inkuizicionit! Merreni dhe lexojeni!

LIONORA: *(Me hidhërim)* Mos qoftë ai Inkuiziconi! Poshtë Vatikani! Unë jam myslimane!

RIDVANI: *(Hasanit)* Po ti çfarë thua, djalosh?

HASANI: Edhe unë jam mysliman. Për shkak të Lionorës, gjoja e pranova fenë katolike! Por në ndërgjegjen time gjithmonë isha mysliman! E tani pasi edhe Lionora është bërë myslimane, as unë nuk e fsheh veten se jam mysliman! Pasi Lionora do të digjet... Pasi edhe Fatma do t'digjet për fajin

tim, atëherë bashkë me to, le të digjem edhe unë! Ky dënim për mua është për shkak të fajit tim! O ju të pafajshëm të shkretë, hajdeni dhe më digjni mua!

RIDVANI: (*Shokëve*) Ua hiqni prangat këtyre! (*Ata ua heqin.*)

HASANI: (*Pasi bie para këmbëve të Fatmës*) Ah, moj Fatma! Ti do të digjesh për fajin tim!

FATMA: (*Pasi e përqafton Hasanin*) Hasan! Unë jam e kënaqur, sepse të pashë edhe një herë si vëlla! Edhe një herë të thirra Hasan! Unë tani jam e lumtur! Por më dhimbseth ti, meqë do të digjesh!

HASANI: Jo, Fatma! Dënimi im është i merituar! Prandaj nuk ka pse të dhimbsem!

FATMA: Por ti megjithatë je me fat... Sepse do të digjesh bashkë me të dashurën!

E unë... Ah! Unë nuk do të kem fatin ta shoh edhe një herë Ridvanin! Ah, Ridvan a Ridvan! (Qan me dënesë dhe ashtu duke vajtuar, hap Kuranin dhe fillon të lexojë.)

RIDVANI: Tani ekzekutimi i dënimit të tyre është gati! Por para kësaj, këtu është edhe një njeri tjetër që duhet dënuar. (*Kryemurgesha hap sytë. Ridvani i nxjerr të dy letrat dhe pasi i hap ato, ia afron kryemurgeshës.*) A bën ti shikosh një herë këto nënshkrime, a janë të tuat?

KRYEMURGESHA: (*duke u dridhur*) Po... Të miat janë! Mos vallë kam bërë keq? I shkrova Vatikanit për gjërat e

pahijshme që ndodhnin në kishë. Mendoj se kam bërë një punë të mirë.

RIDVANI: Në rregull, por unë nuk dua që brenda në kishë të kemi edhe spiunë! (*Shokëve*) Kapeni këtë dhe futeni në burg! (*E marrin kryemurgeshën dhe e dërgojnë në burg.*)

Skena e njëzetë

(*Po ata të mëparshmit, përveç murgeshës*)

FATMA: Hasan! Shiko çfarë rastësie e mrekullueshme! Sapo hapa Kuranin, qëllova në syren e Hazreti Ibrahimit!

RIDVANI: (*Lionorës*) Vajzë! Sido që të jetë... Këta edhe më parë ishin myslimanë! Por çfarë ju shtyri ju që të bëheni myslimane?

LIONORA: (*Me zemërim*) Zullumi juaj dhe drejtësia e tyre! Sjellja juaj në kundërshtim të plotë me gjykimin e Biblës së shenjtë dhe sjellja e tyre në përputhje me të!

RIDVANI: Pa shiko si flet kjo kundër fesë katolike! (*Shokëve*) Merrini këta!

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në
Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

821.512.161-2

FRASHËRI, Sami

Ndërgjegjja: (dramë në pesë akte) / Sami Frashëri; e përktheu
nga turqishtja: Raif Morina. - Shkup: Logos-A, 2014. - 200 faqe; 21 cm.
- (Biblioteka Divan)

Përkthim i veprës: Vicdan: (bes fasildan ibaret tiyatro eseri) /
Semsettin Sami


ISBN 978-9989-58-521-0

I. Sami, Semsettin shih Frashëri, Sami

COBISS.MK-ID 95750410

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2014



LOGOS·A